

DITURIA ISLAME

محمد ﷺ

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE • Nr. 382 • SHTATOR 2022

IMAM I QABESË VIZITOI
KOSOVËN



MUHAMEDI A.S., SHËMBËLLTYRË E PAPËRSËRITSHME

OFERTA E ISLAMIT PËR FAMILJEN NË
VORBULLËN E SFIDAVE BASHKËKOHORE

Porosi të përzgjedhura nga fjalimet e imamit të Qabesë



POROSI NGA LIGJËRATA NË FSI:

“Kushdo që kujdeset që t’ua bëjë të lehtë jetën e njerëzve dhe ua largon brengat e tyre, të tillin, Allahu ka garantuar se do ta mbrojë nga zjarri dhe se atij do t’ia falë mëkatet, ashtu siç thotë Muhamedi a.s., në një fjalë të tij: “I është ndaluar zjarrit që të djegë cilindo njeri që është tolerant, i butë, i lehtë dhe i afërt me njerëzit.”

POROSI NGA LIGJËRATA NË MEDRESENË "ALAUDDIN":

“Të dashur vëllezër! Meqë parimi i ruajtjes së unitetit dhe përbashkimit vëllazëror është tejet me rëndësi e me peshë në Islam, si i tillë, ai na paraqitet edhe si një postulat universal dhe si një detyrim i kulluar fetar që nuk është anuluar asnjëherë përgjatë kohëve.”



POROSI NGA HYTBEJA E XHUMASË NË XHAMINË E MADHE NË PRISHTINË:

“Mesatarja islame nënkupton shmangien nga teprimi, por edhe kujdesin nga mangësimi në cilindo aspekt fetar islam. Kështu që, të tejkalosh kufijtë e asaj që është e kërkuar prej teje, është teprim në fe, ndërsa lënia mangët e asaj që duhet vepruar është neglizhencë dhe pakujdesi në të. Prandaj, edhe teprimi dhe neglizhenca konsiderohen largim nga rruga e drejtë e Allahut të Madhërisëm.”



EDITORIAL

- 4 Lindja që dha kumtin e paharrueshëm në histori

FE & SHKENCË

- 5 Komentimi i kaptinës Muhamed - (6)
Sabri BAJGORA
- 9 Shkenca e Ilmul Kelamit tek Ehli Suneti
Dr. Bahri HOXHA
- 14 Hadithet që iu atribuan Muhamedit a.s. nga brezi që atë nuk e takoi
Dr. Flamur SOFIU
- 17 Sunetet e ushqimit dhe pijes në Islam dhe rregullat etike të tyre
Dr. Ilmije KUQI



- 21 Sjelljet e virtytshme në jetën e besimtarit
Mr. Vedat SHABANI
- 24 Konditat dhe rregullat e urdhrat për të mirë dhe ndalimit nga e keqja
Prof. ass. dr. Rexhep SUMA



- 28 Oferta e Islamit për familjen në vorbullën e sfidave bashkëkohore
Mimoza SINANI
- 32 Familja e shëndoshë për një shoqëri të shëndoshë
Dr. Mirsad ASLANI -
Mr. sci. Sebajdin KRASNIQI



- 34 Muhamedi a.s., shëmbëlltë e papërsëritshme
Isa TËRSHANI

KULTURË

- 37 Sylejman Çelebiu dhe vepra e tij "Vesiletu'n-Nexhat" (Mevludi)

PhD(c) Besir Neziri



- 41 Islami si faktor kryesor në mbijetesën e kombit (2)

Xhafer SADIKU

HISTORI & CIVILIZIM

- 45 Çfarë na rrëfen një vakëfname

Dr. Eduart ÇAKA

- 47 Sixhilatet e kadiut osman si burim i dorës së parë për historishkrimin e qyteteve shqiptare

Prof. ass. dr. Agron ISLAMI

- 51 Komisia letrare shqipe e Shkodrës

Sevdie OSMANI

- 54 Medresetë-shkollat e para në periudhën klasike osmane (1360 – 1600)

Phd. Driton KELMENDI



PERSONALITETE

- 57 Mulla H. Sadik ef. Hoxha (1908 - 1972)

Ma. Vehbi SHATRI



AKTIVITETE

- 60 Imam i Qabesë dr. Abdullah Avad El Xuheni qëndroi në Kosovë



DITURIA ISLAME

Revistë mujore fetare, shkencore e kulturore
Nr. 382 • viti 36 • shtator 2022
• Rebiul Ewel 1444
• çmimi 1 €

Boton:
Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës,
Prishtinë

Redaksia

Kryeredaktor: Mr. Driton Arifi
Anëtarë:
Dr. Ejup Haziri, Merita Boroci,
mr. Muharrem Tërnavë,
mr. Vedat Shabani.
Sekretar redaksie: Dr. Rexhep Suma
Lektor & korrektor: Bajram Zeqiri
Redaktor artistik & teknik:
Bashkim Mehani

Adresa

"Dituria Islame",
rr. "Bajram Kelmendi" nr. 182,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 224 024
E-mail: dituriaislame@hotmail.com
dituriaislame@yahoo.com
www.bislame.net
Shtypi:
Shtypshkronja "Printing press", Prishtinë



“Thuaj: “Unë nuk mund t’i sjell vetes as dobi e as dëm, përveç atë që do Zoti. E sikur t’i dija fshehtësitë, do t’i shumoja të mirat për veten time, dhe nuk do të më godiste asnjë e keq! Unë jam vetëm paralajmërues dhe përgëzues për njerëzit që besojnë.”!

(El Araf, 188).

Lindja që dha kumtin e paharrueshëm në histori

Çdo lindje premtan ripërtërirje, jep kumtin e rimëkëmbjes, e mbi të gjitha e flakë frikën e farësosjes. Dosido, një i lindur, bashkë me sihariqin e ardhjes së tij në këtë botë, e bart me vete edhe paralajmërimin e ikjes së tij prej saj. E, si duket këto të vërteta për njerëzit e përzgjedhur të Zotit kanë një kuptimësi edhe më të thellë, si dhe na thonë më shumë sesa kaq. I dashuri ynë Muhamedi, paqja dhe shpëtimi i Zotit qoftë mbi të, lindi, jetoi dhe vdiq si çdo njeri, mirëpo si një i dërguar, një i përzgjedhur, si një udhërrëfyes dhe, gjithsesi, edhe si një i mbrojtur i Zotit.

Dita e 12-të Rebiul Evvel-it, ishte dita kur lindi ai, a.s. Ajo ditë do të mbetej njësoj, si çdo ditë tjetër, dhe si çdo datë e cilitdo muaj, pa ndonjë vlerë a veçanti, po mos ta shihte dritën e jetës në të më i çmuari njeri. Lindja e tij në të e bëri datëlindjen në vetvete histori.

Ai do të lindte në një kohë kur njerëzit e kishin harruar Zotin e Vërtetë, vlerën e mirësinë, po edhe e kishin varrosur virtytin dhe ushqeheshin me të ligën e gëzoheshin me padrejtësinë.

I përvuajtur do të rritej, pa prindër qyshkur ishte fëmijë, e më vonë edhe i paragjykuar, i përqeshur, i fyer e i torturuar. Ky ishte fati i më të mirit njeri. Të gjitha përvuajtjet, brengat dhe etiketimet nuk i mori si arsye a justifikim që ai ta braktiste misionin fisnik, për aq kohë sa mori frymë në këtë jetë. Ai s’mundi dhe as nuk tëntoi që t’i shmangte të ligat as prej vetes, por llogariste se ato do t’i ndihmonin në përlutësi e dëlirësi te Krijuesi i tij. Allahu, xh.sh., duke cituar fjalët e të Dërguarit, a.s., tha: “Thuaj: “Unë nuk mund t’i sjell vetes as dobi e as dëm, përveç atë që do Zoti. E sikur t’i dija fshehtësitë, do t’i shumoja të mirat për veten time, dhe nuk do të më godiste asnjë e keq! Unë jam vetëm paralajmërues dhe përgëzues për njerëzit që besojnë.”! - El Araf, 188. Ai kurrë nuk e pretendoi shenjtërinë, e as nuk tha se i dinte të fshehtat. Asnjëherë nuk ua kërkoi pasuesëve të tij adhurimin, përkundraz, ai thjesht e kreu detyrën e paralajmëruesit dhe përgëzuesit për njerëzit që mendojnë e që për të vërtetën hulumtojnë. Ai hodhi hapa jo thjesht për të ecur, por për të lënë gjurmë dhe për t’u ndjekur prej të gjithë atyre që besojnë në Zot dhe që synojnë për shpirtin, paqen e dëlirësinë. Historia njerëzore refuzon ta harrojë lindjen, jetën dhe sakrificën e të tillit njeri.

Po si t’i mbulojë historia gjurmët e atij njeriu që misionin e tij e filloi me fjalët hyjnore: “Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi!” El Alek, 1, dhe që doli nga kjo botë duke proklamuar vlerat më të larta dhe më universale në çdo fjalë që tha?! E, sidomos në fjalimin lamtumirës: “O ju njerëz, gjaku-jeta juaj, nderi juaj, vërtet se janë të shenjta për ju deri kur ta takoni Zotin tuaj, siç është e shenjtë për ju edhe kjo ditë, në këtë muaj të shenjtë dhe në këtë vend të shenjtë! O Allah, a e qova në vend misionin që ma ngarkove?! Dëshmoje, pra këtë, o Zoti im!” Buhariu, 7578.

Zoti, e edhe njerëzit, në çdo kohë e vend janë dëshmitarë se ai shembëlleu si pishtar ndriçues, si model jete, si flakadan që nuk do të shuhet kurrë, as pas vdekjes së tij. Ai e filloi misionin me ftesën për dije, hulumtim e shkencë, dhe e përfundoi me ftesën për humanizëm, fisnikëri e dinjitet njerëzor. E nëse këto janë dy kornizat dhe kopertinat e arta të librit të misionit të tij, mund ta imagjinoi se çfarë mund të ketë në brendinë e “librit” - jetës së tij!

Atij, veprat nuk ia përgenjshtruan kurrë fjalët dhe porosinë. Tek ai fjala ishte vepër. Prandaj, nëse ndaj çdo të dituri, shkencëtari a gjeniu njerëzit mund të shprehin dashuri, po edhe të jenë indiferentë, ata kurrë s’kanë arritur ta fshehin mahnitjen nga rrëfimet e jetës së begatë të të dërguarit tonë të fundit, Muhamedit, paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të dhe familjen e tij!

Lindja dhe vdekja e tij nuk janë thjesht ngjarje që rrëfejnë ardhjen dhe ikjen e dikujt nga kjo botë. Për më tepër, na tregojnë se si do të duhej të jetonte secili e që mbi këtë tokë e mban emrin NJERI.

Mr. Driton Arifi

Komentimi i kaptinës Muhamed - (6)

Qëndrimi i hipokritëve dhe i besimtarëve ndaj shpalljes

Sabri BAJGORA

وَيَقُولُ الَّذِينَ آمَنُوا لَوْلَا نُزِّلَتْ سُورَةٌ فَإِذَا أُنزِلَتْ سُورَةٌ مُحْكَمَةٌ وَذُكِرَ فِيهَا الْقِتَالُ رَأَيْتَ الَّذِينَ فِي قُلُوبِهِمْ مَرَضٌ يَنْظُرُونَ إِلَيْكَ نَظَرَ الْمَغْشِيِّ عَلَيْهِ مِنَ الْمَوْتِ فَأُولَئِكَ لَهُمْ ﴿٢٠﴾ طَاعَةٌ وَقَوْلٌ مَعْرُوفٌ فَإِذَا عَزَمَ الْأَمْرُ فَلَوْ صَدَقُوا اللَّهَ لَكَانَ خَيْرًا لَهُمْ ﴿١٢﴾ فَهَلْ عَسَيْتُمْ إِنْ تَوَلَّيْتُمْ أَنْ تُفْسِدُوا فِي الْأَرْضِ وَتَقَطَّعُوا أَرْحَامَكُمْ ﴿٢٢﴾ أُولَئِكَ الَّذِينَ لَعَنَهُمُ اللَّهُ فَأَصَمَّهُمْ وَأَعَمَّى أَبْصَارَهُمْ ﴿٣٢﴾ أَفَلَا يَتَذَكَّرُونَ الْقُرْآنَ أَمْ عَلَى قُلُوبٍ أَقْفَالُهَا ﴿٤٢﴾

“Besimtarët thonë: “Sikur të ishte shpallur një sure (për luftën!)” E kur u shpall një sure e qartë dhe në të u përmend lufta, i sheh ata me zemra të sëmura, si të vështrojnë ty me shikimin sikur të atij që është në agoninë e vdekjes! Por më parësore për ta do të ishte bindja dhe fjala e mirë! E kur çështja (e luftës) të jetë vendosur, do të ishte më mirë për ta që të jenë të sigurtë ndaj Allahut. Mos vallë, po të kishit pushtet (o hipokritë), nuk do të bënit ngatërresa në Tokë dhe nuk do t'i shkëpusnit lidhjet farefisnore?! Këta janë ata, të cilët Allahu i ka mallkuar, i ka bërë të shurdhër dhe ua ka verbuar shikimin. Vallë, pse nuk meditojnë ata për Kurandin apo i kanë zemrat e kyçura?! – (Muhamed, 20-24)

LIDHJA E KËTYRE AJETEVE ME ATA PARAPRAKË

Në ajetet e kaluara, Allahu i Madhërisëm na njoftoi për gjendjen e hipokritëve-mynafikëve, të cilët besimin e kanë të shtirur dhe e bëjnë vetëm sa për sy e faqe. Por, këtë hipokrizi, siç e sqarojnë këto ajete në vazhdim,

Allahu ua shfaq pikërisht në momentet kur prej tyre kërkohet veprim, si fjala vjen për luftë dhe xhihad, e ata menjëherë zmbarsen duke gjetur arsyttime të ndryshme. Kjo tregon se po t'u jepej mundësia dhe po të kishin pushtet, ata menjëherë do të shfaqnin atë çka e fshehin në zemra, urrejtjen ndaj besimtarëve dhe mosbesimin ndaj Zotit. Për këtë arsye, ky grup janë të mallkuar dhe të përjashtuar nga mëshira e Zotit.

KOMENT:

20. Besimtarët thonë: “Sikur të ishte shpallur një sure (për luftën!)” E kur u shpall një sure e qartë dhe në të u përmend lufta, i sheh ata me zemra të sëmura, si të vështrojnë ty me shikimin sikur të atij që është në agoninë e vdekjes! Por më parësore për ta do të ishte...

Që nga shpërngulja e bekuar, kur myslimanët së bashku me të Dërguarin a.s. bënë hixhret në Medinë, po përvëloheshin nga malli dhe dëshira të rroknin armët e të luftonin për hir të lartësimit të fjalës së Allahut, kundër jobesimtarëve. Ata për një periudhë mbi trembëdhjetë vjeçare kishin jetuar të shtypur, nën frikën e kërcënimit për shkak të besimit të tyre. Prandaj, tash pas shpërnguljes, kur po kryenin lirisht obligimet fetare, e ndjenin se tashmë kishte ardhur koha që t'u lejohej lufta për ta mbrojtur vetveten dhe besimin e tyre. Këto ndjenja të tyre të çiltra i ka përmendur edhe vetë Allahu xh.sh. në këtë ajet, kur besimtarët po shpresonin prej Zotit Fuqiptotë t'u zbriste një ajet apo sure për lejimin e luftës. Dhe, kur u shpall ajo të cilën po e kërkonin me padurim, leja për luftë, besimtarët u gëzuan pa masë, sepse tashmë po u jepej

Frika që reflektohet dukshëm në fytyrat dhe zemrat e sëmura të hipokritëve, është një gjendje paniku e pakontrolluar, e cila shpie në humbjen e perceptimit real dhe koheziv nga ana e tyre, sepse maska e hipokrizisë nën të cilën janë fshehur, u bie.

mundësia ta arrinin edhe gradën e dëshmorit-shehidit në rrugën e Zotit. Për çudi, zbritja e ajetit apo sures që ua lejonte luftën myslimanëve, nuk i gëzoi e as i lumturoi një grup njerëzish. Këta ishin mynafikët, të cilët Kurani i përmend si njerëz me zemra të sëmura. Pas lejimit të luftës, shtirja e tyre si gjoja besimtarë, sa vinte e po bëhej më e vështirë për ta, sepse po t'i iknin haptazi një obligimi të tillë kolektiv, do të binin në sy menjëherë. Prandaj ata e shikonin Pejgamberin a.s. dhe myslimanët vëngër e me shikime të turbullta, mu ashtu siç shikon ai që është në grahamat e fundit të jetës, apo siç e potencon Kurani famëlartë, në agoninë e vdekjes, kur shikimet e tij janë të pakontrolluara. Ky ajet, dhe ata që pasojnë pas tij, paraqesin qëndrimin qyqar të hipokritëve ndaj xhihadit, dhe është një përshkrim i jashtëzakonshëm vështuar nga aspekti gjuhësor, sepse sqaron në mënyrë reale frikën dhe qyqarllëkun në zemrat e tyre, kur imagjinonin se mund të shkonin në luftë, të pavullnetshëm, dhe madje, me shumë gjasa, edhe mund të vriteshin. Frika që reflektohet dukshëm në fytyrat dhe zemrat e sëmura të hipokritëve, është një gjendje paniku e pakontrolluar, e cila shpie në humbjen e perceptimit real dhe koheziv nga ana e tyre, sepse maska e hipokrizisë nën të cilën janë fshehur, u bie. Fytyrat e tyre të ngrysur shprehin një lemeri që nënkupton dridhje dhe veprime të çakërdisura, të cilat i ngjajnë një njeriu që dergjet i pafuqishëm në agoninë e vdekjes. Ky është imazhi i një shpirti mëkatar të pabindur ndaj Zotit të vet, imazhi i një shpirti hipokrit, i cili nuk arrin dot ta shijojë dhe ndjejë ëmbëlsinë e imanit.¹

Si sqarim tjetër për këtë qëndrim qyqar të hipokritëve karshi luftës së shenjtë, vjen edhe ajeti 77 i sures En-Nisaë, kur Allahu e përshkruan qëndrimin e mynafikëve për luftën: “Por kur iu bë detyrim lufta, një grup prej tyre iu frikësuan njerëzve ashtu siç është për t’iu frikësuar Allahut, madje edhe më shumë, dhe thanë: O Zoti ynë! Pse na e bëre

detyrim luftën? Ah, sikur të na e kishe shtyrë edhe për një kohë të shkurtër!”

Ndërkohë, kur jemi te pjesa e fundit e ajetit 20: “Fe evla lehum” - “Por më parësore për ta do të ishte”, këtu kemi dy mendime të dijetarëve lidhur me kuptimin e synuar nga i Madhërishmi. Ajo që s’ka dyshim në të, është fakti se cilido kuptim që të merret, ai përfshin kërcënim hyjnor kundër hipokritëve.

Mendimi i parë të cilin e kemi përzgjedhur nënkupton kërcënim për hipokritët, se më parësore për ta do të ishte nënshtrimi dhe bindja ndaj Allahut dhe një fjalë e mirë e jo prapësia dhe ligësia që e mbajnë në zemra, kurse mendimi i dytë nënkupton kërcënimin e drejtpërdrejtë me fjalët: “Mjerë për ta” apo shkatërrim për hipokritët, për shkak të qëndrimeve të tyre, ashtu siç ka ardhur në formën “Fe vejlun lehum” - “Mjerë për ta”, në suren El-Bekare, ajeti 79, ose siç ka ardhur në suren El-Kijame: ajeti 34: “(Atij do t’i thuhet:) Evla leke fe evla” - “Mjerë për ty, mjerë!”²

21. bindja dhe fjala e mirë! E kur çështja (e luftës) të jetë vendosur, do të ishte më mirë për ta që të jenë të sinqertë ndaj Allahut.

Ky ajet është vazhdimësi e ajetit paraprak, në të cilin Allahu i Madhërishëm qoftë në formë qortimi, apo kërcënimi, ua bën me dije hipokritëve, se bindja dhe fjalët e mira e që nënkupton sinqeritetin në fjalë dhe në vepra, do të ishin më parësore dhe më mirë për ta, se sa mosbindja dhe ligësia që e ushqejnë në zemra ndaj Islamit dhe myslimanëve.

Bindja ndaj Allahut dhe nënshtrimi ndaj urdhrave të Tij, në këtë rast, respektimi i dispozitave që kishin zbritur rreth luftës, do të ishte parësore për secilin mysliman, por këtë, hipokritët nuk e ndjenin në zemër. Ata frikësoheshin për jetët dhe pasurinë e tyre, sepse besimi nuk kishte arritur të zinte vend në zemrat e tyre. Madje, sa për t’i nxitur që të afroheshin me zemër të pastër te Zoti, Ai ua bën me dije që kur të jetë vendosur një



çështje nga Allahu, sikur që ishte në këtë rast lufta kundër idhujtarëve-jobesimtarëve, atëherë do të duhej të respektonin urdhrat e Tij me bindje e sinqerisht, e jo të kurdishnin intriga kundër myslimanëve.

22. Mos vallë, po të kishit pushtet (o hipokritë), nuk do të bënit ngatërresa në Tokë dhe nuk do t'i shkëpusnit lidhjet farefisnore?!

Ky ajet ua zbulon katërçipërisht qëllimet e këqija të hipokritëve, dhe ua shfaq sëmundjen që kanë në zemra, se po t'u jepej mundësia që të kishin sadopak pushtet, atëherë sigurisht se do të ktheheshin sërish si në kohën e injorancës, në atë gjendje që kishin qenë para Shpalljes dhe do bënin ngatërresa e fesat në tokë, si dhe do të shkëputnin lidhjet farefisnore. Me një fjalë, do të ktheheshin në kohën e egërsisë dhe vrazhdësisë së zemrave, ku të dobëtit vriteshin, ku nuk respektohej dinjiteti i femrës, por ajo qysh si foshnjë varrosej për së gjalli, ku nuk respektohej familja në përgjithësi, dhe ku mbretëronte ligji i të fortit.

Shumë komentues të Kuranit, kanë dhënë shenjë se ky ajet ka edhe një kuptim tjetër të dytë. Sipas tyre, fjala “in tevel-lejtum” nuk nënkupton pushtet, por nënkupton refuzimin dhe kthimin e

shpinës ndaj udhëzimit hyjnor, duke ndjekur rrugën e ngatërresave dhe shkatërrimit në tokë.

Në lidhje me kuptimin e këtij ajeti, Katadeja ka thënë: “Ky ajet nënkupton se ekziston frika që nëse ia ktheni shpinën dhe e refuzoni besimin në një Zot, do të ktheheni aty ku ishit më parë e të bëni ngatërresa në tokë, duke derdhur gjak.”²³

Ndërsa Ebu Hajjani ka thënë: “Shihet qartë se ky ajet iu drejtohet hipokritëve në lidhje me çështjen e luftës, që nëse refuzoni t'i bindeni Allahut rreth urdhëresës për luftë të ligjësuar, në mbrojtje të vetes dhe fesë së Allahut, vallë a nuk pritët prej jush diç tjetër përveçse të bëni shkatërrime në tokë. Nëse nuk i ndihmoni myslimanët në luftë, atëherë kjo nënkupton se ju qëllimisht po i shkëpusni dhe po i shkatërroni edhe lidhjet farefisnore...”²⁴

23. Këta janë ata, të cilët Allahu i ka mallkuar, i ka bërë të shurdhër dhe ua ka verbuar shikimin.

Të tillët, me prirje të tilla hipokrite dhe shakajshmërisht armiqësore ndaj Islamit dhe besimtarëve, janë të mallkuar dhe larg mëshirës së Zotit Fuqiptotë. Të tillët që, sapo t'u jepet një çik pushtet, janë të gatshëm të derdhen gjak e të bëjnë fesat nëpër tokë, nuk e meritojnë të jenë nën hijen e mëshirës hyjnore. Për këtë arsye, mallkimi i Allahut të Plotfuqishëm nënkupton se



përveç që janë të larguar nga mëshira dhe kënaqësia e Tij, ata natyrshëm do të jenë të goditur me shurdhëri e verbëri, dhe nuk do të kenë mundësi ta “dëgjojnë” e as ta “shohin” të vërtetën. Këta ndonëse kanë vesh dhe sy me të cilët dëgjojnë e shohin argumentet hyjnore, nuk do të arrijnë të meditojnë rreth tyre.⁵

24. Vallë, pse nuk meditojnë ata për Kuranin apo i kanë zemrat e kyçura?!

Po t’u mos u ishin verbuar sytë e zemrave dhe të mendjeve, hipokritët ndoshta edhe do të përpiqeshin të meditonin pak rreth këtyre argumenteve kuranore, por meqë me dëshirë zgjodhën kundërshtimin e urdhrave hyjnorë, atëherë, kurrë nuk do të arrijnë të gjejnë rrugën e udhëzimit. Thjesht, zemrat e tyre sikur janë mbyllur me dryna, dhe këta dryna nuk lejojnë hapjen e zemrës për të përthithur aromën e besimit. Meditimi rreth Kuranit, atij që i qaset me zemër dhe mendje të hapur, ia heq mbulesën dhe ia zhdavarit çdo perde që mund ta pengojë ta shohë dritën e së vërtetës. Ai që e lexon Kuranin me këtë ndjesi, ai ia ndriçon jetën, ia

Ai që e lexon Kuranin me këtë ndjesi, ai ia ndriçon jetën, ia qetëson zemrën, ia pastron ndërgjegjen dhe jeta e tij vazhdon të pulsojë me një natyrshmëri të pastër, duke u shkrirë në harmoninë e përkryer që ekziston në këtë Univers, ashtu siç e ka krijuar Allahu Fuqiptotë.

qetëson zemrën, ia pastron ndërgjegjen dhe jeta e tij vazhdon të pulsojë me një natyrshmëri të pastër, duke u shkrirë në harmoninë e përkryer që ekziston në këtë Univers, ashtu siç e ka krijuar Allahu Fuqiptotë. Por, ata që në zemra kanë vënë dryna, nuk mund ta shohin e as ta sodisin këtë harmoni kozmike, sepse janë të privuar prej shumë mirësive të Allahut xh.sh., prej dritës dhe udhëzimit të Tij.

POROSIA E AJETEVE (20-24)

- Dallimi ndërmjet besimtarëve të sinqertë dhe hipokritëve është shumë i madh, madje i pakrahasueshëm. Përderisa të parët, prisnin me padurim dhe me mall të zbriste një sure apo edhe një ajet që t’ua lejonte luftën, të dytët urrenin një gjë të tillë, nga frika për jetët dhe pasurinë e tyre. Kjo, sepse ata nuk ishin besimtarë të vërtetë, por në zemrat e tyre të sëmura fshihnin urrejtjen ndaj myslimanëve.

- Allahu xh.sh. nga mëshira e Tij, hipokritëve dhe atyre që nuk besojnë, gjithmonë iu ofron edhe një rast të dytë, që të kthehen, të besojnë dhe të binden në Njëshmërinë e Allahut dhe ringjallen në Ditën e Gjykimit. Megjithatë, hipokritët,

në vend që të besonin me zemër e me mendje, ata vepronin të kundërtën. Jo vetëm që nuk besuan, por edhe u munduan të thurnin intriga ndaj Resulullahut s.a.v.s., kudo që arrinin. Allahu i Madhërishëm duke ditur se ç’semundje kanë në zemra, ua qet në shesh të zezat dhe mendimet e tyre të liga kur iu thotë, se juve po t’u jepej pushtet, sigurisht se do të ktheheshit sërish në kohën e injorancës, duke ligjësuar vrasjet, gjakderdhjen, dhe shkëputjet e lidhjeve fafesisnore.

- Mallkimi i Allahut i përshkon të gjithë ata që mbyllin veshët dhe sytë nga e vërteta, duke u ngritur kundër Fjalës së Zotit dhe duke bërë krime e mizori në Tokë.

- Ata që nuk arrijnë t’i perceptojnë urtësitë e Kuranit dhe të meditojnë rreth tyre, vërtet janë të privuar nga mëshira e Allahut, sepse zemrat i kanë të mbyllura me drynat e kufrit, duke mos lënë të depërtojë në to drita e Imanit. - vijon -

1 Më gjerësisht shih: Sejid Kutb, Fi Dhilali-l Kuran, Kajro-Bejrut, 2003, vëll. VI, f. 3296.

2 Ibn Xhuzej, Et-Tes’hil li ulumi-t-tenzil, Bejrut, 1995, vëll. 2, f. 342.

3 Et-Tefsiru-l Munir, vëll. 26, f. 439.

4 Ebu Hajjan el Endelusi, El-Bahrul Muhit, Bejrut, 1993, vëll. 8, f. 82.

5 Muhamed Mutevel-li es-Sha’ravi, Havatiri havle-l Kurani-l Kerim, Kajro, 1991, f. 14337.

Shkenca e Ilmul Kelamit tek Ehli Suneti

”Ilmul Kelami është shkenca që përmban argumentet rreth çështjeve besimore, duke u mbështetur në argumente logjike (racionale) si dhe demantimin e besimeve të risimtarëve (bidatçinjëve), të devijuara nga medhhebi i Ehli Sunetit” (Ibën Halduni)

Dr. Bahri HOXHA

Ç’ËSHTË ILMUL KELAMI?

Është më se e domosdoshme të flitet për dimensionet e shkencës së akides, Ilmul Kelamit, për të njohur realitetin e kësaj shkençe. Duke e ditur se realiteti i diçkaje paraqitet përmbledhur në një ose më shumë fjali përshkruese që ne e quajmë definicion. Dijetarët e akides kishin interesim të madh rreth studimit dhe hulumtimit më të gjerë edhe në shkencat racionale, siç është shkenca e logjikës, e cila i kushton rëndësi të veçantë çështjes së definimit të gjërave. Prandaj kur dijetarët definojnë shkencën e akides ose kelamit, kanë për objektiv që ai definicion të mos përfshijë diçka tjetër përveç asaj që përmban kjo shkencë, si dhe të mos mbetet jashtë përkufizimit diçka nga ajo që kjo shkencë e studion. Më poshtë do përmendim disa nga definicionet më të njohura nga dijetarë të akides, sociologë dhe studiues islamë:

Adudedin el-Ixhij, e përkufizon Ilmul Kelamin si: “Shkenca, përmes së cilës përfitohet kapaciteti i nevojshëm për të aprovuar çështjet besimore fetare, nëpërmjet parashtrimit të fakteve dhe demantimit të dyshimeve.”¹

Sadudin Teftazani, e përkufizon këtë shkencë si: “Shkenca që studion besimet fetare (islame), duke u bazuar në argumente të prera.”²

Sociologu i shquar islam, Ibën Halduni, i jep kësaj shkençe përkufizimin e tij: “Shkenca që përmban argumentet rreth çështjeve besimore, duke u mbështetur në argumente logjike (racionale), si dhe demantimin e besimeve të risimtarëve (bidatçinjëve), të devijuara nga medhhebi i Ehli Sunetit.”³

Kjo shkencë gjatë kohës u quajt edhe me emra të tjerë që qëndrojnë si sinonime të Ilmul Kelamit, si: Ilmu Tevhid, Ilmul Akideh apo Akaid, El Fikhul Ekber, Ilm Usuli Din etj.

ZANAFILLA DHE ARSYEJA E SHFAQJES

Dijetarët islamë me kohë ishin angazhuar përmes reflektimeve të tyre shkencore në shpjegimin e fesë në përgjithësi dhe besimit në veçanti. Disa nga ta ishin shumë aktivë në përballjen e tyre me disa devijime që shfaqeshin kohë pas kohe në shoqërinë islame, për shkak edhe të zgjerimit të hovshëm, nëpër vise që më parë kishin pasur besime të tjera dhe tradita të ndryshme. Imam Ebu Hanife (v.150) udhëtonte shpesh nëpër qytete asokohe, që t'i demantonte mendimet dhe besimet e gabuara.⁴ Fjalët e Imam Malikut (v.192) rreth temave të ndryshme besimore mbahen mend dhe kultivohen me respekt edhe sot e asaj dite. Imam Shafiu (v.204) njihej për argumentim të fortë në shumë



**Përveç
aprovimit dhe
shpjegimit të
akides që
përmban
Kurani dhe
suneti i
Pejgamberit
a.s., kjo shkencë
merret edhe me
shpjegimin e
formave të
devijimeve që
ndodhën
historikisht nga
grupe të
caktuara, të
cilat i përkasin
në burimin e
tyre besimit
islam, por që
gjatë rrugës
ndodhën
distancime nga
 shumica
përfaqësuese e
spektrit të dijes
së trashëguar
islame.**

çështje akaidore, sa që Imam Bagdadiu (v.428) e konsideronte prej mutekeliminëve të parë bashkë me Ebu Hanifen.⁵ Imam Ahmedi (v.241) në kohën e tij u bë simbol i qëndresës përballë persekutimit mutezilite rreth temës se krijimit ose jo të fjalës së Zotit.

Megjithatë, këta kolosë më shumë merreshin me studimin e çështjeve praktike të fesë,⁶ se sa me ato të detajeve teorike, që shumë prej tyre asokohe nuk shiheshin me sy pranimit, për shkak se mbi këto çështje, nuk sendërtohej ndonjë veprim praktik. Dhe si i tillë, diskutimi rreth temave të tilla teorike, shihej sikur hapje debati për diçka që njerëzit nuk dinin. Njësoj qëndronte puna edhe me meseletë e fikhut.⁷ Asokohe nuk parashtroheshin pyetje hipotetike rreth gjërave që nuk kishin ndodhur njëmend. Edhe po të ndodhte të parashtroheshin pyetje të tilla, shumë prej dijetarëve, nuk përgjigjeshin në to derisa ato të ndodhnin në realitet. Përjashtim bënte shkolla e Imam Ebu Hanifes,⁸ me parashtrimin e pyetjeve hipotetike dhe trajnimin e fukahave rreth përgjigjeve adekuate, për çfarë u bë edhe cak i disa kritikave, për shkak të kundërshtimit të frymës së përgjithshme, e cila rekomandonte një heshtje përveç në pyetjet rreth të ngjarave praktike.

Edhe në rrafshin akaidologjik qëndronte e njëjta situatë. Debatet që do krijoheshin rreth tematikave jo detyrimisht të prekshme për jetën reale të shoqërisë së atëhershme, nuk kishin si të kenë përkrahje, sepse sikur largonte masën e gjerë nga një lloj pragmatizmi praktik në një debat që nuk prodhonte fryt në praktikën ditore. Përjashtim bënin vetëm meseletë mbi të cilat zhvillohej debat i gjerë, qoftë fetar apo politik, siç ishin meseletë në të cilat u mbështetën grupet e mutezilëve, havarixhëve, murxhiave, xhehminjëve, etj. Në situata të tilla, debati ishte i ashpër në shoqërinë islame dhe natyrshëm ndikimi socio-politiko-fetar ishte shumë i theksuar dhe si i tillë donte përgjigje. Në këto raste, shpeshherë debati kishte edhe ndikim

praktik në zhvillimin e ngjarjeve me karakter socio-politik, siç ishte rasti me çështjen e tekfirit nga havarixhët, apo se Kurani është i krijuar apo jo etj.. Për shkak të meselesë së parë u zhvilluan beteja të mëdha, kurse rreth debateve të së dytës, u maltretuan shumë dijetarë.

Në këtë situatë, brenda shoqërisë islame kishin lindur mendime, të cilat mundoheshin të jepnin një shpjegim për parimet e besimit. Në to printe grupi i mutezilës. Ata tashmë ishin shkëputur nga mësimet tradicionale islame dhe në shumë pika nuk kishin mendimet e njëjta me të shumicës islame, që filloi të quhet me termin Ehli Suneti dhe Xhemati. Përpjekjet që i bënin, për të shpjeguar dhe mbrojtur fenë para besimeve të tjera ata i futnin nën shpjegimet e shkencës së Kelamit. Ehli Suneti aty-këtu kundërshtonin këto mendime, siç ishte puna nga katër imamët e njohur dhe të tjerë, por jo në një formë të rregullt shkencore. Derisa në ymet shfaqen dy dijetarë të mëdhenj: Ebu Mensur el-Maturidiu (v.333) dhe Ebul Hasen el-Eshariu (v.324), i pari u bë i njohur në pjesën e Transoksanisë, kurse i dyti në gjithë vendet e Lindjes së Mesme dhe Afrikës. Shpjegimet e tyre u pranuan nga gjithë dijetarët e Ehli Sunetit dhe më pastaj u përcollën gjeneratë pas gjenerate, duke formuar kështu dy shkolla të mendimit dhe shpjegimit autentik të besimit islam, të cilat edhe sot e asaj dite përfaqësojnë shumicën e myslimanëve.

SHKENCË E TEORISË

Kjo shkencë studion vetëm çështjet besimore fetare dhe nuk ka të bëjë me çështjet, apo obligimet praktike fetare, ritet e ndryshme, etj.. Ato parime besimore fetare që studion Ilmul Kelami paraqesin parimet bazike, kryesore në fe, në rend të parë dhe pastaj çdo çështje besimore që është e vërtetuar me argumente fetare në Islam. Pra, studion, konfirmon dhe proklamon çdo çështje besimore islame, pa

marrë parasysh nëse konfirmimi i saj është nga parimet bazë, apo nga çështjet dytësore në akiden islame.

Përveç aprovimit dhe shpjegimit të akides që përmban Kurani dhe suneti i Pejgamberit a.s., kjo shkencë merret edhe me shpjegimin e formave të devijimeve që ndodhën historikisht nga grupe të caktuara, të cilat i përkasin në burimin e tyre besimit islam, por që gjatë rrugës ndodhën distancime nga shumica përfaqësuese e spektrit të dijes së trashëguar islame.⁹

Përderisa tematika e kësaj shkence është aspekti teorik i besimit të drejtë, nuk mund të mos merret edhe me format e tjera të praktikumit ideologjik dhe fetar të gjendura përkrah besimit të drejtë, të cilin e përfaqëson, shpjegon dhe e ofron te njerëzit. Prandaj kjo shkencë studion edhe fetë e tjera, pikat e përbashkëta dhe ato ndarëse. Fillimisht me besimet monoteiste, për të vazhduar pastaj me çdo formë të aplikimit të besimit politeist.

Arsyeja e prezencës së disa temave që në fakt kanë të bëjnë me fikhun, në literaturën e Ilmul Kelamit, është pikërisht për shkak të faktit se grupe të caktuara u bënë të njohura me praktika fetare të caktuara, përmes së cilave definimi dhe njohja e tyre do të ishte më e lehtë, siç është meseleja e zgjedhjes së udhëheqësit, apo mes'hi mbi meste etj.. Por çështje të tilla janë të rralla në këtë shkencë.

SHKENCË E THIRRJES

Kur kemi parasysh tematikën e kësaj shkence dhe qëllimet e saja, se janë të ndërlidhura ngushtë me sqarimet e nevojshme rreth çështjeve të besimit, atëherë del në pah një segment tjetër po ashtu shumë i rëndësishëm rreth asaj se cilat nga parimet fetare duhen të sqarohen fillimisht para masave, qofshin ato islame apo joislame, në mënyrë që njerëzit ta kenë të qartë se çfarë në të vërtetë është Islami dhe cilat janë themelet kryesore të tij. Nga këtu duhet ta dimë se pikërisht çështjet e besimit janë ato që u paraprijnë të gjitha çështjeve të tjera brendapërbrenda fesë, si në aspektin e thirrjes në to, mësimit të tyre apo kuptimit dhe interpretimit. Pejgamberi a.s. kur dërgoi Muadhin në Jemen, e porositi që të ftonte para së gjithash me besimin në Zot.¹⁰

Prandaj themi se përderisa besimi është pika fillestare njohëse me Islamin, atëherë edhe kuptimi i drejtë dhe origjinal i këtyre parimeve besimore, mbetet të jetë kreu i shpjegimit fetar para masave. Shkenca e besimit merret me ofrimin e shpjegimeve të nevojshme rreth parimeve besimore te njerëzit.

Duke pasur parasysh se jo çdo aspekt i fesë ka të njëjtën thjeshtësi në të kuptuar, natyrshëm mund të lindin keqkuptime të caktuara në disa aspekte të studimit fetar, atëherë pikërisht shkenca e Kelamit ndërhyr që të demantojë



ato keqkuptime apo dyshime. Bile, disa dijetarë e kanë menduar që pika e dallueshmërisë së shkencës së Kelamit nga emërtimet e tjera të po kësaj shkence, qëndron pikërisht se Kelami merret me demantimin e dyshimeve dhe keqkuptimeve që mund t'i mveshen akides së pastër islame.¹¹

Përforcimi i ligjërimit fetar me argumente fetare dhe logjike (gjë që e bën Ilmul Kelami) është obligim i patjetërsueshëm fetar.

që përdoren për të ushqyer atë që ne quajmë “imani i plakave”.¹⁵ Njerëzit e këtij niveli me të drejtë nuk pranojnë të flitet në këtë formë. Ata janë të vetëdijshëm se para vetës kanë dhjetëra mijëra besime dhe ideologji në botë. Në gjithë këtë vorbull mendimesh, besimesh e besëtytnish, është më se e drejtë të kërkojnë argumente bindëse rreth formës së saktë të besimit. Po që se shkollarët islamë do të mjaftoheshin

METODOLOGJIA NË ARGUMENTIM

Ilmul Kelami mbështet fort parimet besimore, në argumente të prera fetare dhe logjike. Me argument fetar është për qëllim, çdo argument tekstual islam, siç janë ajetet e Kuranit famëlartë, si dhe hadithet e vërteta të Pejgamberit a.s.. Argumenti logjik vije përkrah argumentit fetar, e mbështet atë nga pozicioni i tij, në çështjet studimore ku posedon kapacitet. Ky lloj i argumentimit është më se i nevojshëm në shumë prej çështjeve akaidore, sidomos në rastet kur bashkëbiseduesi nuk është në pozitë të mundësisë së pranimit të argumentit tekstual fetar, për shkak se i përket një besimi tjetër,¹² ose në rast të parashtrimi të një nevoje ku argumenti logjik mund të jetë një mbështetës i fortë dhe përcaktues i domosdoshëm për një kuptim të mirëfilltë të vetë tekstit nga Kurani ose hadithi profetik.

Pastaj, përderisa struktura intelektuale e shoqërisë në përgjithësi u takon niveleve të ndryshme dhe në mesin e shoqërisë gjejmë njerëz me nivel të thjeshtë deri tek ata që janë ajka e mendimit shkencor, filozofik dhe fetar, atëherë Ilmul Kelami, sugjeron forma adekuate të shpjegimit fetar, komfor nivelit të masës. Masave të gjera, që në fjalorin fetar njihen me termin “avvam”, nuk u flitet me argumentet e thella fetare e dialektike, sepse ngjallja e hutisë mund të jetë pjesë e dëmit të shkaktuar. Siç thoshte Ibën Mesudi dhe Aliu r.a.: “Komunikoni me njerëzit në bazë të kapacitetit të tyre! A mos dëshironi që të përgënjeshtrohet Allahu dhe i Dërguari i Tij?”¹³ Pikërisht ky ishte edhe qëllimi pse Huxhetul Islam, El-Gazali, shkroi një libër rreth kufijve të shpjegimit shkencor-akaidologjik para masave të gjera – avvami.¹⁴

Përderisa kështu qëndron puna me shtresat e thjeshta përball shpjegimeve të kësaj shkence, realiteti nuk është i njëjtë edhe me shtresat akademike, të cilat janë të kalitura në hulumtim shkencor, mbi parime logjike. Niveli intelektual nuk pranon të komunikohet përmes metodave

vetëm me paraqitjen e parimeve besimore para spektrit intelektual, pa mos dhënë bashkangjitur edhe argumentet logjike rreth saktësisë së asaj që thërrasin në të, padyshim se një gjë e tillë do ishte mos përmbushje e misionit të shpjegimit dhe qartësisë të mirëfilltë të fesë islame. Pastaj, shumica e argumentimit islam duhet të përqendrohet pikërisht në saktësinë e parimeve bazë të besimit, sepse dyshimet janë kryesisht në saktësinë e besimit si tërësi, pastaj kur ata binden, mbështetja e tyre në aspektin logjik del të jetë më pak e nevojshme. Megjithatë, historikisht dijetarët e Islamit në shpjegimet e tyre edhe rreth rregullave të fikhut, nuk lënë anash së përmenduri edhe argumentimin logjik, menjëherë pas argumentimit fetar. E gjithë kjo praktikë, vërteton edhe më shumë se argumenti logjik nuk është armik i argumentimit fetar (siç është mbjellë te një pjesë e masës islame), porse qëndron përkrah tij, si mbështetës edhe në rregullat e hallallit dhe haramit.

MËDYSHJET RRETH KËSAJ SHKENCE

Nisur nga vetë definicionet me të cilat është përkufizuar shkencën e Kelamit, të cilat, me gjithë dallueshmërinë që mund ta kenë në mes vete, ato në përgjithësi, pajtohen në dy pika kryesore. Të dy këto pika, në fakt paraqesin dy detyrat ose qëllimet primare që synon Ilmul Kelami. E para është se Ilmul Kelami detyrë parësore ka shpjegimin e besimit të drejtë të bazuar në librin e Zotit dhe në sunetin e vërtetë të Muhamedit a.s.. Dhe segmenti tjetër që synon Ilmul Kelami është demantimi i dyshimeve të ardhura në adresë të besimit të drejtë islam, si dhe largimin e çdo keqkuptimi që mund të ndodh gjatë leximit ose praktikimit të këtij besimi.

Pastaj, nisur nga tematika kryesore që shtjellon dhe studion kjo shkencë, të cilën e kemi shpjeguar sipër se është besimi në Zotin xh.sh., Cilësitë e Tij (Ilahijat) etj., nuk mund të supozohet ekzistenca e një mendimi serioz

e aq më pak islam, në bazë të të cilit mund të flitet pastaj për kontestimin e vetë studimit të kësaj shkence sublimë në fenë islame.⁶¹

Edhe kur kihet parasysh natyra e besimit në raport me gjithë strukturën tjetër të fesë, e cila natyrë përkufizohet në këtë raport si themeli me pjesën tjetër të ndërtesës, haptas dhe me gjithë mend mund të konkludohet se përforcimi i ligjërimin fetar me argumente fetare dhe logjike (gjë që e bën Ilmul Kelami) është obligim i patjetërsueshëm fetar.

Nëse gjithë kësaj i shtojmë faktin se, në shoqërinë islame filluan të shfaqen mendime të gabuara, të cilat edhe pse disa nga to, ishin shfaqur me qëllim të mbrojtjes së besimit islam në rrafshin ideologjik, ato nuk kishin kualitetin e duhur për të arritur qëllimin, si në anën e mbështetjes në argumentet tekstuale, ashtu edhe në balancimin e raportit tekst – mendje, kështu që u ndie nevojë imediate që temat që shtjellon Ilmul Kelami të analizohen nga kolosë islamë të Ehli Sunetit, si drejtimi më autokton dhe më përfaqësues i ymetit islam. Prandaj edhe gradualisht shfaqen pozicionet kelamiste autoktone nga katër imamët, duke u zgjeruar pastaj në shpjegime të mëtutjeshme nga nxënësit e tyre dhe nxënësive të tyre, derisa në fakt formulohen shkolla të studimit autokton akaidologjik nga Ehli Suneti.

Pra, fjalët e disa dijetarëve¹⁷ që hedhin dyshim në shkencën si tërësi, duhet të shihen si kundërshtim ndaj rezultateve që dolën nga keqinterpretimi mutezilët, i cili në emër të kësaj shkence parashihte parime të vendosura nga mendja në kundërshtim me tekstin islam nga Kurani dhe suneti. Mirëpo, ata që njohin fushën e besimit, janë të vetëdijshëm se përmbajtja e shkencës tek Ehli Suneti është shumë e kundërt me përmbajtjen e saj që e gjejmë te fraksionet. Dhe natyrshëm, në çështje si kjo, mund të konkludojmë parimin rreth të cilit ishin unikë dijetarët islamë se, përmbajtja është e rëndësishme dhe jo emërtimi.

Me një kundërshtim të ngjashëm ndaj konkluzave të fraksioneve, atyre kritikave u bashkëngjitet edhe Ilmul Kelami sunit, veçse jo nga jashtë, por përmes debatit të zhvilluar brenda mureve të kësaj shkence. Kështu e kuptojmë se të gjithë imamët ishin të unifikuar në këto konstatime, ani pse ndryshojnë qasjet e tyre. Këtë e përforcon fakti se pas akuzave për Kelamin mutezilët, vetëm një shekull më vonë themelohet shkenca e Kelamit sunit, e bazuar në Kuran dhe sunet. Përndryshe nuk mund të perceptohet assesi se shkenca që shpjegon akiden e pastër islame dhe kujdeset rreth flakjes së dyshimeve të konsiderohet diçka e ndaluar në fe, e aq më pak, ky të jetë një mendim i dijetarëve tonë të njohur.

Imam Karafi, në librin e tij “Edh-Dhekhireh” përmend keqkuptimin e fjalëve të Imam Shafiu rreth ndalimit të kësaj shkence, dhe thotë: “Njëri nga shafitët më tha: Fjala

e Imam Shafiu se do t'i dënonte ata që merren me Kelam, tregon se në medhhebin shafi është e ndaluar të merremi me shkencën e Usuli Dinit.” Thash: Jo, nuk është ashtu, sepse mutekeliminët e sotëm janë Eshariu dhe nxënësit e tij. Nuk janë asnjë nga ata që i kishte bashkëkohës Shafiu. Shafiu kishte për qëllim Amr bin Ubejdin dhe të humburit nga devijantët e mutezilës, që jetonin në atë kohë. Edhe ne, sikur Imami, kemi të njëjtin qëndrim. Kurse dijetarët tonë që me argumente ndihmojnë fenë e Zotit, duhet të respektohen e të nderohen për shkak se i dalin zot ymetit në një nga farzet kifaje, sepse ymeti ka ixhma rreth detyrueshmërisë së argumentimit rreth besimit në Zot.” Pastaj ai më tha: “A nuk mjafton vetëm Libri i Allahut dhe suneti i të Dërguarit a.s.?” Unë i thash: “Si do të përpiloje argumentin ndaj atij që nuk i beson Kuranit dhe sunetit?!” Atëherë ai heshti.”¹⁸

Pra, dijetarët në çdo kohë vazhduan të merren me shkencat islame në përgjithësi, e në mesin e tyre edhe me shkencën e Kelamit – akaidin. Ata shkruan tituj të shumtë rreth tematikave të kësaj lëmi, e zhvilluan këtë shkencë, e përparuan, e pajisen me argumentim të palëkundur, nga Libri dhe arsyeja, në mënyrë që Fjala e Allahut të lartësohet.

- 1 El Ixhij, Abdurrahman bin Ahmed, “El Mevakif fi Ilmil Kelam”, Alemul Kutub, Bejrut, f.7.
- 2 Teftazani, Mesud bin Omer, “Sherhul Mekasid”, f.165.
- 3 Ibën Halduni, ... f. 458.
- 4 Shih: Shibli Numani, Ebu Hanifa jeta dhe vepra, 2013, Prishtinë, f. 119.
- 5 Shih: Usulud Din, Abdul Kahir El Bagdadij, 1928, Stamboll, f. 308.
- 6 Fakti se të katër medhhebet e fikhut emërtohen me emrat e tyre është dëshmuar i qartë, se angazhimi primar i tyre ishte në fikh.
- 7 Shih: Kavaidul akaid, El Gazalij, 1985, Alemul kutub, bot 2, f. 98.
- 8 Shih: El Ihtijar li talilil muhtar, El Musilij, 2009, tahkik: El Minshawi, Darul Hadith, f. 9.
- 9 Në mesin e fraksioneve hasim në fraksione që dallojnë nga shumica islame me disa qëndrime, porse nuk shkëputën tërësisht nga të qenët nën ombrellën e përgjithshme të Islamit, siç janë mutezilët etj.. Kurse lloji tjetër i fraksioneve ani pse mundohen të mbajnë një lidhje me Islamin, kanë qëndrime që bien ndesh me akiden islame në çështje kryesore dhe si të tilla nuk konsiderohen të jenë nën ombrellën islame, siç janë disa fraksione batinish, ismailitët, karamitët etj.
- 10 Shih: El Buhari (1496) dhe Muslimi (19).
- 11 Shih: Levamiul envar ve sevatiul esrar, Muhamed bin Sefarini el Hanbeli, pj 1, f.4-5.
- 12 Shih: Edh Dhekhireh, Shihabudin El Karafij, 1994, Darul Garb el Islamij, pj.13, f.244.
- 13 Buhari (127) dhe Muslimi.
- 14 Dhe këtë libër e titulloi “Ilxhamul avvam an ilmil Kelam”, ku sqaron cilat janë pikat kryesore që avvami duhet t'i kenë të qarta në këtë aspekt...
- 15 Disa njerëz, padrejtësisht përdorin, bindjen e njerëzve të thjeshtë, si kundër argument për mos të hulumtuar në argumentet e besimit islam.
- 16 Shih: Buhuthun fi ilmil kelam, Seid Fodeh, f.15.
- 17 Transmetohet nga Imam Shafiu dhe disa dijetarë të tjerë që kritikojnë ashpër marrjen me këtë shkencë, e që në fakt kishin për qëllim mutezilët e kohës, sepse Ehli Suneti atëbotë ende nuk ishte formuar shkencën e mbrojtjes së akides islame, siç përmendet edhe në tekst.
- 18 Edh Dhekhireh, 1994, pj.13, f.244.

Hadithet që iu atribuan Muhamedit a.s. nga brezi që atë nuk e takoi

Qëndrimi i ylemave rreth argumentimin me hadithin mursel

Dr. Flamur SOFIU

HYRJE

Dihet shume qartë se Kurani fisnik dhe suneti i Pejgamberit a.s. janë dy burime parimore të Sheriatit islam, por Kurani dallon nga suneti i Pejgamberit a.s. në aspektin e transmetimit të ne, ngase është i transmetuar i tëri në mënyrë shumë të besueshme e të pashkëputur (tevaturen) dhe se nuk ka kurrfarë dileme rreth mënyrës së transmetimit të tij. E sa i përket sunetit, e shohim se ka prej haditheve që janë të transmetuara në mënyrën e besueshme (tevaturen) dhe në formën individuale (ahad). E sa i përket hadithit që është ahad, ai ndahet parimisht në tri grupe:

1. Ato hadithe që sipas unanimitetit pranohen si argumente;
2. Ato hadithe që sipas unanimitetit nuk pranohen si argumente;
3. Ato hadithe që ka divergjencia për pranimin dhe mospranimin e tyre si argument. E në këtë grup të haditheve bënë pjesë edhe hadithi mursel.

DEFINICIONI I HADITHIT MURSEL

Sipas dijetarëve të hadithit, hadithi mursel definohet kështu: “Hadithi mursel konsiderohet ai transmetim i tabiiut drejtpërsëdrejti nga Pejgamberi a.s., duke mos përmendur në hallkën e zinxhirit të transmetimit sahabiun dhe duke thënë (tabiiu): se Pejgamberi a.s. ka thënë kështu.”¹

Dijetarët e usulit, hadithin mursel e definojnë kështu: “Hadith mursel sipas usulistëve² është që transmetuesi i këtij

“Hadithi mursel konsiderohet ai transmetim i tabiiut drejtpërsëdrejti nga Pejgamberi a.s., duke mos përmendur në hallkën e zinxhirit të transmetimit sahabiun dhe duke thënë (tabiiu): se Pejgamberi a.s. ka thënë kështu.”

hadithi, i cili nuk e ka takuar Pejgamberin a.s. të thotë: “ka thënë Pejgamberi a.s.,” pavarësisht se ky hadith është munkat’i,³ muadal⁴ apo mu’alek⁵.”

Imam Sejfidin el-Amidiju e definojnë hadithin mursel kështu: “Kur transmetuesi i cili nuk e ka takuar Pejgamberin a.s. është i drejtë thotë se Pejgamberi a.s. ka thënë.” Ky është definimi i hadithit mursel sipas Amidijut.⁶

Imam Shevkani, në librin e tij “*Irshad el fuhul*” ka thënë: “Shumica e dijetarëve të usulit thonë se hadith mursel konsiderohet transmetimi i atij, i cili nuk e ka takuar Pejgamberin a.s., por që thotë se Pejgamberi a.s. ka thënë, pavarësisht se këtë e transmeton tabiiu, tebetabiiu apo dikush tjetër pas tyre.”⁷

Në definicionin që i japin dijetarët e hadithit, hadithit mursel, e bëjnë të qartë se kushdo që argumenton me hadithin mursel, ai në të njëjtën kohë argumenton me hadith maudal⁸ dhe munkati⁹. Ndërsa në definicionin e dijetarëve të usulit vërehet qartë se te hadithi mursel e përfshijnë edhe hadithin munkati dhe muadal.

NDARJA E HADITHIT MURSEL

Autori i librit “*Mir’at el usul*” përmend se hadithi mursel sipas fukahave dhe usulistëve ndahet në katër grupe:

- a. Hadithi mursel që e transmeton sahabiu;
- b. Hadithi mursel që e transmeton tabiiu dhe tebetabiiu;
- c. Hadithi mursel që e transmeton transmetuesi i drejtë i cilësdo kohë qoftë;

ç. Hadithi mursel që e transmetojnë dy transmetues, secili me rrugë të transmetimit në vete, ose që e transmeton një transmetues më dy rrugë të transmetimit.¹⁰

ARGUMENTIMI ME HADITHIN MURSEL

Sipas ixhmainit, hadithi mursel i transmetuar nga sahabiu duhet të merret si argument.¹¹

Sa i përket hadithit mursel që e transmeton dikush tjetër përveç sahabiut, dijetarët ndajnë këto mendime:

1. Ebu Hanife r.a., imam Ahmedi r.a., Maliku r.a. dhe shumica e mutezilitëve janë të mendimit se hadithi mursel duhet të konsiderohet si burim i Sheriatit.¹² Disa prej dijetarëve hanefitë, hadithin mursel e marrin si argument vetëm nëse është transmetuar prej tri gjeneratave të njohura (sahabët, tabiinët dhe tebetabiinët), ndërsa prej tjerëve pas tyre jo.¹³ Disa prej dijetarëve mutezilitë, hadithin mursel e konsiderojnë si më të fortë në argumentim se sa hadithin musned, dhe se kur vijnë në mospajtime ndërmjet vete, përparësi në argumentim i japin hadithit mursel.¹⁴

Hanefitë, mendimin e tyre e mbështesin në këto argumente:

a. Në ixhmain e sahabëve – Sahabët kanë pranuar transmetimet e shumta nga Ibën Abasi r.a., e i cili shumë pak ka dëgjuar prej Pejgamberit a.s.;

b. Në ixhmain e tabiinëve – Tabiinët kanë pranuar shumë hadithe mursele nga disa tabiinë të njohur si: Seid bin Musejbi, Ibrahim en-Nehiju, Hasen el-Basriu etj. Transmetimet e tilla vazhdimisht kanë qenë të njohura në

mesin e sahabëve dhe tabiinëve pa u kundërshtuar nga askush.

c. Në argumente logjike – Kur transmetuesi i drejtë dhe i sinqertë thotë se Pejgamberi a.s. ka thënë kështu, atëherë nuk mbetet diçka tjetër pos që të pranohet ai. E nëse transmetuesi tradhton në transmetim, atëherë ai nuk konsiderohet i besueshëm dhe se hadithi i tillë është i kategorisë së musnedit.¹⁵

2. Ibnul Haxhibi dhe Ibnul Humame mendojnë se hadithi mursel duhet të pranohet po që se transmetohet nga dijetarët që janë të përpiktë në transmetim. Sipas Taxhudin es-Subkit, dijetarët që janë të përpiktë në transmetim konsiderohen sahabët, tabiinët dhe tebetabiinët.¹⁶ Këta mendimin e tyre e mbështesin në argumentin logjik që është përmendur më herët.

3. Isa bin Eban e pranon hadithin mursel nëse është transmetuar nga sahabët, tabiinët dhe tebetabiinët, pavarësisht se a transmetohet hadithi mursel prej dijetarëve të përpiktë në transmetim apo nga të tjerët.¹⁷ Ky dijetar, mendimin e vet e mbështet në hadithin e Pejgamberit a.s., i cili thotë: “Më e mira gjeneratë është kjo që jetoj unë, e pastaj ata që vijnë pas tyre, e pastaj ata të cilët vijnë pas tyre, e mandej do të përhapet gënjeshtra.”¹⁸

4. Imam Sejfuddin el-Amidiju përkrah mendimin se hadithi mursel duhet të pranohet si argument nëse transmetuesi është i drejtë.¹⁹

5. Imam Shafiu r.a. është i mendimit se hadithi mursel duhet të merret për argument nëse e plotëson njërin prej këtyre kushteve:

a. Nëse hadithi mursel është i transmetuar nga ndonjë sahabiu;

b. Nëse hadithi mursel është i transmetuar nga tabiinët e njohur, të cilët kanë takuar shumë sahabë të Pejgamberit a.s. si f.v. Seid bin Musejbi, Zuhejri etj.;

c. Që kuptimi i hadithit mursel të forcohet më ndonjë hadith që senedi i tij rrjedh nga Pejgamberi a.s.;

ç. Nëse hadithi mursel është i pëlqyer nga fjala e ndonjë sahabiu;

d. Nëse hadithin mursel e pranojnë apo e pëlqejnë shumica e dijetarëve;

e. Nëse hadithi mursel është transmetuar në një rrugë tjetër të transmetimit edhe nëse prapë hadithi i tillë është mursel;

ë. Nëse është hadithi mursel i pranuar sipas mendimit së shumicës së dijetarëve;



f. Nëse transmetuesin e hadithit mursel e shoqërojnë në transmetim hafidhat e hadithit dhe nuk e kundërshtojnë transmetimin e tij;

g. Nëse transmetuesi i hadithit mursel nga i cili transmetohet hadithi është i besueshëm.²⁰

Nëse hadithi mursel nuk e plotëson njërin prej këtyre kushteve të përmendur, atëherë sipas Shafiut r.a., hadithi i tillë nuk merret si argument, por refuzohet.

5. Dhahiritë dhe shumica e muhadithinëve,²¹ janë të mendimit se hadithi mursel nuk duhet të merret si argument. Këta, mendimin e tyre e arsyetojnë duke thënë:

- kur transmetuesi nga i cili po transmetohet është i panjohur, atëherë mosnjohja e tij sjell atë që të mos njihen atributet e tij, e mos njohja e gjendjes së transmetuesit është shkak që të mos pranohet transmetimi;

- nëse hadithi mursel pranohet si argument, atëherë duhet të pranohet edhe në kohën tonë, ngase shkakun (i'letin) e kanë të përbashkët në çështjen e pranimit;

- nëse pranohet hadithi mursel, atëherë nuk ka vlerë senedi.²²

6. Imam Muslimi r.a. nuk pranon argumentimin me hadith mursel.²³

Shembuj të ndikimit të mospajtimeve rreth argumentimit të hadithit mursel në çështjet e jurisprudencës islame

Mospajtimit rreth argumentimit me hadithin mursel ndikojnë në marrjen e vendimeve në jurisprudencën islame si p.sh.:

Çështja e prishjes së abdestit duke qeshur me zë të lartë në namaz. Hanefitë janë të mendimit se të qeshurit me zë të lartë në namaz e prish abdesin, duke u bazuar në hadithin mursel ku Pejgamberi a.s. e kishte urdhëruar një njeri të përsëriste abdesin pasi kishte qeshur me zë të lartë në namaz. Ndërsa shafitët dhe shumica dërmuese janë të mendimit se nuk prishet abdesi kur ndodh të qeshet me zë të lartë në namaz, ngase nuk pranojnë të veprojnë me hadithin mursel.²⁴

Çështja e obligimit të zëvendësimit të agjërimit kur ndodh që të prishet agjërimit vullnetar. Hanefitë dhe malikitë janë të mendimit se ai që e prish agjërimit vullnetar duhet doemos ta zëvendësoj atë ditë, duke mbështetur në hadithin mursel, ku Aisheja r.a. tregon: “Unë dhe Hafsa ishim duke agjëruar agjërimit vullnetar dhe ne na erdhi ushqim si dhuratë, e ne prishem agjërimit. Në atë moment hyri te ne i Dërguari a.s. dhe Hafsa nxitoi para meje dhe e pyeti atë për çështjen e prishjes së agjërimit tonë.” Ai u përgjigj: “Zëvendësoni agjërimit e tillë me një ditë tjetër.” Imam Shafiut dhe pjesa dërmuese e dijetarëve nuk pranojnë që është obligim

zëvendësimi i agjërimit vullnetar, ngase nuk punojnë me hadithin mursel.²⁵

- 1 Dr. Vehbete Zuhajli, Usulul fikhil islamijj, botimi i II, boton “Darul Fikri”, Damask, 1418/1998, vol. I.fq. 373; krahaso: Abdul Kadir Ahmed bin Bedrani, El-Med’halu lla Medh’hebil Imam Ahmed, boton “El-Muniriye”, pa vit botimi, fq. 43; krahaso: Muhammed Ebi Beker bin Kajjim el-Xhevziju, E’alamul Muki’ine, botimi i I, boton: “Es-Se’adetu”, 1374 h. vol. I. fq. 30; krahaso: Ibën Kuddame, Reudatu En- Nadhir , vol.I. fq. 281-327; krahaso: Dr. Mustafa Se’idul Hinn, Etherul Ihtilafi Fil Kava’idil Usulijjeti Fi Ihtilafil Fukahai, botimi i VI, boton “Muesseseturr-Rrisaleti” , Bejrut, 1417/ 1996, fq. 397.
- 2 Po aty; krahaso: Se’adud-Din Mes’ud bin Umer et-Teftazani esh-Shafi’i, Et-Telvihu Alet-Tevdih, botimi i I , boton “Darul Kutubil l’lmijjeti”, Bejrut, 1416/1996, vol.II. fq. 14-15
- 3 Munkat’i quajmë atë hadith, në senedin e të cilit ka ra një transmetues, ose është cekur ndonjë transmetues i panjohur.
- 4 Muad-dal quajmë hadithin në senedin e të cilit kanë rënë dy transmetues njëri pas tjetrit.
- 5 Mual-lak quhet hadithi, në fillim të senedit të të cilit kanë rënë një, dy a më shumë transmetues njëri pas tjetrit.
- 6 Sejfuddin Ebil Hasen Alij bin Ebi Alijj bin Muhammed el-Amidijji, El-Ihkam Fi Usulil Ahkam, boton “Darul Fikri”, 1416/1996, Bejrut, vol. I-II. fq. 276.
- 7 Dr. Mustafa Se’idul Hinn, Etherul Ihtilafi Fil Kava’idil Usulijjeti Fi Ihtilafil Fukahai, botimi i VI, boton “Muesseseturr-Rrisaleti” , Bejrut, 1417/ 1996, fq. 398.
- 8 Shiko fusnotën nr. 4
- 9 Shiko fusnotën nr. 3.
- 10 Muhammed bin Feramuz i njohur si Munlahuseu, Mir’atul Usuli Fi Sherhi Mirkatil Vusuli, Stamboll, pa vit botimi. pjesa e II, fq. 20-21
- 11 Muhammed bin Feramuz i njohur si Munlahuseu, Mir’atul Usuli Fi Sherhi Mirkatil Vusuli, Stamboll, pa vit botimi. pjesa e II, fq. 21; krahaso: Dr. Vehbete Zuhajli, Usulul Fikhil Islamijj, botimi i II, boton “Darul Fikri”, Damask, 1418/1998, vol. I.fq. 474.
- 12 Dr. Vehbete Zuhajli, Usulul Fikhil Islamijj, botimi i II, boton “Darul Fikri”, Damask, 1418/1998, vol. I.fq. 474 krahaso: Dr. Mustafa Se’idul Hinn, Etherul Ihtilafi Fil Kava’idil Usulijjeti Fi Ihtilafil Fukahai, botimi i VI, boton “Muesseseturr-Rrisaleti” , Bejrut, 1417/ 1996, fq. 401; krahaso: Abdul Aziz el-Buhari el-Hanefijj, Keshful Esrari Sherh Usulil Bezdevijj, 750 h. vol. III. fq. 5.
- 13 Dr. Sami bin Alijj eth-Thekafijji, Esbabu Ihtilafil Fukahai, botimi i I, boton “Darul Bejani” Kairo, 1416-1996, fq. 224; krahaso: Dr. Mustafa Se’idul Hinn, Etherul Ihtilafi Fil Kava’idil Usulijjeti Fi Ihtilafil Fukahai, botimi i VI, boton “Muesseseturr-Rrisaleti” , Bejrut, 1417/ 1996, fq. 401.
- 14 Dr. Vehbete Zuhajli, Usulul Fikhil Islamijj, botimi i II, boton “Darul Fikri”, Damask, 1418/1998, vol. I.fq. 474 krahaso: Dr. Mustafa Se’idul Hinn, Etherul Ihtilafi Fil Kava’idil Usulijjeti Fi Ihtilafil Fukahai, botimi i VI, boton “Muesseseturr-Rrisaleti” , Bejrut, 1417/ 1996, fq. 401; krahaso: Abdul Aziz el-Buhari el-Hanefijj, Keshful Esrari Sherh Usulil Bezdevijj, 750 h. vol. III. fq. 5.
- 15 Dr. Vehbete Zuhajli, Usulul Fikhil Islamijj, botimi i II, boton “Darul Fikri”, Damask, 1418/1998, vol. I.fq. 476.
- 16 Po aty fq. 474
- 17 Po aty fq. 475.
- 18 Transmetojnë Buhariu, Muslimi, Nesaiju, Ahmedi, Darimiju dhe Maliku.
- 19 Sejfuddin Ebil Hasen Alij bin Ebi Alijj bin Muhammed el-Amidijji, El-Ihkam Fi Usulil Ahkam, vol. I-II. fq. 272.
- 20 Muhammed bin Idris esh-Shafijj, Err-Rrisaletu, boton “El-meketebetul lilm’ijjeti”, fq. 462-464; krahaso: Dr. Vehbete Zuhajli, Usulul Fikhil Islamijj, vol. I.fq. 475; krahaso: El-Imamu Muhammed Ebu Zehre, Usulul Fikh, fq. 102-103; krahaso: Muhammed bin Feramuz i njohur si Munlahuseu, Mir’atul Usuli Fi Sherhi Mirkatil Vusuli, pjesa e II, fq. 21-22; krahaso: Dr. Mustafa Se’idul Hinn, Etherul Ihtilafi Fil Kava’idil Usulijjeti Fi Ihtilafil Fukahai, fq. 398-299; krahaso: Dr. Sami bin Alijj eth-Thekafijji, Esbabu Ihtilafil Fukahai, fq. 224.
- 21 Dr. Vehbete Zuhajli, Usulul Fikhil Islamijj, vol. I.fq. 477
- 22 Dr. Vehbete Zuhajli në librin e tij: Usulul Fikhil Islamijj, vol. I. fq. 475.
- 23 Sahihul Muslim, vol.I-II, fq. 30.
- 24 Etherul Ihtilaf fil Kavaidil Usulijjeti fq. 356.
- 25 Po aty.

Sunetet e ushqimit dhe pijes në Islam dhe rregullat etike të tyre

Pikëpamja e myslimanit për gjërat nuk është e njëjtë me pikëpamjen e të tjerëve. Ai gjithmonë i lidh veprimet e tij me Zotin e Madhëruar. Andaj, ai nuk e bën ushqimin dhe pirjen e tij një çështje rutine, por ai e bën nijetin e tij në këtë ushqim dhe pije për Zotin dhe synon që më të ta forcojë trupin në bindje ndaj Tij.

Dr. Ilmije KUQI

Zoti i Plotfuqishëm ligjësoi mësimet e Islamit, rregullat dhe etiken e tij, për të organizuar të gjitha çështjet e jetës së njeriut dhe për të ngritur sjelljen e individit dhe shoqërisë, në adhurim, ushqim, pije, veshje, martesë dhe aspekte të tjera të jetës. Ai ka sjell një sistem edukativo-moral që kontrollon sjelljen e myslimanit me një shkallë të ndjeshme në të gjitha aspektet e jetës së tij. Në mesin e këtij sistemi edukativo-moral është edhe çështja e ushqimit dhe pijes. Edhe ngrënia, edhe pirja kanë rregulla etike islame, që duhet t'i ndjekë myslimani. Ne e dimë se vendet dallohen nga etika e mirësjelljes dhe ato mund të ndryshojnë sipas ndryshimit të kohërave. Por, ajo që e dallon atë etikë që e ka vendosur Islami, është se ajo është një etikë e përgjithshme, e qëndrueshme, në të gjitha vendet dhe në të gjitha kohërat. Prandaj, shtrohet pyetja: Cila është etika që solli Islami për të kontrolluar sjelljen e myslimanëve në tavolinat e ushqimit dhe pijeve? Apo më fjalë të tjera, cilat janë sjelljet e një mysliman kur ha dhe pi?

Para përmendjes së tyre, është e domosdoshme të theksohet se sunetet dhe rregullat etike që Islami nxit në tryezën e ngrënies janë të shumta. Disa prej tyre janë para ngrënies, disa prej tyre gjatë ngrënies dhe disa pas ngrënies. Në vijim do të mundohem që t'i paraqesim ato që përsëriten çdo ditë.



*“Kurrë nuk e ka nënçmuar
i Dërguari i Allahut a.s. ndonjë
ushqim. Nëse i ka pëlqyer,
ka ngrënë, e nëse jo, e ka lënë.”*

SUNETET DHE RREGULLAT ETIKE PARA NGRËNIES DHE PIRJES

Ndër sunetet e ngrënies është që me ngrënie dhe pirje të synohet forcimi i trupit për adhurim dhe jo të bëhet me qëllim kënaqje me të.¹ Kjo në mënyrë që për këtë personi të shpërblehet, ngase e lejuara me nijet të mirë shndërrohet në ibadet, për të cilën njeriu shpërblehet, duke u bazuar në hadithin, të cilin e transmeton Umeri r.a., se Pejgamberi a.s., ka thënë: *“Me të vërtetë, veprat shpërblehen sipas qëllimit.”*² Prandaj, pikëpamja e myslimanit për gjërat nuk është e njëjtë me pikëpamjen e të tjerëve, por ai gjithmonë i lidh veprimet e tij me Zotin e Madhëruar. Andaj, ai nuk e bën ushqimin dhe pirjen e tij një çështje rutine, por ai e bën nijetin e tij në këtë ushqim dhe pije për Zotin dhe synon që më të ta forcojë trupin në bindje ndaj Tij.

Në mënyrë që Zoti të lëshojë bereqet në ushqim, myslimani përpiket të jetë në një vijë me sunetin, ku synon që gjatë ngrënies të jetë me të ndonjë person tjetër apo edhe më shumë se një person, e kjo e fundit do të ishte më e mirë. Kjo, ngase në ushqimin në të cilin gjinden shumë persona, Allahu lëshon bereqet, e këtë e dëshmojmë me hadithin, të cilin e transmeton Vahshiu r.a., se Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Tubohuni rreth ushqimit tuaj dhe përmendeni emrin e Allahut, do ju bekoj.”* Në një transmetim tjetër: *“do t’ju japë bereqet në të.”*³

Ushqimin dhe pijen, të cilat janë begati të Zotit, myslimani nuk duhet t’i nënçmojë, por duhet të jetë i kënaqur me atë që ka në dispozicion. Kështu që, nëse i pëlqen, le të hajë, e nëse nuk i pëlqen, le ta lërë atë pa lënduar ndjenjat e atyre që ia kanë ofruar. Kështu vepronte i Dërguari ynë a.s., siç thuhet në hadithin e Ebu Hurejres r.a.: *“Kurrë nuk e ka nënçmuar i Dërguari i Allahut a.s. ndonjë ushqim. Nëse i ka pëlqyer, ka ngrënë, e nëse jo, e ka lënë.”*⁴

Para ngrënies dhe pirjes është sunet⁵ që myslimani të kujdeset për higjienën e duarve, sepse feja e tij është fe e pastërtisë. Larja e duarve para ngrënies njëkohësisht është

edhe pritje e dhuntisë me mirësjellje, si dhe falënderim i kësaj begatie të Zotit. Për shkak se ushqimi me nijet të forcimit është adhurim, e meriton që t’i paraprihet me pastërti, ashtu siç i paraprihet namazit me pastërti. Transmeton Selmani r.a., se Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Bereqeti i ushqimit është abdesi para tij dhe abdesi pas tij.”*⁶ Me fjalën *“abdes”* në hadith, për qëllim është pastrimi, jo marrja e abdesit. Duhet pasur parasysh se, sipas sunetit, duhet të lahen të dy duart, ndërsa larja e njëres dorë, apo vetëm e gishtërinjve të duarve, para ngrënies, nuk është e mjaftueshme.

Në rast të ngrënies me persona të tjerë, myslimani duhet të ketë kujdes të mos fillojë me ngrënie derisa të fillojë më i vjetri në atë mes, përveç nëse është prej atyre që ndiqet. Këtë duke e argumentuar me hadithin, që transmetohet nga Hudhejfe r.a., i cili thotë: *“Kur prezantonim me Pejgamberin a.s. në ushqim, ne nuk i vendosëm duart tona derisa i Dërguari i Zotit a.s., të fillonte të vërë dorën e tij.”*⁷

SUNETET DHE RREGULLAT ETIKE GJATË NGRËNIES DHE PIRJES

Ndër sunetet e njohura të ngrënies është fillimi me emër të Allahut, sepse robi kujton Zotin e Plotfuqishëm në të gjitha çështjet e tij, e në mesin e tyre edhe kur ha dhe pi. Ai gjatë thënies së besmeles e ngrit zërin, në mënyrë që t’ua rikujtoj të tjerëve. Mirëpo, ndonjëherë personi mund ta harroj *besmelen* në fillim të ushqimit për ndonjë arsye. Kështu që, në rast të tillë, në momentin që i kujtohet, ai thotë: *“Në emër të Zotit nga fillimi deri në fund.”* Kjo duke u mbështetur në fjalët e të Dërguarit të Allahut a.s.: *“Kur dikush nga ju ha ushqim, le të thotë: “Bismilahi”. Por, nëse harron në fillim të tij, le të thotë: Bismilahi, në fillim e deri në mbarim.”*⁸

Gjithashtu, është sunet bërja lutje për mirësi dhe bekim në ushqim, duke u mbështetur në hadithin e Pejgamberit a.s. që thotë: *“Atë që e ushqen Zoti me ushqim, le të thotë: “O Zot! Na beko në Të dhe na ushqe më me të mirë se kjo!” Ndërsa atij që Zoti i jep të pijë qumësht, le të thotë: “O Zot! Na beko në Të dhe na shto prej tij.” I Dërguari i Zotit a.s. tha: “Asgjë nuk vjen në vend të ushqimit dhe pijes⁹ përveç qumështit.”*¹⁰

Po ashtu është sunet që ngrënia dhe pirja të bëhet me dorën e djathtë,¹¹ po si çdo çështje tjetër pozitive që preferohet të bëhet me dorë të djathtë, përveç në rast të ekzistimit të ndonjë justifikimi, ndërsa në ndihmesën me dorën e majtë nuk ka asgjë të keqe. Këtë e dëshmon hadithi, të cilin e transmeton Ibën Umeri r.a., se Pejgamberi a.s., ka thënë: *“Kur dikush nga ju ha, le të hajë me dorën e djathtë, e kur të pi, le të pijë me dorën e djathtë, sepse shejtani ha me dorën e majtë dhe pi me të majtën.”*¹²



Ato ushqime të cilat merren me dorë është sunet të hahen me tre gishtat e dorës së djathtë, me gishtin e madh, gishtin tregues dhe gishtin e mesëm. Kjo duke u mbështetur në hadithin, të cilin e transmeton Ka'bi r.a., i cili thotë: “I Dërguari i Allahut a.s., hante me tre gishta.”¹³ Në një transmetim tjetër thuhet: “E kam parë të Dërguarin e Allahut r.a., duke ngrënë me tre gishtat e tij: gishtin e madh, atë që e pason dhe të mesmin.”¹⁴

Gjithashtu, sunet është të hahet para vetes dhe mos të hahet nga mesi i pjatës në fillim të ushqimit, sepse bereqeti zbret në mesin e saj, siç theksohet në hadithin, të cilin e transmeton Ibën Abasi r.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Bekimi zbret në mes të ushqimit, prandaj hani nga skajet e tij dhe mos hani nga mesi i tij.”¹⁵

Nga personi kërkohet të hajë prej një vendi, sepse ai është një ushqim, si dhe të hajë para vetes dhe jo nga ana që është para të tjerëve, sepse të ngrënit nga pjesa që është para të tjerëve është mungesë edukate. Nga Umer ibën Ebi Seleme r.a. transmetohet të ketë thënë: “Isha i vogël, nën përkujdesjen e të Dërguarit të Allahut a.s. dhe dora ime endej në pjatë (gjatë ngrënies), andaj i Dërguari i Allahut a.s. më tha: “O vogëlush, përmende Allahun (thuj: Bismilah), ha me të djathtën dhe ha nga ajo që ke pranë.”¹⁶

Por, në rast se në enë ka lloje pemësh, në këtë rast për dallim nga ushqimi, personi ha prej cilësdo prej tyre, sepse ato janë lloje të ndryshme. Këtë e dëshmon hadithi, të cilin e transmeton Ikrash ibën Dhujbit r.a., i cili thotë: “Ia sollën Pejgamberit a.s. një enë të madhe me bukë të thërrmuar me

lëng mishi dhe mish të yndyrshëm pa eshtra. Ne u ofruam të hamë prej tij, kështu që unë e futsha dorën time në skajet e tij. I Dërguari i Zotit a.s. më tha: “O Ikrash, ha prej një vendi, sepse ai është një ushqim.” Mandej, sollëm një pjatë me lloje të hurmave të njoma, kështu që fillova të haja para vetes. Dora e të Dërguarit të Allahut a.s. sillej në pjatë, pastaj tha: “O Ikrash, ha çfarë të duash, ngase ato nuk janë të një lloji.”¹⁷ Nga ky hadith, kuptohet se nëse llojet e ushqimeve janë të larmishme, nuk është e qortueshme ngrënia nga skajet e tjera, po ashtu si frutat.¹⁸

Sunet është nderimi i bukës aq sa është e mundur. Ndërsa prej nderimit të bukës është edhe marrja e bukës së rënë në tokë, sado e vogël që të jetë dhe ngrënia e saj, për respekt ndaj dhuntisë së Zotit të Madhëruar, ku në të kundërtën në lëniën e kafshatës së rënë ka kuptim të mohimit të dhuntisë. Këtë e mbështet hadithi, të cilin e transmeton Enesi r.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Nëse ndonjërit prej jush i bie ndonjë kafshatë, le ta largojë dëmin prej saj dhe mos t’ia lërë shejtanit.”¹⁹

Sa i përket pirjes së ujit, është sunet që ai të pihet me tri frymë, duke mos marrë frymë në gotë. Prandaj, kur personi dëshiron të marrë frymë, ai e largon gojën nga gota dhe merr frymë dhe pastaj pinë përsëri. Kjo duke u mbështetur në hadithin, që e transmeton Ebu Katade r.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Kur ndonjëri prej jush pi, mos e nxjerr frymëmarrjen në enë.”²⁰ Kjo ndalueshmëri në hadith është ndalueshmëri disiplinimi për shkak të kujdesit ndaj pastërtisë dhe higjienës, ngase gjatë frymëmarrjes mund të dalin avuj të ndyrë dhe mund të dalë një erë e keqe. Ibën Meleku, në lidhje me

“I Dërguari i Allahut a.s. kur hante ushqim, thoshte: Falënderimi i takon Zotit që na ushqe, na dha të pimë dhe na bëri myslimanë.”

hadithin, ka thënë: “Kjo është nga frika e rënies së diçkaje nga pështyma në ujë dhe ngase mund të ketë ndryshime në gojë dhe kështu era ngjitet për uji.”²¹

Ndërsa argument se pirja bëhet me tri frymë, kemi hadithin që transmeton Enesi r.a., i cili thotë: “I Dërguari i Allahut a.s. merrte frymë në enë tri herë dhe thoshte: “Ai është më i këndshëm, më i pranueshëm dhe më i shëndetshëm.”²²

Kuptimi i hadithit është personi të pi tri herë. Në secilën herë duke e larguar gojën nga gota, pastaj rikthehet përsëri në të. El-Bejdavi, në lidhje me këtë hadith, ka thënë: “Pirja me tre gllënja shuan më shumë etjen, është më e fortë në tretje dhe ka më pak efekt në ftohjen e stomakut dhe dobësimin e nervave.”²³

SUNETET DHE RREGULLAT ETIKE PAS NGRËNIES DHE PIRJES

Ndër sunetet e njohura të ngrënies dhe pirjes është që pas përfundimit të tyre të thuhet: “elhamdulillah”, duke u mbështetur në hadithin që transmetohet nga Ebu Seid el-Hudri r.a., i cili thotë: “I Dërguari i Allahut a.s. kur hante ushqim, thoshte: Falënderimi i takon Zotit që na ushqe, na dha të pimë dhe na bëri myslimanë.”²⁴

Kjo për shkak, se në thënien “*elhamdulillah*” pas ngrënies dhe pirjes, ka shprehje falënderimi ndaj Dhuruesit të kësaj begatie, si dhe kërkesë për shtimin e saj,²⁵ duke u mbështetur në fjalën e të Lartmadhërishmit: “*Nëse falënderoni, do t’ua shtoj të mirat.*”²⁶

Përveç thënies së mësipërme, mund të shtojmë edhe: “Elhamdulillah-lahil-ledhi etameni hadha ve razekanihi min gajri havlin minni ve la kuvetin.” Kjo, duke u mbështetur në fjalën e Pejgamberit a.s.: “*Kush ka ngrënë ushqim dhe thotë: Falënderoj Allahun që më ushqe me këtë dhe ma bëri atë risk (furnizim), pa kurrfarë force apo fuqie nga unë, i falën mëkatet e kaluara.*”²⁷

Krejt në fund, është sunet larja e duarve²⁸ dhe fshirja e tyre me peshqir,²⁹ duke u mbështetur në hadithin që e transmeton Selmani r.a., se Pejgamberi a.s., ka thënë: “*Bereqeti i ushqimit është abdesi para tij dhe abdesi pas tij.*”³⁰ Me fjalën abdes për qëllim është pastrimi jo marrja e abdesit siç e kemi përmendur.

- 1 Redu el-Muhtar ala ed-Durr, 6/339; ed-Durrer el-Mubaha, fq.25.
- 2 El-Buhari, nr: 1, 1/6.
- 3 Ahmedi, nr: 16078, 25/485; Ibën Maxheh, nr: 3286; Ebu Davud, nr: 3764, 3/346; Ibën Hibani, nr: 5224, 12/27-28, Shejh Shuajbi thotë: “*Është i mirë me rrugë tjera*”. El-Iraki, në Tahrixhu ehadith el-Ihja, fq.435, dhe El-Menavi, në Et-Tejsir bisherhi el-Xhami es-Sagir, 1/34, thonë: “*Senedi është i mirë*”.
- 4 El-Buhari, nr: 5409, 7/74.
- 5 Në El-Fetava et-Tatarhanijeh, 135/18, El-Muhit, 351/5, dhe El-Bahr err-Rraik, 208/8, thuhet: “*Është mustehab larja e duarve para ushqimit.*”
- 6 Ahmedi, nr: 23732, 39/136; Ebu Davudi, nr: 3761, 3/345; Et-Tirmidhi, nr: 1846, 3/345-346, dhe thotë: “*Ne nuk e njohim këtë hadith përveçse nga hadithi i Kais ibën er-Rabi’, ndërsa Kajs ibën er-Rabi’ është i dobët në hadith*”. El-Mundhiri, në Et-Tergib ve et-Terhib, 3/109, thotë: “*Kajs ibën er-Rabi’ është saduk, në lidhje me të ka fjalë për shkak të kujtesës së tij të dobët, por hadithi nuk del jashtë kufirit të hadithit të mirë*”.
- 7 Ahmedi, nr: 23249, 38/285, Shejh Shuajbi thotë: “*Senedi i tij është sipas kritereve të Muslimit*”.
- 8 Ahmedi, nr: 25733, 42/479, Shejh Shuajbi thotë: “*Senedi i tij është sipas kritereve të dy shejhave*”; Ibën Maxheh, nr: 3264, 2/1086; Ebu Davudi, nr: 3767, 3/347; Et-Tirmidhi, nr: 1858, 3/352, dhe thotë: “*Ky hadith është i mirë sahih*”.
- 9 Asgjë nuk mjafton në mënjanimin e urisë dhe etjes përveç qumështit.
- 10 Ebu Davud, nr: 3730, 3/339; Et-Tirmidhi, nr: 3455, 5/384, dhe thotë: “*Ky hadith është i mirë*”.
- 11 Dr. Salah Ebu el-Haxh, në El-Bejan fi el-Ejman ven-Nudhur, fq.169, thotë se kjo është mustehab, sepse sipas tij, vazhdimësia e diçkaje nga ana e Pejgamberit a.s. nuk konsiderohet sunet, përveç nëse bëhet për adhurim, e nëse është për zakon, atëherë kjo konsiderohet mustehab jo sunet, po siç është veshja e rrobës, ngase vazhdueshmëria e Pejgamberit a.s. me ngrënien me dorë të djathtë ishte zakon.
- 12 Muslimi, nr: 2020, 3/1598.
- 13 Muslimi, nr: 2032, 3/1605.
- 14 El-Mu’xhem el-Evsat, nr: 1649, 2/180. El-Hejthem, në Mexhma ez-Zevaid, 5/28, thotë: “*E transmeton Taberaniu në El-Evsat dhe në të gjendet El-Husejn ibën Ibrahim el-Edhenij dhe Muhamed ibën Ka’bi ibën Uxhreti, të cilët nuk i njoh, ndërsa transmetuesit e tjerë janë të besueshëm*”.
- 15 Et-Tirmidhi, nr: 1805, 3/317, dhe thotë: “*Ky hadith është i mirë sahih*”; El-Mustedrek, nr: 7118, 4/129, El-Hakimi thotë: “*Senedi i këtij hadithi është sahih*”. Këtë e miraton edhe Dhehebiu.
- 16 El-Buhari, nr: 5376, 7/68; Muslimi, nr: 2022, 3/1599.
- 17 Ibën Maxheh, nr: 3274, 2/1089; Et-Tirmidhi, nr: 1848, 3/347-348, dhe thotë: “*Ky hadith është i vetmuar*”; El-Mu’xhem el-Evsat, nr: 6126, 6/180; El-Mu’xhem el-Kebir, nr: 154, 18/82. Ez-Zerkani, në Sherhu ez-Zerkani ala el-Muvetta, 4/498, thotë: “*Në senedin e tij ka dobësi, por ai ka rrugë të tjera që e forcojnë*”.
- 18 Mirkatu el-Mefatih, 7/2726.
- 19 Muslimi, nr: 2034, 3/1607.
- 20 El-Buhari, nr: 153, 1/42.
- 21 Mirkatu el-Mefatih, 7/2752.
- 22 Ahmedi, nr: 12923, 20/262, Shejh Shuajbi thotë: “*Hadithi është sahih, ndërsa senedi është i mirë, për shkak të Ebu Asimit*”. Në Sahihu Muslimi, nr: 2028, 3/1602, përmendet: “*I Dërguari i Allahut a.s. merrte frymë në enë tri herë.*”
- 23 Mirkatu el-Mefatih, 1/377.
- 24 Ahmedi, nr: 11276, 17/375, Shejh Shuajbi thotë: “*Senedi i tij është i dobët*”; Ibën Maxheh, nr: 3283, 2/1092; Et-Tirmidhi, nr: 3457, 5/385, dhe thotë: “*Ky hadith është i mirë*”.
- 25 Mirkatu el-Mefatih, 7/2712.
- 26 Ibrahim, 7.
- 27 Ibën Maxheh, nr: 3285, 2/1093; Et-Tirmidhi, nr: 3458, 5/385, dhe thotë: “*Ky hadith është i mirë*”.
- 28 Në El-Bahr, 208/8, thuhet larja e duarve para ngrënies është mustehab.
- 29 Shih: El-Hedijetu el-Alajeh, fq.255; Mefatih el-Xhinan sherh Shirati el-Islam, fq.290.
- 30 Ahmedi, nr: 23732, 39/136; Ebu Davudi, nr: 3761, 3/345; Et-Tirmidhi, nr: 1846, 3/345-346, dhe thotë: “*Ne nuk e njohim këtë hadith përveçse nga hadithi i Kais ibën er-Rabi’, ndërsa Kajs ibën er-Rabi’ është i dobët në hadith*”. El-Mundhiri, në Et-Tergib ve et-Terhib, 3/109, thotë: “*Kajs ibën er-Rabi’ është saduk, në lidhje me të ka fjalë për shkak të kujtesës së tij të dobët, por hadithi nuk del jashtë kufirit të hadithit të mirë*”.

Sjelljet e virtytshme në jetën e besimtarit

(Etika e fjetjes dhe zgjimit nga gjumi)

Mr. Vedat SHABANI



Ne si besimtarë myslimanë, e kemi për obligim ta ndjekim rrugën dhe traditën e Pejgamberit a.s. në çështjet e adhurimit dhe të veprimeve që kanë të bëjnë edhe me çështjet e jetës së përditshme.

Çështjet e sjelljes së virtytshme janë një prej tematikave, të cilat janë në interes të secilit besimtar, në mënyrë që t'i njohë e t'i përvetësojë ato. Andaj si të tilla do të duhej që të merrnin edhe një pjesë të mundit e të përpjekjes sonë në shkrime, ligjërime e këshilla. Si të tilla, ato mbesin interesante në çdo kohë për t'i njohur e për t'i praktikuar secili nga ne. E, autoriteti më meritor për t'u marrë model, dhe i cili i ka jetësuar në mënyrë praktike këto dhe virtytet e tjera, pa dyshim është i Dërguari i Allahut xh.sh., Muhamedi a.s.. Këtë e dëshmon ajeti kuranor, ku Allahu xh.sh. ka thënë: “*se ti je me virtyte morale*” (El-Kalem, 4)

Ndërsa vetë Muhamedi a.s. ka thënë: “*Jam dërguar për t'i përsosur virtytet morale.*”¹

Ne si besimtarë myslimanë, përveç që e kemi për obligim ta ndjekim rrugën dhe traditën e Pejgamberit a.s. në çështjet e adhurimit dhe të veprimeve që kanë të bëjnë me çështjet e jetës së përditshme, e kemi për obligim që ta ndjekim rrugën dhe traditën e tij edhe në çështjet të cilat ndërlidhen me virtytet morale dhe mirësjelljen, apo thjesht me përditshmërinë tonë. Nuk ka dyshim se çdo besimtar mysliman interesohet se si Pejgamberi a.s. sillej ndaj bashkëshorteve të tij, si sillej ndaj fëmijëve dhe fqinjëve të tij, si porosiste Pejgamberi a.s. që të sillemi ndaj prindërve tanë dhe familjarëve të tjerë. Lidhur me këtë Allahu xh.sh. në



Kuran ka thënë: “Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun.” (El-Ahzab, 21)

Kjo seri temash, prekin fusha të gjera jetësore dhe janë gjithëpërfshirëse. Ato na rrëfejnë për një seri rregullash dhe virtytësh morale për të cilat çdo besimtar ka nevojë t'i njohë dhe praktikojë gjatë jetës së tij të përditshme. Prezantimi i këtyre tematikave do të bëhet në mënyrë të përmbledhur e cila do të përshtatet edhe me angazhimet e shumta të njerëzve, veçmas në këtë kohë të pa kohë. Me këtë shpresojmë dhe lutemi që besimtarët myslimanë të kenë mundësi dhe të njihen me këto virtyte dhe mënyrën se si Pejgamberi a.s. ka vepruar. Lidhur me këtë Pejgamberi a.s. në një hadith kudsij ka thënë: “Nuk ka asnjë veprim më të mirë, të cilin e bënë rob i mi me qëllim të afrimit ndaj Meje, se sa ato veprime të cilat ia kam bërë obligim (farz). Robi i mi vazhdon të bëjë punë të mira vullnetare me qëllim të afrimit ndaj Meje derisa Unë ta dua atë. Nëse rob i arrin atë nivel që Unë ta dua atë, atëherë Unë bëhem veshi i tij përmes të cilit ai dëgjon, syri i tij përmes të cilit ai shikon, dora e tij përmes të cilës ai vepron dhe këmba e tij përmes të cilës ecë. Nëse më drejtohet me ndonjë lutje Unë i përgjigjem asaj, nëse kërkon mbrojtjen Time unë e mbrojtë atë. Nuk ka veprim të cilin Unë e bëjë e të kem mëdyshje në bërjen e tij se sa kur unë marr shpirtin e besimtarit dhe frikohem se po e lëndoj atë.”²

RREGULLAT (VEPRIMET ETIKE) ME RASTIN E SHKUARJES NË GJUMË

Gjumi të cilin ne e bëjmë çdo natë ka disa rregulla dhe preferenca, prej tyre mund të theksojmë:

- Të mos qëndrojmë zgjuar gjatë natës, përveç në raste të veçanta. Raste të veçanta mund të llogariten vizitat familjare me qëllim të ruajtjes së lidhjeve fafaisnore, vizita e ndonjë të sëmuri, qëndrimi me qëllim të mësimi e të ngjashme. Pejgamberi a.s. e ka pasur çdoherë traditë fjetjen pas faljes së namazit të jadisë. Ai a.s. e ka urryer gjumin para namazit të jadisë dhe bisedën-ndejën pas namazit të jadisë.

- Të jemi me abdes kur të shkojmë në shtrat për të fjetur. Pejgamberi a.s. ka thënë: “Kur të shkosh në shtrat, atëherë merr abdes ashtu siç merr për faljen e namazit.”³

- Leximi e këtyre pjesëve nga Kurani: Ajetul-Kursij/ Tespihdovës, përfundimin e kaptinës El-Bekare, Kulhuvallahun dhe dy Kulëudhat. Është transmetuar nga Aisheja r.a., se Pejgamberi a.s. kur shkante në shtrat për të fjetur i ngrite duart lart, frynte mbi to, lexonte Kulhuvallahun dhe dy Kulëudhat dhe më pastaj me duart e tij fërkonte aq sa mundte nga trupi i tij, duke filluar nga koka, fytyra dhe trupi. Këtë veprim e bënte tri herë.⁴ Pejgamberi a.s. gjithashtu ka thënë: “Kush lexon dy ajetet e fundit të kaptinës El-Bekare, ato do t'i mjaftojnë.”⁵ Ndërsa. sa i përket vlerës së leximit të Tespihdovës, Pejgamberi a.s. ka thënë: “Kush lexon Tespihdovën kur shkon në shtratin e

tij, ai do të jetë nën mbrojtjen e Allahut xh.sh. dhe nuk do t'i afrohet djalli derisa të gdhij.”⁶

- Leximi i kaptinës El-Kafirun. Një veprim i tillë llogaritet preventivë dhe mbrojtëse e besimtarit nga politeizmi.⁷

- Sipas mësimëve të Pejgamberit a.s. preferohet, siç u theksua edhe më lart, që me rastin e shkuarjes në shtrat, çdo person të marrë abdes dhe të bie në krahun e djathtë dhe ta thotë këtë lutje: “Allahumme eslemtu vexh’hi Ilejke, ve favved’tu emri ilejke, ve elxhe’tu dhahri ilejke, ragbeten ve rahbeten ilejke, la melxhe’e ve la menxha’ minke il-la ilejke, Allahumme amentu bi-kitabike el-ledhi enzelte, ve bi-nebijjike el-ledhi erselte” – “Zoti im, vetën time e dorëzova te Ti, çështjen time e lash në dorën Tëndë, shpinën time e mbështeta te Ti, me vetë dëshirë dhe nga frikë-respekti për Ty, nuk kemi strehim as shpëtim përveçse te Ti. Zoti im, unë kam besuar në librin Tënd të cilin e ke zbritur dhe në Pejgamberi tënd të cilin e ke dërguar.”

- Sipas mësimëve dhe udhëzimeve të Pejgamberit a.s., preferohet, që me rastin e shkuarjes në shtrat dhe zgjimit nga gjumi të thuhet: (SubhanAllah ve bi-hamdihi), njëqind herë. Pejgamberi a.s. ka thënë: “Kush e thotë këtë lutje, në Ditën e Kiametit asnjë person nuk do të paraqitet më mirë se sa ky, përveç atij që e ka thënë të njëjtën lutje, ose ka thënë edhe më shumë.”⁸

- Gjithashtu, bazuar në udhëzimet e Pejgamberit a.s., me rastin e shkuarjes në shtrat, preferohet të thuhet kjo lutje, të cilën Pejgamberi a.s. e ka quajtur: “Zonja e lutjeve”. “Allahumme ente Rabbi, la ilahe il-la ente, kalektene ve ena abduke, ve ena ala ahdiqe ve vaëdike ma istetaëtu, eudhu bike min sherri ma sanaëtu, ebu’u leke bi-nimetike alej-je ve ebu’u bidhenbi, fegfiri, fe in-nehu la jegfuru dhunube il-la ente.”⁹ – “O Allah, Ti je Zoti im, nuk ka zot tjetër përveç Teje. Ti je Krijuesi im, ndërsa unë jam robi yt. Unë do të qëndrojë në rrugën dhe premtimin të cilin e kam dhënë ndaj Teje për aq sa kam mundësi. Kërkoj mbrojtjen Tënd nga të këqijat që veprojnë. Jam mirënjohës i begatitë Tu ndaj meje, gjithashtu pranoj edhe gabimet e mija, prandaj m’i fal ato, sepse nuk ka kush i fal përveç Teje.” Pejgamberi a.s. ka thënë: “Kush e thotë këtë lutje në mbrëmje dhe vdes atë natë, ai do të hyjë në Xhenet, gjithashtu kush e thotë në mëngjesë pasi të zgjohet dhe vdes atë ditë do të hyjë në Xhenet.”

- Nuk është e preferuar që të flejë mbi stomak. Këtë formë të fjetjes, Pejgamberi a.s. ka thënë se e urren Allahu xh.sh..

- Nëse gjatë natës sheh ndonjë ëndërr të mirë, kjo është një sihariq nga ana e Allahut xh.sh., prandaj është mirë që të falënderohet Zoti xh.sh. dhe t’i tregoj atij që e donë.

Edhe pas zgjimit nga gjumi, po edhe çdo veprim të cilin neve e bëjmë, ka rregulla, udhëzime dhe preferenca të cilat Pejgamberi a.s. i ka bërë.

- Nëse gjatë natës sheh ndonjë ëndërr të keqe, atëherë kjo është nga djalli dhe preferohet që të kërkojë ndihmë dhe mbrojtje prej tij. Preferohet që me rastin e zgjimit nga gjumi, si rezultat i ëndrës së keqe, të pështyjë tri herë në anën e majtë dhe mos t’ia tregojë asnjë njeriu atë ëndërr.

RREGULLAT (VEPRIMET ETIKE) ME RASTIN E ZGJIMIT NGA GJUMI

Rregullat të cilat u theksuan më lartë kanë të bëjnë me etikën dhe edukatën e shkuarjes në shtrat për të fjetur. Edhe pas zgjimit nga gjumi, po edhe çdo veprim të cilin ne e bëjmë ka rregulla, udhëzime dhe preferenca, të cilat Pejgamberi a.s. i ka bërë dhe të njëjtën kohë ato janë mësim dhe udhëzim edhe për ne si pjesëtarë të fesë islame. Në vazhdim do të potencojmë disa rregulla që kanë të bëjnë me rastin apo momentin e zgjimit nga gjumi:

- Rikujtimi i Allahu xh.sh. me rastin e zgjimit nga gjumi. Ka qenë traditë e Pejgamberit a.s. që kur është zgjuar nga gjumi ka thënë: “Elhamdu Lilahi el-ledhi ahjana bade-ma ematena ve ilejhi nushur.”¹⁰ – “Falënderimi i takon Allahut i Cili na bëri prapë të gjallë dhe tek Ai është rikthimi.”

- Pastrimi i gojës dhe dhëmbëve. Ka qenë traditë e Pejgamberit a.s. që sa herë zgjohej nga gjumi i pastronte dhëmbët me misvak.

- Larja e fytyrës pas zgjimit nga gjumi.

- Nëse zgjohet natën për të falur namaz të natës preferohet që t’i zgjojë edhe anëtarët e tjerë të familjes.

1 Musnedi i Imam Ahmedit, hadithi nr. 8952.

2 Sahihu i Buhariut, nr. i hadithit: 6502.

3 Sahihu i Buhariut, nr. i hadithit: 247.

4 Sahihu i Buhariut, nr. i hadithit: 5017.

5 Sahihu i Buhariut, nr. i hadithit: 5008.

6 Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi me këtë kuptim.

7 Hadithin të cilin e potencojmë një gjë të tillë e transmeton Ebu Davudi në Sunenin e tij. Nr. i hadithit: 5055.

8 Sahihu i Muslimit, nr. hadithit: 2629.

9 Sahihu i Buhariut, nr. i hadithit: 6306.

10 Sahihu i Buhariut, nr. i hadithit: 6312.

Konditat dhe rregullat e urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja

Ymeti islam është nderuar me bartjen dhe komunikimin e mesazhit të Islamit te bota mbarë.

Prof. ass. dr. Rexhep SUMA

Urdhri për të mirë dhe ndalimi nga e keqja është reformë, vlerësim dhe edukim bazuar në shenja sipas një mesazhi cili kërkon njohuri e njohje e studim që kërkojnë veçanërisht nga predikuesi (thirrësi) që të zotërojë aftësi, mençuri, fleksibilitet, e durim.

Ymeti islam është nderuar me bartjen dhe komunikimin e mesazhit të Islamit te bota mbarë. Duke qenë ymeti më i mirë, ai bartë edhe mirësi të shumta që i ofron botës. Andaj në këtë sferë, myslimani duhet të jetë i vetëdijshëm për rolin e tij historik që ka, ndoshta edhe pa vetëdije, duke qenë moskokëçarës për gjendjen e shoqërisë islame përreth tij. Pra duke neglizhuar urdhërimin për të mirë dhe ndalimin nga e keqja.

Në këtë kuadër, vërejmë se disa e kryejnë këtë detyrë pa dije, pa urtësi ose disiplinë me rregullat dhe etikën e nevojshme për të urdhëruar për të mirë dhe për të ndaluar nga e keqja. Dijetarët dhe studiuesit islamë kanë qenë të interesuar për sqarimin e kritereve, konditave dhe etikën e urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja në kuadër të hulumtimit dhe thellimit në analizë të tërësisë së provave të cekura në Kuran dhe sunet.

Urdhri për të mirë dhe ndalimi nga e keqja është reformë, vlerësim dhe edukim bazuar në shenja sipas një mesazhi cili kërkon njohuri e njohje e studim që

kërkojnë veçanërisht nga predikuesi (thirrësi). Në të shumtën e herëve, urdhërimi për të mira dhe pengimi prej të këqijave bëhet me fjalë. Urdhërimi për të mira dhe pengimi prej të këqijave mund të jetë duke e ftuar jomyslimanin në fenë islame, apo duke e thirrur gjynahqarin mysliman që t'iu nënshtrohet urdhërave të Allahut xh.sh. dhe të largohet prej kundërshtimeve ndaj ligjeve të Sheriatit islam. Rregullat dhe principet gjithëpërfshirëse të çështjes së urdhërimit për të mira dhe të pengimit prej të këqijave e të cilat duhet t'i njohë mirë thirrësi janë si vijon:

NJOHURIA

Personi që ngarkohet me kryerjen e urdhrit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja duhet të zotërojë njohuri të bollshme se çka është vepër e mirë për të cilën duhet ftuar dhe çka është vepër e keqe nga veprimi i së cilës duhet penguar. Ai nuk duhet të jap fetva - përgjigje të pabazuara në argumente të shëndosha, ose të pa qartësuar mirë nga dijetarët, dhe që i përshtaten mjedisit të caktuar kulturor dhe formimit të tyre intelektual. Ka gjëra që i di çdo mysliman, dhe ka gjëra që janë të veçanta për dijen e dijetarëve dhe muxhtehidëve. Myslimani i thjeshtë i di çështjet e namazit, agjërimit dhe detyrat e tjera dhe e di ndalimin e kamatës,

“Thuaj: “Kjo është rruga ime, e vënë në fakte të qarta, e që unë dhe ai që vjen pas meje. Larg të metave është Allahu, e unë nuk jam nga idhujtarët.” (Jusuf, 108).



mashttrimit, zbulimin e pjesëve intime etj.. Pra kjo është që do të duhet të njihet nga feja domosdoshmërisht, ndërsa jashtë kësaj fushe mbetet brengë dhe përgjegjësi e interpretimit që me të do të duhej të merreshin dijetarët. Përmendet nga disa prej gjeneratave të hershme: “Nuk ka urdhëruar për të mira dhe nuk ka penguar prej të këqijave pos atij që ka qenë njohësi mirë i asaj që urdhëron dhe asaj që pengonte të veprohet.” Kjo është e qartë dhe se është e njëjtë me atë që dëshiron ta trajtojë të sëmurin, ai ka nevojë të njohë sëmundjen dhe ilaçin, d.m.th. duhet të jetë mjek i mirë dhe kështu duhet të jetë edhe thirrësi. Allahu xh.sh. ka thënë: “Thuaj: “Kjo është rruga ime, e vënë në fakte të qarta, e që unë dhe ai që vjen pas meje. Larg të metave është Allahu, e unë nuk jam nga idhujtarët.” (Jusuf, 108).

PRIORITETET

Rregulli bazik është të fillojë me urdhrin që ka të bëjë me farzet para sunetit dhe ndalon nga haramet para mekruheve. Nganjëherë krijohen disa situata që të kemi së bashku dy të mira apo dy të këqija, dhe kjo paraqet hutim se nga cila të fillojë, me urdhrin apo me ndalesën? Është e domosdoshme në të gjitha këto të jepet përparësi obligimit (farzit) para sunetit. Të kundërshtohet fillimisht e ndaluara para asaj që është mekruh.

Nëse përballen dy vaxhibe, që nuk është e mundur të kryhen në të njëjtën kohë, i jepet përparësi atij obligimvaxhibi që është më i fuqishëm prej tyre. Kështu është edhe kur përballen dy haramet, që nuk mund të lihet më i madhi prej tyre, përpos duke e vepruar më të voglin, në këtë rast më i vogli, në të vërtetë, nuk është haram, edhe pse në rastin e parë veprimi quhet lënie e vaxhibit, kurse në të dytin quhet

bërje e haramit. Ndaj dhe në këtë rast, për veprën thuhet lënie e vaxhibit me arsye dhe bërje e haramit për shkak të domosdoshmërisë ose interesit më të madh, ose për ta mënjanuar atë që është më haram.¹ Dijetari i mirënjohur, Jusuf Kardavi thotë se kapitulli i përballjeve është shumë i gjerë, e sidomos vjen në shprehje në kohërat dhe vendet në të cilat mungojnë gjurmët e peygamberisë dhe kalifatit. Disa njerëz mund të shikojnë në disa të mira duke e peshuar ndonjërin prej tyre, edhe pse në të ka efekte të mëdha negative, kurse disa të tjerë i shikojnë disa të këqija duke e peshuar ndonjërin prej tyre, edhe pse me të kanë lënë dobi të mëdha, kurse mesatarë janë ata që i shikojnë të dy çështjet.

BUTËSIA

Kjo konditë e ka bazën e fuqishme në burimet e Sheriatit, pra në Kuran dhe hadith. Në ligjëratën të cilën Allahu xh.sh., i drejtohet Musait a.s. dhe Harunit a.s., thotë: “Shkoni që të dy të Faraoni, se ai vërtet e ka tepruar. Atij i thoni fjalë të buta, ndoshta ai mendohet a frikësohet.” (Ta Ha, 43-44).

Fjala e butë nga ky ajet është e përmendur në kaptinën En-Naziat: “Dhe thuaj: “E ke ndër mend të pastrohesh?” Unë të udhëzoi të Zoti yt e ti t’ia kesh frikën Atij!” (En-Naziat, 18-19).

Kjo formë e të shprehurit në mënyrë të qartë e shpjegon të vërtetën, por është e shprehur në mënyrë të butë sa që mohuesi i së vërtetës nuk ka pse të nervozohet. Më pastaj shihet se si është folur në mënyrë edhe më të butë se sa kjo formë e të shprehurit. Sipas asaj që tregon Allahu xh.sh., Musai a.s. thotë para Faraonit: “Ne na është thënë se dënimi është për atë që gënjen (të dërguarit) dhe ia kthen shpinën besimit.” (Ta Ha, 48).

Kjo është një vërejtje e butë dhe e sinqertë që i drejtohet Faraonit. Por edhe nga tradita apo gurra profetike në këtë aspekt kemi nxitje për këtë cilësi. S'ka mundësi që të ekzistojë butësia në ndonjë vepër përpos që e zbukuron – hijeshon atë dhe s'ka mundësi që t'i merret butësia ndonjë vepre, përveçse do ta shëmtojë atë. Vërtet Allahu e do butësinë në çdo çështje, ajo që jepet me butësi nuk mund të merret me forcë. Pa dyshim se thirrësi nganjëherë ndodh që të dalë jashtë kornizave të butësisë gjatë urdhërimit për të mira dhe ndalimit nga e keqja, por ai duhet gjithmonë ta ketë të qartë se butësia është e vetmja rrugë e sigurtë, e të cilën e ka trasuar dhe zbatuar i Dërguari a.s.. Një shembull ilustrimi e kemi edhe rastin kur Ebu Bekri r.a. në një fjalim të tij e lexoi ajetin kuranor: “O ju që besuat, ruajeni veten tuaj! Ai që ka humbur, nuk ju dëmton juve kur jeni në rrugë të drejtë. Kthimi i të gjithë juve është tek Allahu dhe Ai ju njofton për atë që vepruat.” (El Maide, 105), pastaj ai e lavdëroi dhe e falënderoi Allahun, e tutje tha: “O njerëz, ju a e lexoni këtë ajet, por ju këtë ajet e vini në vend të gabuar, sepse unë e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut, duke thënë: “Nëse njerëzit e shohin një të keqe dhe nuk e ndryshojnë, afër është që Allahu t'i ndëshkojë për shkak kësaj të keqeje.” Tefisirologu i njohur, Ibën Kethiri, duke e komentuar këtë ajet kuranor ka thënë: “Allahu i Madhërishëm iu drejtohet robërve të Vet besimtarë që ta përmirësojnë veten dhe të bëjnë mirë me mundin e fuqinë e tyre që kanë, duke ua bërë me dije se atë që e ka rregulluar veten, nuk e dëmton e keqja e njerëzve të prishur, pa marrë parasysh nëse njeriu i tillë është afër apo larg atij.”²

TË ANALIZUARIT SE ÇKA ËSHTË E DOBISHME DHE ÇKA E DËMSHME

Kuptimi i kësaj është që urdhëruesi për të mirë dhe penguesi nga e keqja të synojë atë që është e dobishme dhe të ketë kujdes nga e padobishmja, çfarë ka mundësi të veprojë e çka jo. Prandaj, kur të ndodhë që të vijë në kundërshtim e dobishmja me të dëmshmen, në këtë rast, predikuesi duhet treguar kujdes se çfarë po urdhëron të bëhet dhe çfarë po pengon të veprohet.³

Dijetarët kanë vendosur se është e ligjshme dhe e lejueshme që të heshtësh për ndonjë veprim të ndaluar që e shikon nëse kundërshtimi i tij do të sillte një dëm më të madh. Kështu kryhet ai që sjell dëmin më të vogël dhe durohet ajo që sjell të keqen më të vogël. Për këtë flitet edhe në hadithin e saktë të transmetuar nga Aisheja r.a., ku Pejgamberi a.s. i thotë asaj: “Sikur populli yt të mos ishin ende të freskët nga koha e

idhujtarisë, atëherë do ta ndërtoja Qabenë mbi themelet e Ibrahimit a.s.” (Buhariu dhe Muslimi). Pra, do ta prishte atë dhe do ta rindërtonte përsëri për të futur brenda saj pjesën që kishte ngelur jashtë kur u rindërtua nga kurejshët, për arsye se nuk u mjaftoi pasuria për ta plotësuar atë. Po ashtu, këtë e përforcon edhe Kurani fisnik në tregimin e pejgamberit Musa a.s. me popullin çifut. Pejgamberi Musa a.s. shkoi për t'u takuar me Allahun xh.sh., dhe qëndroi për dyzet ditë. Por gjatë mungesës së tij, ata u mashtruan nga Samiriju me viçin e tij prej floriri që filluan ta adhurojnë. Pejgamberi Harun a.s., vëllai i pejgamberit Musa, i këshilloi, por ata nuk i dëgjuan

këshillat e tij dhe i thanë: “Ata i thanë: “Ne nuk do t'i ndahemi këtij (adhurimit të viçit) derisa të kthehet Musai!” (Ta Ha, 91). Kur u kthye pejgamberi Musa dhe pa këtë gabim të madh që ishte kryer, kishin adhurar viçin, filloi që ta qortonte rëndë vëllain e tij Harunin, duke e tërhequr nga koka dhe nga mjekra prej zemërimit të madh. Allahu i Madhërishëm thotë: (Musai u kthye e) tha: “O Harun, ç'të pengoi ty kur i pe se morën rrugën e gabuar e ti mos ua vazhdosh rrugën time? A mos e kundërshtove edhe ti porosinë time?” Ai (Haruni) tha: “O bir i nënës sime, mos më kap as për mjekre, as për flokë, se unë u frikësova se do të thuash: “I përçave Beni Israilët dhe nuk e ke respektuar porosinë time?” (Ta Ha, 92-94). Kjo do të thotë se, Haruni a.s. preferoi që më mirë të priste dhe të kujdesej për unitetin e bashkësisë derisa të kthehej vëllai i tij dhe të diskutonin bashkë se si do ta zgjidhnin këtë çështje të rrezikshme me urtësinë dhe vendosmërinë e duhur.⁴

“... Allahu nuk e prish gjendjen e një populli (nuk ua largon të mirat) përderisa ata ta ndryshojnë veten e tyre.” (Er-Rad, 11).

NDRYSHIMI I GABIMEVE TË PJESSHME NUK ËSHTË ILAÇ

Këtu dua që të tërheq vëmendjen për një çështje të rëndësishme për ata që merren me përmirësimin e gjendjes së myslimanëve. Studiuesi Jusuf Kardavi, në lidhje me këtë pikë shprehet se ajo ka të bëjë me atë që shkatërrimi që u ka ndodhur shoqërive tona gjatë shekujve të prapambetjes, atyre të kolonializmit perëndimor dhe të periudhës së diktaturës dhe të shtetit laik, është një shkatërrim përfshirës dhe i thellë. Andaj për rregullimin e tij nuk mjafton ndryshimi i disa gabimeve të pjesshme. Çështja është më e madhe dhe më e rëndësishme se kaq dhe duhet patjetër që të bëhet një ndryshim më gjithëpërfshirës, më i gjerë dhe më i thellë. Një ndryshim që përfshin mendimet dhe botëkuptimet, parimet dhe vlerësimet, sjelljet, veprat, edukatën dhe zakonet, sistemet dhe ligjet. Dhe para së gjithash duhet që të ndryshojnë

njerëzit brenda tyre, duke i këshilluar vazhdimisht dhe duke i edukuar pandërprerë me modelin e mirë. Nëse njerëzit ndryshojnë brenda vetes, atëherë do të jenë të aftë dhe do ta meritojnë që Allahu i Madhërishëm ta ndryshojë gjendjen e tyre sipas ligjit të pandryshueshëm që thotë:⁵ “... Allahu nuk e prish gjendjen e një populli (nuk ua largon të mirat) përderisa ata ta ndryshojnë veten e tyre.” (Er-Rad, 11).

PËRZIERJA E VEPRËS SË MIRË ME TË KEQEN

Thirrësi në Islam parimisht urdhëron në çdo vepër të mirë me krejt llojet e veprave të tilla, ndërsa veprat e liga, ndalon dhe e pengon zbatimin e tyre në tërësi dhe nga të gjitha llojet e tyre. Ndërkaq, kur ndodh që një person i veçantë apo një grup i veçantë të veprojnë edhe të mirën edhe të keqen së bashku në të njëjtën kohë, apo në të kundërtën i braktisin të dyja së bashku, në këtë rast duhet analizuar mirë se ku është më së shumti interesi. Nëse është interesi më i madh në zbatimin e tyre, duhet urdhëruar që të kryhen, edhe pse në të ka edhe veprim të keq. E nëse është e kundërta, ashtu që dëmi është më i madh se sa dobia, atëherë duhet urdhëruar që të zbatohen ato, edhe pse do të kalojë ndonjë e mirë pa u vepruar. E kur nuk është në gjendje ta vlerësojë se a ka më shumë dobi sesa dëm ose anasjelltas, atëherë ai do të bëjë një analizë të situatës me vëmendje dhe që të mos i japë përparësi asnjërit veprim pos me dije dhe sinqeritet.⁶

KOMUNIKIMI I MESAZHIT ISLAM BRENDA MUNDËSIVE DHE FORCAVE NJERËZORE

Komunikimi apo shpërndarja e vlerave fetare të masa e gjerë duhet të zhvillohet brenda mundësive dhe aftësive njerëzore. Nuk është prej kushteve të transmetimit të thirrjes që urdhërimi për mirësi dhe pengimi prej të këqijave të arrijë deri te çdonjëri që është i ngarkuar me obligime. Mirëpo, ajo që kushtëzohet është që të ngarkuarit me obligime të kenë mundësi të arrijnë ta njohin atë që është e mirë dhe atë që është e keqe, e nëse të ngarkuarit nga myslimanët e shpërfillin këtë dhe nuk angazhohen për ta kuptuar atë, atëherë gabimi u mbetet atyre dhe jo thirrësit - daiut.⁷

DUHET SHMANGUR HADITHEVE TË CILAT JANË TË PAQARTA PËR SHUMICËN E NJERËZVE

Thirrësi duhet t'i shmangët përmendjes së haditheve, të cilat vështirë kuptohen të shumica e njerëzve, mendjet dhe niveli arsimor i të cilëve nuk mund t'i konceptojë, sepse ato kanë sqarime të cilat ata nuk mund t'i pranojnë, ndoshta për atë se ato i tejkalojnë nivelet e tyre të të kuptuarit. Thirrës i suksesshëm është ai që interesohet për hadithet të cilat kanë të bëjnë me realitetin e njerëzve, dhe i cili përpiqet që të largohet prej haditheve të paqarta dhe të dykuptimita, domethënien e të cilëve nuk mund ta pranojnë njerëzit me inteligjencën mesatare. Imam Neveviu, në veprën e tij

“Et-Takrib” duke folur për etikën e muhaddithit, i cili ua mëson nxënësve hadithin thotë: “Duhet të ruhet prej asaj që mendjet e tyre nuk mund ta përballojnë, e as ta kuptojnë.” Imam Sujuti, në komentin e vet “Et-tedrib ala et-takrib” thotë: “Hadithet të cilat flasin për cilësitë e Allahut janë hadithe që duhet shmangur predikimi i tyre në masë, sepse me këtë, ka keqkuptime e njerëzit mund të gabojnë, apo të bien në dyshim, apo të imagjinojnë Allahun të ngjashëm me diçka, apo të bien në antropomorfizëm.”⁸

Andaj dietari e ka për detyrë që t'i studiojë natyrën e këtyre urdhëresave dhe ndalesave dhe pasojat e tyre. Shembull, nëse me urdhrin e tij për ta realizuar një nënshtrim (ita'at), bëhet një mëkat edhe më i madh se nënshtrimi, duhet të shmangët bërja e atij veprimi, duke dashur të mënjanohet mëkati.⁹

Daiu-predikuesi duhet të tregojë kujdes ndaj vetvetes, të shmangët nga mëkatet e ndryshme dhe t'iu përmbahet urdhëresave të Allahut xh.sh., Ai nuk mbanë kurrfarë përgjegjësie ndaj njerëzve që nuk dëshirojnë të reflektojnë dhe as t'i kryejnë urdhëresat, apo të largohen nga ndalesat e Tij. Por, bazuar në këtë ajet, obligim e ka që t'ua tërheq vërejtjen besimtarëve, të luftojë të keqen dhe dukuritë negative në shoqëri siç ka vepruar dhe punuar Muhamedi a.s., i cili na ka porositur: “Njerëzit nëse e shohin të keqen dhe nuk e ndryshojnë (e ndalojnë) atë, frikësohem se Allahu do t' i përgjithësoj ata me dënimin e Tij.”

Si kondita të tjera që ka të bëjë me urdhërimin për të mirë dhe ndalon nga e keqja, predikuesi duhet të njohë ambientin ku operon dhe ku ka vendosur të kryej punën e predikimit. Po ashtu të jetë e kohës së tashme e jo të kaluarës, prolongimi i urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja në kohë të përshtatshme, të shfrytëzohen mundësitë të cilat do ta realizonte këtë efekt. Ndër të tjera numërohen edhe sinqeriteti, durimi, është obligim komunikimi, të mbulojë dhe mos të bëj skandal, modestia, t'i përmbahet asaj që urdhëron, mos shoqërimi me njerëz të këqij, të kërkojë këshilla dhe ndihmë nga ata që ka besim.¹⁰

1 Jusuf Kardavi, “Detyrat parësore të lëvizjes islame në periudhën e ardhme”, Furkan Ism, Shkup, 2000, f. 266.

2 Imam Hafidh ebi Fida Ismail ibn Kethir el Kureshi Ed-dimeshki, Tefsirul Kur'anil adhim, Darul marife, Bejrut, v.1,1993, f. 645.

3 Ibën Tejmije, Mexhm'u fetava, v.33, f.128.

4 Jusuf Kardavi, “Rizgjimi islam nga adoleshenca drejt pjekurisë”, Furkan ISM, Shkup, 2007, f.315.

5 Po aty, f.314.

6 Abdulkërim Zejdani, Usulu-d-ave, Muesesetu errisale, botimim i IX-të, Bejrut, 1999, f. 579.

7 Ibën Tejmije, Mexhm'u fetava, v.28, f.125-126.

8 Jusuf Kardavi, Thekafetu ed-daie, Muesesetu errisale, botimi i 11, Bejrut, 1987, f.71-72.

9 Jusuf Kardavi, “Detyrat parësore të lëvizjes islame në periudhën e ardhme”, Furkan Ism, Shkup, 2000, f. 267.

10 Muhamed Mustafa Shami, Davabit ve adab el emru bil ma'rufi ve nehji anil munker, <https://makkahacademy.org>, (01.09.2022).

Oferta e Islamit për familjen në vorbullën e sfidave bashkëkohore

Mimoza SINANI

FEJA SI FAKTOR DOMINANT

Faktori më dominant që ndikon në martesën islame është feja. Në kulturën islame nuk ekziston koncepti i bigëzimit midis asaj që është sakrale dhe asaj që është sekulare. Përderisa çdo aspekt i jetës është krijim i Allahut, ai bart kuptim fetar. Ndonëse martesë nuk konsiderohet si një sakrament fetar, Islami e rekomandon atë për çdo mysliman. Në Kuran (30:20 ;33-24:32 ;13:38 ;7:107 ;29 ,4:1) dhe në literaturën e hadithit gjenden pasazhe të shumta në të cilat celibati (beqaria) dekurajohet dhe martesë inkurajohet. Për shembull, Pejgamberi a.s. raportohet të ketë mësuar: “Martesë është prej rrugëve (mënyrave) të mia”, si edhe “Kushdo që është i aftë për t’u martuar, le të martohet”!¹

Feja garanton të drejta të caktuara dhe imponon përgjegjësi të caktuara mbi çiftin bashkëshortor. Si burri, ashtu edhe gruaja, konsiderohet se përftojnë përfitime substanciale prej institucionit të martesës, por ata gjithashtu janë të kufizuar ndaj obligimeve të saj, prej urdhërësive kuranore dhe interpretimit juridik të fragmenteve të shenjta.

Zakoni i të kërkuarit të gruas për martesë, mënyrë e sigurt për ruajtjen e prestigjit të saj.

Prej kohërave që s’mbahen mend, burri i ka propozuar gruas dhe ka kërkuar martesën me të. Është në natyrën e burrit që të propozojë dhe është në natyrën e gruas që të veprojë e vetëpërmbytur. Ky ka qenë një

ndër faktorët më të rëndësishëm për ruajtjen e prestigjit dhe nderit të grave. Sipas ligjit të krijimit, burri është krijuar si burim i kërkesës dhe i propozimit dhe është lutës, ndërsa gruaja është burim i asaj që tërheq dhe përgjigjet. Natyra e ka mbrojtur gruan me natyrën e një luleje dhe burrin me natyrën e një bilbili, gruan e ka bërë llambë dhe burrin flutur nate. Kjo është një nga skemat dhe planet e mençura të krijimit.²

Është në kundërshtim me respektin dhe nderin e një gruaje që të rendë pas një burri dhe t’i vardiset atij, ndërsa për një burrë është burrërore që ai t’i propozojë dhe t’i lutet një gruaje për këtë qëllim, madje edhe në qoftë se ai merr një përgjigje negative.

Ndërsa për një grua është e papërshtatshme dhe jo e lehtë që ta ftojë një burrë që të jetë bashkëshorti i saj dhe, nëse ndodh që kërkesa e saj të refuzohet, të shkojë në kërkim të një burri tjetër.

PJESËMARRJA E FAMILJEVE NË ZGJEDHJEN E ÇIFTIT BASHKËSHORTOR

Martesë në Islam, përveçse është bashkim i dy individëve, është edhe bashkim i dy familjeve. Për këtë arsye, një pjesëmarrje më e gjerë në zgjedhjen e partnerëve të martesës nga ana e grupeve familjare të përfshira, konsiderohet si më e përshtatshme dhe më e dobishme, sesa thjesht dëshirat e dy

Si burri, ashtu edhe gruaja, konsiderohet se përftojnë përfitime substanciale prej institucionit të martesës.

individëve, sado që kjo mund të tingëllojë si e papranueshme në një ambient bashkëkohor perëndimor.

Ndërsa pjesa më e madhe e feministeve perëndimore do ta nënçmonin pjesëmarrjen e familjes në martesën e një çifti si një influencë negative, për shkak të kufizimit të dukshëm të lirisë së tyre individuale, ne si myslimanë duhet të argumentojmë se pjesëmarrja e tillë është dobiprurëse edhe për individët, edhe për grupet brenda shoqërisë. Kjo jo vetëm i siguron martesat, që bazohen mbi parime më të shëndosha sesa ato të bazuara në magjepsjen fizike dhe tërheqjen seksuale, por siguron edhe masa të tjera ruajtjeje për vazhdimësinë e suksesshme bashkëshortore.

Shumë njerëz e konsiderojnë si të dëmshëm çfarëdo cenimi të individualizmit dhe të pavarësisë. Ata nuk arrijnë ta kuptojnë se pikërisht nga ky fakt, se ata janë të varur nga të tjerët dhe të tjerët janë të varur nga ata, varet mirëqenia e tyre psikologjike dhe rregullimi i tyre në shoqëri – në fakt normaliteti i tyre mendor. Është e nevojshme një fushatë për të bindur njerëzit se madje vlera të tilla si liria individuale, bëhen objekt shpërdorimi dhe mbitheksimi.³

ISLAMI U KUSHTON KUJDES TË VEÇANTË VLERAVE DHE ARTIT FAMILJAR

Familja është institucioni më i vjetër nga të gjitha institucionet njerëzore. Qytetërimi të tëra kanë lulëzuar apo kanë stagnuar varësisht prej asaj se sa ka qenë jeta familjare e tyre e fortë apo e dobët. Islami u kushton kujdes të veçantë vlerave dhe artit familjar, sepse kjo me të vërtetë është art dhe kërkon një përkujdesje më të madhe nga të gjitha lidhjet e tjera njerëzore.⁴



Familja e cila përbëhet prej dy elementeve përbërëse, mashkullit dhe femrës, fton për bashkëpunim reciprok dhe siguron nevojat e tyre. Realisht ata së bashku formojnë një organizëm, duke i mundësuar pemës së njerëzimit të zhvillohet dhe në fund të sjellë fryte. Përmes bashkëpunimit çifti bashkëshortor mund të rritë dhe të arsimojë farën e fryteve të tyre.⁵

Fëmija është fryt i drurit bashkëshortor dhe dëshirë natyrore e mashkullit dhe femrës. Martesa pa fëmijë është sikurse pema pa frute. Përgjegjësia më e ndjeshme e nënës është të edukojë fëmijën e saj. Nëse nënat i edukojnë si duhet fëmijët e tyre, atëherë i tëri kombi, madje edhe bota do t'u nënshtrohej ndryshimeve revolucionare.

Allahu i Gjithëdijsëm i ka dhuruar gruas fuqi të jashtëzakonshme. Përparimi dhe lumturia, si edhe shkatërrimi i familjes janë në duart e saj. Nëse familja është e shëndoshë, e tillë është e edhe e tërë shoqëria. Nëse në familje ndodhin shkatërrime dhe tronditje, themelet e shoqërisë minohen seriozisht.⁶

Kërkimi i mirësisë, i dashamirësisë dhe i nderimit midis bashkëshortëve shfaqet në mënyrë të përsëritur si në tekstet fetare, ashtu edhe në ato juridike. Raporti midis burrit dhe gruas nuk është një raport thjesht utilitar. Ky raport ka karakter shpirtëror dhe prej tij burojnë: dashuria, xhentilesa, mirëkuptimi, mbështetja, besimi reciprok, shpirti i sakrificës, përkrahja dhe ndihma. Vetëm në kontekstin familjar, këto potencialitete shpirtërore të burrit dhe gruas kthehen në realitete dhe bëjnë që brenda familjes të lulëzojë begatia dhe virtyti.⁷

LIDHJA BASHKËSHORTORE, LITARI HYJNOR QË I BASHKON ZEMRAT

Martesa në fenë islame nuk është një marrëveshje afariste për të cilën bëjnë negociata dy partnerë, as nuk është kontratë shekullare ku përfitimet dhe obligimet çmohen në kontrast me njëra-tjetrën. Pastërtia morale, ngritja shpirtërore, integriteti social, stabiliteti njerëzor, paqja dhe mëshira, janë elementet kryesore të martesës. Kjo është një kontratë për të cilën vetë Zoti është Dëshmitari i Parë dhe Pala e Parë. Kjo kontratë nënshkruhet nën Emrin e Tij. Kjo është shenjë e bekimeve të Tij dhe një mëshirë e pafundme, siç thotë vetë Ai në Kuran (30:31).⁸

Lidhja bashkëshortore është një litar hyjnor që i bashkon zemrat, i qetëson ato kur janë të shqetësuar. Shtëpia është qendër dashurie, kujdesi dhe miqësie. Këto begati Allahu i Gjithëfuqishëm i përmend në Kuranin famëlartë: “Edhe një argument tjetër i Tij është se Ai, nga lloji juaj, krijon

bashkëshorte që të gjeni prehje pranë tyre, dhe ndërmjet jush mbjell dashuri dhe mëshirë.” (30:21)⁹

QËLLIMET E MARTESËS

Së pari, myslimanët e konsiderojnë martesën si siguruese të balancës midis kërkesave individuale dhe atyre shoqërore. Si e tillë, ajo konsiderohet si një domosdoshmëri sociale dhe psikologjike për çdo anëtar të komunitetit.

Së dyti, martesë është një mekanizëm për kontrollin moral. Islami e konsideron aktivitetin seksual si një energji të rëndësishme dhe të shëndetshme, si për meshkujt, ashtu edhe për femrat. Kështu ai nuk duhet të mohohet prej anëtarëve të cilësdo gjini.¹⁰

Së treti, qëllimi i tretë i martesës është parapërgatitja për një atmosferë të qëndrueshme për rritjen e fëmijëve. Islami e shikon këtë qëllim si lidhje të ndërlikuar të sistemit të zgjeruar familjar.

Së katërti, martesë siguron përfitime ekonomike kruciale për gratë gjatë viteve të mirërritjes së fëmijëve të tyre. Vetëmbajtja ekonomike gjatë kësaj periudhe, është e vështirë për nënat.

Së pesti, shoqërimi i afërt i bashkëshortëve siguron kënaqësi emocionale, si për gratë, ashtu edhe për burrat. Rëndësia e këtij qëllimi të martesës në Islam dëshmohet qartë prej referimeve të përsëritura në Kuran dhe në literaturën e hadithit për qetësinë (30:21; 7:189) dhe karakterin mbrojtës (9:71) të lidhjes midis burrit dhe gruas. Burri dhe gruaja konsiderohen të jenë kaq të afërt, saqë ata përshkruhen si veshje të njëri-tjetrit (2:187).¹¹

BARAZIMI I STATUSIT TË BURRIT DHE TË GRUAS

Në sferën e legjislacionit, Islami filloi me barazimin e statusit të burrit dhe të gruas. Muhamedi a.s. ka thënë: “Ju keni të drejta te gratë tuaja, por edhe ato kanë të drejta ndaj jush.” Kështu ai i vuri relacionet midis dy gjinive mbi një bazament juridik.¹²

Kurani na mëson se të dyja gjinitë kanë status dhe vlerë të njëjtë. Gratë dhe burrat janë krijesa të Allahut, në një nivel vlere dhe dobie të barabartë, megjithëse, rëndësia e njëllotje e tyre, nuk vërteton pretendimin për barazvlefshmëri apo identitet të përkryer të tyre.¹³

Gruaja është një entitet i pavarur dhe një qenie plotësisht përgjegjëse njerëzore. Islami i drejtohet asaj në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe nuk i qaset me ndërmjetësimin e meshkujve.

Në pajtim me Kuranin, të dyja gjinitë ndajnë besimin e përbashkët, të dyja janë subjekte në kushte të njëjta ekzistenciale, me mundësi të njëjta dhe qëllim të njëjtë për ekzistim.¹⁴

Pejgamberi Muhamed thoshte: “Gratë janë gjysma tjetër e burrave.” Njësia themelore e njerëzimit nuk është as burri, as gruaja. Është burri dhe gruaja, të bashkuar përmes martesës që i bën ata familje.¹⁵ Barazia e të drejtave të burrit dhe gruas, nga pikëpamja e vlerës së tyre materiale dhe shpirtërore, është një gjë, por identiteti i tyre është diçka tjetër. Ky ndryshim nuk është rezultat i faktorëve gjeografikë, historikë apo socialë, por ai është skicuar në vetë planin e krijimit.

Kurdo që shqyrtohet ndryshimi i karakteristikave dhe i natyrës së lindur të grave dhe burrave, një pjesë e njerëzve e interpretojnë këtë si mangësi të gruas dhe përsosmëri të burrit dhe si diçka që kërkon një sërë përfitimesh për burrin dhe një sërë privimesh për gruan. Skema e krijimit nuk ka synuar të krijojë njërin të përsosur dhe tjetrin të papërsosur.

Gruaja dhe burri janë dy yje në dy orbita të ndryshme. Kushti themelor për lumturinë e burrit dhe të gruas është që secili prej tyre të vazhdojë të lëvizë në orbitën e vet. Liria dhe barazia do të ishte në dobinë e tyre për sa kohë që asnjëri prej tyre nuk do të largohet nga orbita dhe drejtimi i tij apo i saj natyror.

Kurani mbështet në mënyrë mjaft elokumente statusin e barabartë të grave dhe burrave dhe, në të njëjtën kohë, ai pranon, përgjithësisht, ndryshimet e tyre përkatëse të natyrës dhe funksionit. Kështu, ndërsa pohon barazinë fetare, etike, intelektuale dhe ligjore të meshkujve dhe të femrave, Kurani kurrë nuk i konsideron dy sekset si identikë apo ekuivalentë.

Të drejtat dhe përgjegjësitë e një gruaje janë të barabarta ndaj atyre të një burri, por ato nuk janë domosdo identike me të tyret. Barazia dhe identiteti janë dy gjëra të ndryshme. Si rrjedhim burrat dhe gratë duhet të jenë më mirë plotësues të njëri-tjetrit, sesa të konkurrojnë me njëri-tjetrin.¹⁶

Është e vërtetë se ekzistojnë disa dallime ontologjike dhe fiziologjike midis femrës dhe mashkullit. Femra është xhentile, anon më shumë nga dashuria, është shpirtbutë, e dhënë pas estetikës, është më mbresëlënëse. Për këtë arsye gruas i thuhet “gjinia më e ndjeshme”. Burri është më racional, më i fortë fizikisht dhe më i ashpër. Por sipas Islamit, këto dallime nuk janë edhe aq të rëndësishme, sepse edhe natyrën e mashkullit edhe natyrën e femrës i lartësojnë faktorët transcendentale, si “fryrja e shpirtit” dhe “substancia hyjnore”.¹⁷

Burri dhe gruaja, për shembull, përshkruhen si mbulojë të njëri-tjetrit (2:187) dhe si bashkëshortë që jetojnë dhe banojnë në qetësi (33:21; 7:189). Burri dhe gruaja janë dërguar për të plotësuar njëri-tjetrin (9:71). Secilit i kërkohet të përmbushë përgjegjësitë e caktuara, që i janë ngarkuar për të mirën e të dyve dhe të mbarë shoqërisë.¹⁸

GRUAJA ËSHTË PERSONALITET LIGJOR I MËVETËSISHËM

Gruaja ruan identitetin e saj ligjor të mëvetësishëm pas martesës, emrin e saj të vajzërisë, devotshmërinë e saj ndaj një shkolle të veçantë juridike dhe të drejtën e saj për pronësi të parave, të pronës apo të aksioneve të saj financiare.

Ndryshe nga situata në Perëndim, ku deri në shekullin e fundit ishte e pamundur për një grua të martuar për ta mbajtur pasurinë për veten e vet, për të kontraktuar me persona të tjerë, apo për të shfrytëzuar pasurinë e saj pa miratimin e burrit të saj.¹⁹ Kurani shpall të drejtën e çdo gruaje, për të blerë dhe për të shitur, për të kontraktuar dhe për të fituar²⁰ dhe për të mbajtur dhe menaxhuar paratë dhe pronën e vet asaj. Përveç këtyre të drejtave, Kurani i pohon gruas një pjesë në trashëgiminë e familjes (4:7,11) dhe paralajmëron kundrejt privimit të saj prej kësaj trashëgimie (4:19).

Islami specifikoi se gruaja duhet të jetë subjekt, e jo objekt në kontratën e martesës. Kjo kontratë duhet të jetë e ligjshme, marrëveshje e shkruar midis dy njerëzve, e cila bën të nevojshëm propozimin e njëres palë ('ixhab), pëlqimin (kabal) e së dytës, dhe dëshmitarët.²¹

Në fenë islame gruaja është një entitet i pavarur dhe një qenie plotësisht përgjegjëse njerëzore. Islami i drejtohet asaj në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe nuk i qaset me ndërmjetësimin e meshkujve.²²

Ky personalitet ligjor i mëvetësishëm i paracakton çdo gruaje të drejtën për të kontraktuar, për të drejtuar biznesin, për të fituar dhe zotëruar pasurinë në mënyrë të pavarur. Martesa nuk ka pasojë mbi statusin e saj ligjor, mbi pronën e saj dhe fitimet e saj. Ajo është një qenie ligjore që mund ta zotërojë dhe ta drejtojë vetë pasurinë. Pasuria e saj mbetet e vetë asaj edhe kur martohet. Asaj i është dhënë e drejta nga Kurani për të siguruar jetesën dhe për të pasur të ardhura si një individ i pavarur (4:32).

SFIDAT BASHKËKOHORE

Mosbalancimet e shkaktuara prej ndryshimeve të vrullshme sociale janë faktorë të pashmangshëm në çdo shoqëri. Në këto periudha të historisë, ato janë veçanërisht sfiduese.

Numri në rritje i grave të punësuar, arsimi në rritje për gratë dhe për burrat, zhvillimi i vetëdijesimit islam dhe identitetit midis myslimanëve në të gjitha pjesët e botës,

lëvizshmëria në rritje, përqendrimi i popullsisë në qendrat urbane, kontakti në rritje me kulturat e huaja, si dhe shumë fakte të tjera të jetës bashkëkohore, kërkojnë rregullime të caktuara në praktikën martesore në çdo shoqëri. Nëse rregullimet e tilla do të rezultojnë negative ndaj institucionit të martesës islame, apo thjesht produktive prej një sinteze të re të influencave të shek. XXI me premisat esenciale, kjo do të varet nga aftësia e shoqërisë për të reaguar me një vetëdije të fuqishme dhe inteligjente sociale.

Çdo periudhë i është dashur të bëjë "paqen" e vet me këto ndryshime të kushteve, për të marrë atë që është e pranueshme sipas esencës islame dhe për të mos pranuar ato, të cilat janë kulturalisht dhe fetarisht "të patretshme".²³ Kjo është sfidë bashkëkohore, jo vetëm për shoqërinë myslimane, por për çdo shoqëri tjetër në botë.

Myslimanët duhet të jenë të aftë të marrin nga tradita intelektuale islame për t'u siguruar përgjigje sfidave të shtruar nga teori e praktika të ndryshme filozofike dhe shkencore që burojnë nga bota moderne.

- 1 Lois Lamja Faruki, *Gratë, shoqëria muslimane dhe Islami*, përkthet MIMOZA Sinani, Logos-A, 2007, f. 133. Shih dhe Gamal A. Badawy, "Woman in Islam", *Islam: Its Meaning and Message*, ed. Khurshid Ahmad, London: Islamic Council of Europe, 1975.
- 2 Murteza Mutahari, *The rights of women in Islam*, Teheran, 1980, f. 21.
- 3 Lois Lamja Faruki, po aty, f. 62, 118-119.
- 4 Ruqayyah Waris Maqsood, *Fshehtësia e një martesë të lumtur*, Shkup, 2006, f. 19.
- 5 Lois Lamyael-Faruki, Muhammed Xh. Bahonari, Muhammed Sharif, *Femra nën mbrojtjen e Islamit*, Gjilan, 199, f. 56
- 6 Ibrahim Amini, *Etika bashkëshortore*, Tetovë, 2003, f. 6, 14, 15, 21.
- 7 Ahmed Hurshid, *Familja dhe Islami*, Tiranë, 1999, f. 19. Shih dhe Arthur Jeffery, "The Family in Islam," *The Family: Its Function and Destiny*, bot. Ruth Nanda Anshen (New York: Harper dhe Row), 1959.
- 8 Hamudeh Abd-UL-Ati, *Islami në fokus*, Shkup, 1992, f. 215.
- 9 Ibrahim Amini, po aty, f. 11.
- 10 Hammudah 'Abd al 'Ati, *The Family Structure in Islam* (Indianapolis: American Trust Publications, 1977), f. 50.
- 11 Lois Lamja Faruki, po aty, f. 136.
- 12 Ali Bulaç, *Koncepte dhe sisteme bashkëkohore*, Logos-A, 2005, f. 275.
- 13 Lois Lamja Faruki, po aty, f. 81.
- 14 Dr. Murad Hofmann, *Islami si alternativë*, Shkup, 2000, f. 170.
- 15 Hassan Hathout, *Leximi i mendjes së muslimanit*. Tiranë, 2005, f. 96.
- 16 Lois Lamja Faruki, po aty, f. 66, 88.
- 17 Ali Bulaç, po aty, f. 273.
- 18 Lois Lamja Faruki, po aty, f. 89.
- 19 Monard G. Paulsen, "Women, Legal rights", *Encyclopedia Americana* (Danbury, Conn.: Americana Corp., 1980), Vol. 29, f. 108-109.
- 20 "... burrave u takon hise nga ajo që fituan ata dhe grave gjithashtu ju takon hise nga ajo që fituan ato..." (4:32)
- 21 Asaf A. A.Fyze, *Outlines of Muhammadan Law*, (London: Oxford University Press), 1955, f. 74.
- 22 Dr. Hasan Turabi, *Gruaja në Islam*, Prishtinë, 1997, f. 9.
- 23 Lois Lamja Faruki, po aty, f. 153. Shih dhe Hammudah 'Abdal-'Ati, "Modern Problems, Classical Solutions: An Islamic Perspective on the Family", *Journal of Comparative Family Studies* (1974) 5 (2); 37-54.


Familja e shëndoshë për një shoqëri të shëndoshë

Dr. Mirsad ASLANI - Mr. sci. Sebadin KRASNIQI

Familja është grupi shoqëror më i vjetër dhe më i qëndrueshëm, i bazuar në lidhjet bioriprodhuese, biosociale, socio-mbrojtëse dhe socio-ekonomike të burrit dhe gruas dhe fëmijëve të tyre, të cilat janë të ndërlidhura nga formimi i familjes.¹

Vlera dhe rëndësia e familjes gjithnjë e më shumë vije duke u bërë më e dukshme, dhe ajo shfaqet si një domosdoshmëri në kohën moderne. Për të, do të duhej që të gjithë anëtarët e shoqërisë të kujdesen, e veçanërisht duhet përkujdesje edhe nga shteti, duke e ndihmuar sendërtimin e saj moralisht dhe materialisht. Sot, kur të gjitha vlerat njerëzore, pra edhe ato fetare, nga themeli janë lëkundur dhe kur as familja nuk është kursyer, dëftohet nevoja e veçantë që vlera e saj të theksohet e të ndriçohet te të gjitha shtresat e shoqërisë.²

Koncepti edukativo-islam i bashkëjetesës harmonike e sheh familjen si faktor stabiliteti dhe insiston me të gjitha mekanizmat në formimin e saj si celulë themelore dhe të shëndoshë të një brezi shoqëror. Asaj, i kushton vëmendje të veçantë, si dhe përcakton bazat themelore mbi të cilat ajo duhet të zhvillohet. Vetëm në këtë mënyrë njerëzit do të përmbushin kuptimin e ekzistencës së tyre njerëzore në këtë botë dhe të arrijnë lumturinë



e natyrshme njerëzore. Kështu, ata pastaj do të ndjejnë mëshirën, ngrohtësinë dhe dashurinë familjare dhe rrjedhimisht do të kalojnë një jetë të dinjitetshme, siç i ka hije krijesës më të përsosur të Zotit, njeriut. Në këtë mënyrë na mëson edhe Zoti Mëshirëplotë, se familja dhe shtëpia si vendbanim i rëndomtë i saj është vendpërhyje për njeriun. Ai në Kuranin Fisnik na tha: “Dhe njëri prej argumenteve të Tij, është që prej jush janë krijuar femrat, që të qetësoheni pranë tyre, dhe që në mes jush të lind (vendoset) dashuria dhe mëshira. Me të vërtetë, në këtë, ka argumente për njerëzit që mendojnë.” (Err-Rrum, 21). Pra, mund të shohim që Zoti Mëshirëplotë e ka vendosur familjen mes dukurive më të bukura dhe më madhështore brenda këtij universi dhe e ka konsideruar shenjë prej shenjave të madhërisë së Tij.

Shtëpia është simboli i qetësisë dhe rahatisë. Me këtë, sikurse Zoti na thotë që nëse kërkon qetësinë dhe rahatinë, atë e gjeni në shtëpitë tuaja me familje.³ Shumë sociologë e konsiderojnë familjen si fundamentin themelor të të gjitha shoqërive. Ajo përbën njësinë bazë të organizimit shoqëror dhe është e vështirë të imagjinohet se si shoqëria njerëzore mund të funksiononte pa familje.⁴



Në të gjitha shoqëritë perëndimore, por jo vetëm, shohim rënie të shkallës së lindshmërisë, në kontrast, ne shohim një gjendje pak më premtuese në shoqëritë myslimane. Kjo, ngase Islami, feja e Zotit i inkurajon njerëzit të shtohen e të kenë fëmijë dhe kështu ta vendosin themelin e fortë të familjes.

Zoti u ka premtuar prindërve shumë shpërblime për preokupimin dhe punën e tyre të lodhshme si dhe për sakrificat që i bëjnë në rritjen dhe edukimin e fëmijëve dhe familjes së tyre. Islami i konsideron si shpenzimet - sadakatë më të mira shpenzimet që prindi i bën për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e familjes, dhe për këto premtim shpërblime të mëdha.⁵ E mbi të gjithë, të kujtojmë faktin se, Zoti Mëshirëplotë, fëmijët i përshkruan si stolitë dhe pasuria më e bukur e kësaj bote, të cilët vijnë në jetë vetëm si fryt dhe rezultat i martesës, pra jetës familjare: “Fëmijët janë stoli të kësaj bote ...” (Kehf, 46).

Humoristja e njohur amerikane, Erma Louise Bombeck, për fëmijët dhe rolin e tyre për një shoqëri të shëndoshë dhe të lumtur thotë: “Fëmijët i japin rëndësinë (kuptimin) jetës tuaj.”⁶ Lirisht mund të themi se familja është komuniteti më i fortë në shoqëri si në të kaluarën, ashtu edhe në këtë kohë bashkëkohore-moderne. Edukimi islam na orienton kah

parimi se zhvillimi i shëndosh pedagogjik-social i një shoqërie kryesisht varet nga zhvillimi dhe përparimi i familjes së shëndoshë, të edukuar, arsimuar.

Shpërbërja e sistemit arsimor dhe i familjes së shëndoshë është edhe shpërbërje dhe shkatërrimi i të gjithë shoqërisë në një të ardhme të afërt apo të largët. Kështu që, Islami me mësimet e tij edukuese që nga fillet e tij, e sheh zhvillimin dhe mbijetesën e familjes në shoqëri si qelizë bazë nga e cila formohet mirëfilli i gjithë komuniteti dhe vetëm në këtë mënyrë ai mund të mbijetojë dhe të jetë i shëndoshë.

- 1 Savo Trifunović, “Sociološki leksikon, Savremena administracija – (Leksikoni Sociologjik, Administrata Bashkëkohore).”, UB, Beograd, 1982., f.471.
- 2 Grup autorës, “Islamski obiteljski život – (Jeta familjare islame).”, Përkth: Nexhat Ibrahim, Zëri Islam, Prizren, 1996, f.4.
- 3 Amër Halid, “Rëndësia e familjes në islam”, Përkth: Elmaz Fida, Furkan - ISM, Shkup, 2008, f.14.
- 4 Michael Haralambos, “Uvod u sociologiju. - (Hyryje në sociologji).”, Globus, Zagreb, 1994, f.4.
- 5 Dr. Muhammed Ali el Hashimi, “The ideal Muslim Society: As Defined in the Quran and Sunnah – (Shoqëria ideale muslimane sipas Kuranit dhe Suneti)”, Përkth: Driton Maxhuni, Botoi: Fjala e Bukur, Prishtinë, 2013, f.369-370.
- 6 Erma Louise Bombeck (1927-1996), është një nga humoristët më të njohura në historinë e Amerikës e cila është shkrimtare e pesëmbëdhjetë librave dhe mbi katër mijë shkrimeve në mbi nëntëqind gazeta të ndryshme në SHBA dhe Kanada. (Për më gjerë shih: https://en.wikipedia.org/wiki/Erma_Bombeck, e qasur më 11.11.2021).

Muhamedi a.s., shëmbëlltyrë e papërsëritshme

Isa TËRSHANI

Nuk ka dyshim se i Dërguari i Allahut, Muhamedi a.s. ishte dhe do të mbetet kandil ndriçues, i cili ua ndriçon rrugën të gjithë atyre që duan ta njohin personalitetin e tij dhe ta ndjekin rrugën e tij. Ai gëzonte të gjitha tiparet fisnike e morale, të cilat si veçori ia kishte dhuruar vetë Zoti xh.sh.. Lidhur me këtë, Allahu xh.sh. në Kuran ka thënë: “Ju e kishit shembullin më të lartë në të dërguarin e Allahut...” (El Ahzab, 21)

Shëmbëlltyra dhe veprimtaria e të Dërguarit të Allahut a.s. duhet të jenë tipare të pandashme të sjelljeve dhe përditshmërisë sonë, apo thënë ndryshe, shëmbëlltyra e tij duhet të jetë pasqyrë, ku çdo mysliman do të bëjë krahasimin e jetës dhe veprimtarisë së tij nëse janë në përputhje me sjelljet dhe veprat e tij. Ndjekja e hapave të Muhamedit a.s. duhet të jetë pjesë e kulturës dhe përditshmërisë sonë, e kjo nënkupton që syneti-praktika e tij të jetë themel mbi të cilën ngritën veprimet tona.

Shëmbëlltyra e tij duhet të jetë prezentë në çdo pore të jetës sonë, në jetën dhe përditshmërinë tonë, në tryezat dhe ndejat tona, në transaksionet dhe sjelljet tona. Kjo nënkupton që të gjitha veprimet tona duhet të bëhen në përputhje me atë që ka porositur i Dërguari i Allahut xh.sh..1

Është një e vërtetë e pamohueshme se admirimi i personalitetit dhe karakterit të një njeriu të dashur, si dhe

përpykja për ta imituar atë, është një prirje e natyrshme e bashkëlindur. Prandaj për njeriun, gjetja e modeleve të përkryera dhe mundësia për të ecur në gjurmët e tyre është një intuitë jashtëzakonisht me rëndësi me të cilën pothuajse edhe lindim. Për këtë arsye, Zoti i Madhërishëm, me mirësinë dhe bujarinë e Tij të pafundme, jo vetëm që i ka zbritur njeriut librat, por Ai i dërgoi edhe pejgamberët, të cilët ishin shprehja e gjallë e atyre librave. Pra i ka dërguar personalitete shembullore që të paraqesin përsosmërinë e qëndrimeve dhe sjelljeve fetare dhe etiko-morale.2

Përgjatë jetës së tij 63 vjeçare sa jetoi Muhamedi a.s., ai më shumë përjetoi momente të vështira e me vuajtje, se sa momente të këndshme. Ai ishte jetim, ishte bari, ishte punëtor krahu, për ta siguruar kafshatën e gojës. I pakënaqur me besimin e popullit të tij, i urryer për shkak të besimit të drejtë që proklamonte, i lëçitur e bojkotuar për shkak të vlerave që i përcolli tek ata. Atij i vdiqën madje të gjithë djemtë e tij. Është gjuajtur me gurë, ka jetuar si muhaxhir, i syrgjynosur, i helmuar, por mbi të gjitha dhe krejt në fund, ai doli me ndihmën e Zotit të tij fitimtar i pakrahasuar. Pejgamberi a.s., e dëgjonte çdonjërin kur fliste, dhe nuk e ndërpriste, derisa bashkëbiseduesi vetë nuk heshtte. Të pambrojturit i ndihmonte, të pastrehët i strehonte, të uriturit i ushqente, sekretet i mbante në fshehtësi, ndërsa të paditurit i mësonte. Ai ishte i qetë kur të tjerët i kaplonte paniku dhe ishte plot dashuri kur të tjerët urrenin. Me të paedukuarit sillej me shumë dashamirësi. Pra, ai ishte njeriu, që ishte i matur në të gjitha gjërat.

Në namaz e gjente kënaqësinë dhe mbështetjen. Nga frikë respekti, zëri i dridhej përpara Zotit, kurse, kur njerëzit i udhëhiqte në namaz, preferonte gjithmonë të lexonte sure të shkurtra. Në rast se dëgjonte ndonjë zë fëmije, namazin e ndërpriste dhe shikonte se si t'i ndihmojë atij. Kur nipërit i hipnin mbi shpinë, teksa bënte sexhdenë, ai nuk lëvizte nga pozita, gjersa ata të kënaqeshin dhe largoheshin vetë. Kur lexonte nga Kurani, lexonte sipas llojeve të ndryshme të leximeve, me qëllim që t'i kënaqte edhe shokët e tij, të cilët vinin nga fise me dialekte të ndryshme. Falej edhe pas mesnate, herë më shumë e herë më pak. Kur lexonte ajetet që tregojnë për mëshirën e Allahut xh.sh., ndalej dhe lutej për t'u mëshiruar, e kur lexonte nga ajetet që tregojnë hidhërimin dhe dënimin e Tij, ndalej dhe lutej për të shpëtuar prej tyre.

Muhamedi a.s., asnjëherë nuk lëshohej në thashetheme. Ai fliste këndshëm dhe qetë, me përjashtim vetëm kur mbante hytben. Zërin e kishte melodik dhe tërheqës. Fliste vetëm sipas nevojës, dhe nuk lëshohej në “thashë e thënë”. Ai gjithmonë e fliste vetëm të vërtetën, si dhe shpesh dëshironte



të dëgjonte. Ai ishte modest, buzëqeshte, mirëpo kurrë nuk ia jepte të qeshurës me të madhe. Kur ishte i pa humor, kjo vërehej shumë shpejt në fytyrën e tij. Ai asnjëherë, kundër asnjë qenie të gjallë, nuk e ka ngritur dorën, përveç kur ka qenë i urdhëruar me Shpallje. Në momentet më të vështira ishte i guximshëm dhe i vendosur. Gjithmonë solidarizohej me shokët (sahabët) e vet. Ai hante kur hanin ata, si dhe flinte, kur flinin ata. Kur hante, nuk dëshironte të ngopej, e në mënyrë të veçantë i shmangej teprimit. Ai nuk kishte dëshirë të hante i vetëm. Nga ushqimet preferonte qumështin, hurmat dhe mjaltin. Zakonisht vishej sikur edhe shokët e vet. Me asgjë nuk dallohej prej tyre. Me një fjalë, historia nuk ka shënuar të ketë pasur ndonjë njeri sikur ai. Ai gjithmonë kujdesej për rrethin ku jetonte, si dhe nuk e donte prishjen e raporteve. Ai e ruante ambientin, bimët dhe shtazët, ndërkohë që këtë traditë ua sugjeronte edhe të tjerëve.

Pejgamberi ynë, na donte neve më shumë sesa prindërit tanë. Ai gjithmonë mendonte edhe për ata që do të vijnë pas tij, sepse ishte një vizionar shumë i madh. Të gjithë të dërguarit e mëparshëm e lutën Allahun e Madhëruar për realizimin e disa prej nevojave të popujve të tyre, kurse Muhamedi a.s., lutjen e tij, e la për Ditën e Gjykimit, kur do të lutet për umetin e vet. Pra, ai do të lutet për ne, që ne të na mëshirojë e të na falë Allahu, xh.sh.. Askush nuk mund të pretendojë se e do Pejgamberin a.s., gjersa ai nuk konsiderohet më i dashur për të, madje edhe më tepër sesa prindërit, bashkëshortja/i, fëmijët, madje edhe më tepër sesa vetja. Ta duash Pejgamberin a.s., në të vërtetë do të thotë ta njohësh atë dhe t'ia zbatosh porosinë.

Pejgamberi a.s., ishte mishërim i përsosur i Kuranit famëlartë. Gruaja e tij, Aisheja, r.a., e kishte përshkruar si “Kurani i cili ecë mbi tokë”. Ndërsa vetë Kurani famëlartë, për të thotë që është “rahmetun lil alemin” - mëshirë për të gjithë botët, “usvetun haseneh” - shembulli më i mirë, dhe “ala hulukin adhim” i krijuar me moralin më të përsosur. Ishte nga më të devotshmit, mirëpo njëkohësisht, e kuptonte edhe se të gjithë njerëzit janë në gjendje të barabartë për t'i zgjeruar kufijtë e njohjes dhe të devotshmërisë.

Se sa ishte tolerant dhe i butë ndaj të paditurve, flet edhe rasti i njerit nga beduinët, i cili kishte urinuar në xhami. Disa shokë të tij (sahabë) kishin filluar që ta kritikonin atë beduinin dhe kishin kërkuar që të dënohej, por Pejgamberi ynë i dashur, me butësinë e tij, kishte insistuar që të mos pengohej beduini derisa ta mbaronte, e më pastaj, vetë e kishte pastruar vendin e papastër. Pas kësaj, e këshilloi beduinin se gjërat e këtilla nuk lejohen të veprohen në xhami.

Pejgamberi a.s., shtëpinë e kishte të ndërtuar nga thuprat dhe balta, ndërsa hapësira e dhomave ishte aq sa mezi kishin mundësi të qëndronin dy vetë. Ai flinte në një lëkurë të fortë, ashtu që, shenjat e rrjepjes së lëkurës, i vëreheshin në trup. Ai, a.s., i dëgjonte me vëmendje bashkëshortet dhe shokët e tij, dhe nuk e kishte zakon që të pohonte se dinte më tepër se ta në çështjet që i përkisnin kësaj bote. Ai ishte një shembull i përkryer se si duhet jetuar, dhe jo vetëm për myslimanët, por edhe për tërë njerëzimin.

Së këndejmi, nga kjo që u tha mund të konkludojmë se karakteri shembullor, sjellja dhe morali i të Dërguarit të Allahut, a.s., i ngjanë një oqeani të pafund. Ai i zotëronte të gjitha cilësitë dhe virtytet dalluese, të njohura dhe të panjohura, të të gjithë pejgamberëve që erdhën para tij dhe përfaqësojnë mishërimin e karakterit dhe cilësive fisnike. Vetë Allahu xh.sh., e ka cilësuar Muhamedin a.s., duke thënë: “Vërtet, ti je me një shkallë të lartë të moralit.”³ Ndërsa Muhamedi a.s., kur është pyetur për qëllimin e dërgimit ka thënë: “Unë jam dërguar për të përsosur virtytet e larta morale!”⁴

Nëse sot do të takoheshim me Pejgamberin a.s., a do të kishte mundësi ai që te ne, të dallonte shenjat se jemi pasuesit e tij? Andaj, le të mundohemi ta pasojmë Pejgamberin tonë, Muhamedin a.s., që nesër në ditën e Gjykimit të jemi nën flamurin e tij.

1 Bashkim Aliu., “Mozaiku Islam”, Shkup, 2014, f.75.

2 Doç.dr. Omer Çelik, dr. Mustafa Ozturk, Murat Kaja, “Personaliteti shembullor”, vëllimi I, përktheu: dr. Mithat Hoxha. Shkodër, 2010, f. 17.

3 El-Kalem, 4.

4 Buhariu, 273. Ahmedi, 8939.

Sa të jem gjallë selam të çojmë

O Muhamed o i Dërguar,
Për dy kible je imam,
Vetëm për ty ia vlen për të shkruar,
Qe katërmbëdhjetë shekuj të çojmë selam.

Lindja jote të gjithë i gëzoi,
Burra, gra, e pleq e fëmijë,
Në Tevrat e Inxhil Zoti paralajmëroi,
Ahmed - Muhamed Mustafaja do të vijë.

Kur ti linde, të gjithë i mahnite,
Pa komplikime erdhe në këtë botë,
Kështu dëshmoi nëna Eminen
Me isharet dëshmove të Vetmin Zot.

Pa babë u linde, jetim u rrite,
Që t'ia dish rëndësinë jetimit,
Zoti të bëri kandil drite,
Shëmbëlltyrë e gjithë njerëzimit.

Qysh në fëmijëri shenjat u duken,
Se do të jesh ti një Profet,
Nënë Halimes që të dha gjirin,
Zoti i dha shumë bereqet.

Ishte e ndjeshme dhe e dhimbshme,
Lindja jote pa baba,
Por pikëllimi arriti kulmin,
Kur nënë Emineja vdiq në vendin Ebwa.

Kështu vitet shumë shpejt shkuan,
I palodhur e i pa përtesë,
Me gjithë vuajtjet e rënkimet,
Muhamedi i mbushi njëzet e pesë.

Me Hatixhen u martua,
Përkundër distancës në moshë,
Me shtatë fëmijë nga Zoti u bekuan,
Dashurinë e kishin të shëndoshë.

Dalëngadalë po ecin vitet,
Kur i mbushi katër dhjetë,
Nga Allahu i erdhi shpallja,
Edhe grada për Profet.

Lexo! Mëso! Studio! Ishin fjalët e para,
Vazhdoi shpallja njëzet e tri vjet,
Edhe pse sprovat ishin të papara,
Trembëdhjetë në Meke, në Medine dhjetë.

Si çdo fillim që e ka fundin,
Kështu ndodh edhe me profet,
Vdiq e shkoi më i miri njerëzimit,
Kur i mbushi gjashtëdhjetë e tri vjet.

Ti je ai, që aq shumë qave,
Edhe pse ne kurrë s'na ke pa,
Kur të pyeten se çka ke ti?!
“Jam përmallu, the: për të dashurit e mi.”

Andaj edhe ne ty shumë të dojmë,
Sa të jem gjallë selam të çojmë,
Nuk të harrojmë ne kurrë përjetë,
Na bashkoftë Zoti në Xhenet.

Sal-li Ala Muhamed!

Rexhep Gurgurovci
20 Tetor 2020
03 Rabiul Ewel 1442

Sylejman Çelebiu dhe vepra e tij “Vesiletu’n-Nexhat” (Mevludi)

PhD(c) Besir Neziri

Me rastin 600-vjetorit të vdekjes së Sylejman Çelebiut, autorit të veprës “Vesiletu’n-Nexhat” apo siç njihet në popull “Poeti i Mevludit”, UNESCO (Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë), mori vendim që viti 2022 të shpallet “Viti i Sylejman Çelebiut”. UNESCO, me propozimin e Republikës së Turqisë, në Konferencën e Përgjithshme të 41-të të saj, mori vendim që viti 2022 të shpallet “Viti i Sylejman Çelebiut”, dhe që 600-vjetori i vdekjes së Sylejman Çelebiut të përfshihet në programin e përvjetorëve dhe festimeve të UNESCO-s.¹ Me këtë rast u pa e udhës të shkruhet pak për këtë poet të madh

dhe për veprën e tij, Mevludin, i cili që nga dita e parë e shkrimit e deri në kohën tonë, shekuj me radhë, është kënduar dhe vazhdon të këndohet me zë të bukur në kuvende dhe ceremoni të ndryshme.

SYLEJMAN ÇELEBIU

Sylejman Çelebiu është poeti i skalitur në mendjet e besimtarëve myslimanë me veprën e tij të njohur, Mevludin, të cilin e shkroi me dashurinë e tij të madhe për Muhamedin, paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të. Për jetën e këtij poeti të madh nuk ka informacione të mjaftueshme. Mendohet sa



ka lindur në Bursa në vitin 1351 (752 h.). Babai i tij ishte Ahmed Pasha, djali i Shejh Mahmudit, i cili ishte myderriz në medresetë e Iznikut në kohën e Orhan Gazit dhe një nga vezirët e periudhës së Sulltan Muradit I.

Informacione të mjaftueshme nuk ka edhe për shkollimin e tij. Mirëpo, fakti që ai ishte emëruar si imam në pallatin mbretëror të Sulltan Bajazitit dhe më vonë si imam i “Ullu Xhamisë” në Bursa me propozimin e Emir Buhariut, tregon se ai mori një arsimim të mirë dhe ishte njohës i mirë i shkencave islame. Edhe fakti që ai është quajtur me llagapin “Çelebi”, tregon se ai ka qenë nga dijetarët e njohur të kohës, ngase ky llagap në periudhën osmane iu është dhënë dijetarëve.²

Mendimi i përgjithshëm është se Sylejman Çelebiu vdiq në vitin 825/1422. Varri i tij është në Bursa, te varrezat e zavijes Yoğurtlu Baba në lagjen Çekirge.³ Vepra kryesore dhe e vetme e Sylejman Çelebit është “*Vesiletu'n-Nexhat*”.

“VESILETU'N-NEXHAT”

“*Vesiletu'n-Nexhat*”, që në shqip do të thotë “Rruga e shpëtimit”, është vepra më e njohur, më e pëlqyer dhe më e lexuar në letërsinë turke, e cila në popull njihet me emrin *Mevlud*. Kjo vepër, e cila ka arritur deri në ditët e sotme duke e shtuar famën dhe ndikimin e saj çdo shekull e më shumë, konsiderohet vepra e parë në llojin e mevludit dhe si prototipi dhe shembulli më i bukur i veprave të shkruara në këtë lloj në letërsinë turke.

“*Vesiletu'n-Nexhat*” apo *Mevludi* është shkruar në vitin 1409 (h. 812) derisa Sylejman Çelebiu ishte imam i “Ullu Xhamisë” në Bursa. Kjo vepër është shkruar me metrin e vargut “fâilâtun fâilâtun fâilun” dhe në stilin masnavi me një turqishte të thjeshtë. Përbëhet prej 16 kapitujve dhe 768 dyvargeve (bejteve).⁴ Idetë, njohuritë dhe emocionet në të janë shpjeguar me një stil mjaft artistik.

Fillon me një lutje në prozë, pastaj vijnë titujt e kapitujve si më poshtë: Njeshmëria e Allahut, kërkimi i lutjes për shkruenin dhe kërkimfalja për librin, arsyeja e krijimit të botës, krijimi i shpirtit të Muhamedit, a.s., formimi i trupit të Muhamedit, a.s., ndodhitë e jashtëzakonshme gjatë lindjes së Muhamedit, a.s., lavdërimi i Pejgamberit, a.s., shpjegimi i mu'xhizeve, miraxhit (ngritjes në qiell) dhe hixhretit të tij, shpjegimi i disa veçorive të tij, këshilla, largimi nga punët e këqija, transmetimi i pejgamberllakut, vdekja e Muhamedit, a.s., dhe përfundimi.⁵

QËLLIMI I SHKRIMIT

Sylejman Çelebiu këtë vepër e shkroi për dy qëllime, e para është ngjarja që e ka përjetuar sa ishte imam në “Ullu Xhami”. Një ditë, teksa një vaiz iranian po ligjëronte në këtë xhami, komentoi kuptimin e ajetit 285 të kaptinës El-Bekare: “...**Ne nuk bëjmë dallim mes asnjërit prej të dërguarve të Tij...**”

Gjatë interpretimit të këtij ajetit, ai thotë se: “Nuk ka asnjë dallim apo epërsi ndërmjet Muhamedit a.s dhe Isait a.s.. Një arab i ditur dhe i zellshëm fetar, një nga ashikët e vërtetë të Dërguarit të Allahut, i cili ishte në mesin e xhematit, e kundërshtoi këtë duke sjellë argumente të forta dhe të prera duke thënë se ky kuptim është i gabuar: “O xhahil! Ti je i dobët në shkencën e tefsirit. Qëllimi i thënies “nuk ka dallim mes pejgamberëve” është në aspektin e profetësisë (nubuvvetit dhe risaletit), e jo në aspektin e gradës dhe virtytit. Nëse do të ishte në të gjitha aspektet, atëherë si komentohet ajeti i 253 i sures El-Bekare: “Nga këta të dërguar, disa syresh i ngritëm mbi të tjerët.”

Megjithëkëtë xhemati ia mbanë anën vaizit. Pas kësaj, ky person shkoi në tokat arabe, në Egjipt dhe Halep, dhe gjashtë



Portreti i Sylejman Çelebiut

herë solli fetva në favor të mendimit të tij, por vaizi prapë insistoi në mendimin e tij. Në fund me fetvanë e shtatë arrin ta mund vaizin.

Sylejman Çelebiu përcolli nga afër këtë diskutim, i cili ndau në dy grupe xhematin, dhe pa të nevojshme të shkruante një vepër për të kuptuar mirë dhe saktë virtytet dhe gradën e Pejgamberit tonë, a.s. dhe për të parandaluar disa ide të gabuara. I ndikuar nga fjalët e vaizit Sylejman Çelebiu e thuri këtë poezi:

*Isa nuk vdiq por u ngjiti në qiell,
Për t'u bërë nga ymeti i tij ishte kjo.
Edhe shkopi në dorë të Musait,
Për nder të tij u bë gjarpër i madh.
Shumë e lutën Hakkin këta,
Prej ymetit të Muhamedit të jenë,
Në të vërtetë këta janë të dërguar,
Por Ahmedi është më i virtytshmi e më
bujari.*

*Ngase është më meritori për këto virtyte,
I pamend është ai që nuk e njeh kështu atë.*

Sylejman Çelebiu në këto vargje, ngritjen e Isait, a.s., në qiell e ndërlihd me dëshirën e tij për t'u bërë ymeti i Muhamedit a.s., në të ardhmen. Gjithashtu thekson se edhe kthimi i shkopit të Musait a.s. në gjarpër tregon madhështinë e nderit të Muhamedit a.s. dhe se shumë pejgamberë kërkonin nga Zoti që të jenë pjesë e ymetit të Muhamedit a.s., i cili është më i virtytshëm dhe më i përsosur se ata, edhe pse të gjithë ishin të dërguar të Zotit.⁶

Këto vargje u pëlqyen shumë nga i gjithë xhemati, i madh e i vogël, dhe kjo u bë motiv për Sylejman Çelebiun për të shkruar Mevludin.

Ndërsa qëllimi i dytë i shkrimit të Mevludit ishte për të reduktuar apo edhe për të eliminuar ndikimin e atyre që donin të shkatërrojnë besimin e Ehli Sunetit dhe të atyre që propagandojnë lëvizjen batinije (ezoterizëm), e cila përfaqëson sektet ekstremiste shiite që nuk pranojnë kuptimet e jashtme të teksteve kuranore dhe mbrojnë pikëpamjen se vetëm “imami i pafajshëm” që mund të lidhet me Zotin mund ta dijë kuptimin e tyre të vërtetë.⁷ Në një periudhë

kur Perandoria Osmane mund të konsiderohej e dobët (kur ajo sapo ishte formuar), në një kohë kur të gjitha llojet e rrymave politike, intelektuale dhe fetare ishin prezentë, Sylejman Çelebiu doli në anën e Ehli Sunetit dhe ndihmoi në parandalimin e kolapsit të shtetit.

Sylejman Çelebiu gjithmonë ka mbrojtur pikëpamjet e Ehli Sunetit si në çështjet e besimit, ashtu edhe në çështjet e tjera, dhe në veprën e tij, nga fillimi e deri në fund ka mbrojtur besimin e Ehli Sunetit.⁸

Sipas historianëve, Perandoria Osmane i kushtoi rëndësi të madhe Mevludit për të përhapur besimin e Ehli Sunetit dhe për të parandaluar përhapjen e sekteve supersticioze. Sulltanët osmanë, shejhulislamët dhe dijetarët e famshëm të asaj kohe kanë marrë pjesë personalisht në ceremonitë e mevludit, por njëkohësisht kanë organizuan edhe vetë ceremoni të mevludit.⁹

BURIMET E “VESILETÛ’N-NEXHAT” (MEVLUDIT)


Sylejman Çelebiu gjatë përgatitjes së Mevludit, burim kryesor e ka pasur Kuranin dhe hadithin e Muhamedit, a.s.. Për ta lavdëruar dhe prezantuar Muhamedin, a.s., dhe moralin e tij sipas parimeve islame para se gjithash kërkohet njohja e mirë e Kuranit. Kur analizohet renditja e titujve të kapitujve dhe nënkaptujve të Mevludit, shihet se ajo është bërë sipas trinomit “Besim-profetësi-moral”, të cilat janë nga temat boshte të Kuranit. Sulejman Çelebiu me shkrimin e Mevludit dhe me përpikërinë e tij në shpjegimin e dispozitave islame në veprën e tij, dëshmojnë se ai e ka njohur shumë mirë Kuranin dhe hadithin e Muhamedit, a.s., dhe se ka pasur njohuri për fazat e rëndësishme të jetës së tij. Andaj kjo vepër nga fillimi deri në fund, në çdo varg mbart gjurmë të Kuranit, hadithit dhe moralit islam.¹⁰

Tema dhe përmbajtja e tekstit të Mevludit të Sylejman Çelebiut, por edhe të mevludeve të tjerë, në njëfarë mënyre hynë në kuadër të sires së Pejgamberit a.s., e cila është një prej

Mevludi i Sylejman Çelebiut, i cili është përkthyer në shumë gjuhë si në atë angleze, gjermane, boshnjake, bullgare, çerkeze, greke etj., ka pasur shtrirje të madhe edhe te shqiptarët dhe është përkthyer shumë herë edhe në gjuhën shqipe.

shkencave islame. Kjo ngase temat kryesore të mevludit janë fazat e ndryshme të jetës së të Dërguarit tonë, a.s..

Shumë studiues që janë marrë me këtë çështje dhe burime të ndryshme, tregojnë që ndër burimet e tekstit të mevludit është edhe libri “*Garibname*” e Ashëk Pashës dhe “*Sijeri’n-Nebi*” i Daririt. Përveç kësaj, të njëjtët studiues pohojnë se vepra e lartpërmendur e Daririt është përkthim i sires së Ebu’l-Hasan Bekrit dhe për këtë arsye siren e Ebu’l-Hasan Bekrit e fusin në mes të burimeve të mevludit. Ndërsa studiuesi Ahmet Atesh mendon se Sylejman Çelebiu është ndikuar edhe nga mevludi i titulluar “*Mevlidi’l-Kebir*” ose “*Urfu’t-Ta’rif bi’l-Mevlidi’sh-Şerif*”, i shkruar nga dijetari i famshëm i këndimit (kiraatit) Ibnu’l-Xhezerit (v. 833/1429), apo edhe prej ndonjë burimi tjetër.¹¹



Faksimil i ballinës së Mevludit prej hafëz Ali Ulqinakut

Ali Riza Ulqinakut e deri në ditët tona. Këto mevlude, të cilat në fillim janë shkruar me alfabetin turko-arab, e më vonë me alfabetin shqip, kanë qenë përkthime e përshtatje ose nën ndikimin e fuqishëm të mevludit të Sylejman Çelebiut, kurse mevludet e shkruar pas viteve të '80-ta janë të shkëputur nga ndikimi i drejtpërdrejtë i mevludit të Çelebiut.¹³

Mund të thuhet pa hezitim se mevludi i Sylejman Çelebiut me emrin “*Vesiletu’n-Nexhat*” është një nga veprat turke më të ribotuara dhe më të lexuara ndër shekuj në Perandorinë Osman. Nuk ka asnjë bibliotekë që ka dorëshkrime e të mos ketë më shumë se një kopje të këtij mevludi turqisht dhe në gjuhë të ndryshme. Kjo vepër e madhe luajti rol të madh për ruajtjen dhe kultivimin e fetarësisë të myslimanët në Perandorinë Osmane dhe jo vetëm.

PËRKTHIMET E MEVLUDIT TË SYLEJMAN ÇELEBIUT NË GJUHËN SHQIPE

Mevludi i Sylejman Çelebiut, i cili është përkthyer në shumë gjuhë si në atë angleze, gjermane, boshnjake, bullgare, çerkeze, greke etj., ka pasur shtrirje të madhe edhe te shqiptarët dhe është përkthyer shumë herë edhe në gjuhën shqipe.¹²

Mevludi në letërsinë shqiptare ka filluar të jetë i pranishëm që nga shek. XVIII, kur Hasan Zyko Kamberi shkroi poemën për lindjen dhe miraxhin e Muhamedit a.s., e cila konsiderohet mevludi i parë i shkruar në gjuhën shqipe me alfabetin arab. Më pas janë shkruar mbi 30 lloje të mevludeve në shqip. Nga më të njohurit janë: mevludi i hafëz Ali Ulqinakut, mevludi i hafëz Ali Korçës, mevludi i Ahmed Shkodrës, mevludi i hafëz Abdullah Zemlakut dhe mevludi i Tahir ef. Popovës.

Mevludet në gjuhën shqipe ndahen në dy periudha. Në periudhën e parë hyn mevludet e shkruar ndërmjet Hasan Zyko Kamberit dhe hafëz Ali Ulqinakut siç janë: mevludi i Ismail Floqit, Abdullah Sulejman Konispolit dhe Haxhi Ciçko, të cilët janë pak të njohur për lexuesit shqiptarë. Kurse në periudhën e dytë bëjnë pjesë mevludet e shkruar prej H.

1 <https://www.unesco.org.tr/home/AnnouncementDetail/5983>

2 Halil Şirin, *Süleyman Çelebi'nin Vesiletü'n-Necat (Mevlid-İ Şerif) Adlı Eserindeki Hadis Dayanakları ve Değerlendirilmesi*, (Yüksek Lisans Tezi), Süleyman Demirel Üniversitesi Sosyal Bilimler Enstitüsü, Isparta, 2016, fq. 7.

3 A. Necla Pekolcay, “Mevlid”, *TDV İslam Ansiklopedisi*, İstanbul 2004, c. XXIX, fq. 486.

4 Po aty.

5 Po aty.

6 Süleyman Çelebi, *Mevlid (Vesilet-ün-necat)*, haz. Faruk Kadri Timurtaş, Milli Eğitim Basımevi, İstanbul, 1990, fq. V-VI.

7 Avni İlhan, “Bâtuniyye”, *TDV İslam Ansiklopedisi*, İstanbul 1992, c. V, fq. 190.

8 Po aty.

9 Süleyman Çelebi, *Vesilet'ün Necat*, DİB. yay., Ankara, 2008, fq. 17-18.

10 Hümevra Arslantürk, “Süleyman Çelebi Mevlidi'nin Kur'ani Kaynakları”, *Yazılışının 600. Yılında Bir Kutlu Doğum Şaheseri Uluslararası Mevlid Sempozyumu*, (editör Bilal Kemikli, Osman Çetin) Ankara 2010, fq. 358-398.

11 Soner Akdağ, “Süleyman Çelebi'nin Mevlid'i Üzerine”, *A.Ü. Türkiyat Araştırmaları Enstitüsü Dergisi Sayı 36*, Erzurum, 2008, fq. 87-88.

12 Muhammed Tayyib Okıç, “Çeşitli Dillerde Mevlidler ve Süleyman Çelebi Mevlidinin Tercemeleri”, *Atatürk Üniversitesi İslami İlimler Fakültesi Dergisi*, 1975, Sayı: 1, fq. 27-38.

13 Po aty.

Islami si faktor kryesor në mbijetesën e kombit (2)

“Kur po i falënderoja myslimanët, duke shtuar se më vinte shumë keq që nuk më gjendej asgjë për t’iu përgjigjur në të njëjtën mënyrë mirësjelljes së tyre, ata m’u përgjigjën me fjalët e mëposhtme shumë të gjetura, të cilat i dëgjova me dhimbje dhe do t’i ruaj gjatë në kujtesën time sepse më therën në zemër: Mos e vrit mendjen zotëri - ma kthyen me fytyrat e qeshura në gjuhën shqipe - është zakon të thuhet: bëj të mirën e harroje; shko me Zotin dhe ku i dihet nëse një ditë nuk të kthehet njëqindfish, qoftë edhe pas një viti!”

Xhafer SADIKU

VLERAT E ISLAMIT DHE NDIKIMI I TYRE NË SHOQËRINË SHQIPTARE

Gjatë periudhës së rivalitetit të kishave të Perëndimit dhe Lindjes, dhe kërcënimit të zhdukjes së shqiptarëve nga presioni sllav, grek dhe latin, shqiptarët gjetën mbrojtje tek Islami, për shkak të vlerave të tij. Inkuizicioni mesjetar veptoi edhe në Shqipëri që nga viti 1236, por nuk pati sukses, për faktin se kishte dy kisha dhe po përhapej Islami. Nëse priftërinj apo besimtarë katolikë do të goditeshin nga inkuizicioni, ata kalonin me lehtësi në kishën ortodokse ose në Islam, duke dalë jashtë juridiksionit të Papatit. Me ardhjen e osmanëve në territoret shqiptare, u zhdukën edhe inkuizitorët dominikanë nga Shqipëria.

Për vlerat e Islamit në Shqipëri kanë shkruar autorë të shumtë të huaj, që punonin në territoret shqiptare gjatë periudhës së Perandorisë Osmane. Në librin “Vilajeti i Shkodrës”, i botuar më 1899, ish-drejtori i shkollave laike italiane në Vilajetin e Shkodrës, Gaetano Giordani dhe i biri, Vittorio, mësues në ato shkolla, shkruanin midis të tjerash se myslimanët janë krenarë për lirinë, janë humanë, bamirës e po ashtu mirënjohës për shërbimet e kryera për ta. Mikpritja tek ata është nder i madh. Nga momenti që ka kapërcyer pragun e shtëpisë së tyre, mysafiri është i shenjtë...¹

Giuzep Schiroi, arqipeshkv i Durrësit, më 20 shkurt 1737, kur do të largohej në një vend tjetër, i shkruante atit të Përgjithshëm të Bazilianëve, për disa dhurata që kishte marrë nga disa myslimanë: “Kur po i falënderoja myslimanët, duke shtuar se më vinte shumë keq që nuk më gjendej asgjë për t’iu

përgjigjur në të njëjtën mënyrë mirësjelljes së tyre, ata m’u përgjigjën me fjalët e mëposhtme shumë të gjetura, të cilat i dëgjova me dhimbje dhe do t’i ruaj gjatë në kujtesën time sepse më therën në zemër: Mos e vrit mendjen zotëri - ma kthyen me fytyrat e qeshura në gjuhën shqipe - është zakon të thuhet: bëj të mirën e harroje; shko me Zotin dhe ku i dihet nëse një ditë nuk të kthehet njëqindfish, qoftë edhe pas një viti! Mbeta një herë duke u menduar prej fjalëve të tyre e pastaj iu përgjigja, duke shpresuar me gjithë zemër: Ashtu e bëftë Zoti, bijtë e mi! - dhe u ndava prej tyre”.



Marrëdhëniet e ngushta shoqërore ndërmjet myslimanëve dhe të krishterëve shqiptarë u ka munguar çdo ngjyrë ndasie e përçarje. Duke qenë shumicë e popullsisë e besimit islam, e duke mbrojtur pakicën e krishterë, Islami mbronte në këtë mënyrë, vetë kombin shqiptar. Konsulli i Rusisë në Manastir, në një raport drejtuar eprorëve të tij, më 6 gusht 1864, vinte në dukje: “Asnjë lloj fanatizmi fetar në drejtim të fesë myslimane nuk shfaqet tek ata. Sipas konsullit, deri në Reformat e Tanzimatit (1839), “Manastiri i Shën Naumit, jo vetëm mbrohej nga aristokracia myslimane e vendit nga çdo lloj violence, por edhe e ndihmonin me dhurata të mëdha.”²

Myslimanët i respektonin jo vetëm objektet e kishave dhe manastireve, por edhe ritet e tyre. Në një deklaratë të at Bonaventura Nikaj - famullitar i Laçit-Sebaste (të Kurbinit), theksohej: “Unë jam edhe administratori i Shenjtores së Shën Antonit të Kurbinit, Shenjtorja më e dëgjuar e Arbërisë së mesme dhe e vetmja kishë e shuguruar e Kryepeshkopatës (shuguruar më 1557 nga kryepeshkopi Bruno nga Tivari). Atje dynden më shumë muhamedanët sesa të krishterët. Ditën e Shën Antonit, më 13 qershor, famullitari i Laçit, sipas zakonit të vjetër, duhet të dërgojë njoftimin e festës në qytetin plotësisht muhamedan të Krujës, ku nëpërmjet një lajmëtari shpallet festa e Shën Antonit, dhe me këtë rast vjen një turmë e madhe muhamedanësh, që merr pjesë në shërbimin hyjnor.”³ Sjellje të tilla ishin të natyrshme e të përhershme.

ISLAMI, MBROJTËS I KOMBIT NGA ASIMILIMI

Besimin islam, që e kishte bërë të vetin shumica e popullsisë shqiptare, luajti rol vendimtar në ruajtjen e shqiptarëve nga asimilimi i kombeve fqinjë, që i përkisnin besimit ortodoks. Islamizmi i rezistoi sllavizmit, duke ia dedikuar fitoren e tij vetëm nga fakti që qeveria osmane kishte për bazë parimet e Kuranit.⁴

Dallimi fetar me fqinjët ruajti gjuhën shqipe, elementin thelbësor të identitetit kombëtar. Në gadishullin ballkanik, religjioni islam paraqitej esencialisht unitar nga pikëpamja politiko-religjioze.

Religjioni islam, nëpërmjet një procesi historik pak a shumë të gjatë, rrjedhojë e kohës dhe hapësirës, rriti midis individëve zhvillimin e ideve, hodhi baza të thella për krijimin e një elite të këtij komuniteti, elitë e mendimit kombëtar. Nëpërmjet veprës së religjionit islam e të përbërjes shoqërore krijuar prej tij, veptoi fuqishëm nacionalizmi. Emra të njohur të besimit islam që i dhanë formë dhe frymë Rilindjes Kombëtare janë dëshmia më e mirë.

Krahas mendimit politik të Rilindjes, ideja e krenarisë kombëtare si popull, që përbente një tjetër bazë të shpirtit shqiptar, ishte produkt i mirëfilltë i mendimit religjioz, nocioni i të cilit ishte shumë i përhapur nga xhamitë midis myslimanëve. Autorë studimesh për çështjet e kombit dhe religjionit janë të shumtë dhe nga kombe të ndryshëm. Islami, sipas Giovanni Amadori Virgilj, i jepte besimit të tij një superioritet domethënës. Nga fusha religjioze, kjo ndjenjë superioriteti zhvillohej në raportet politiko-sociale e në shumë forma në Rumelinë Perëndimore. Nga pikëpamja politiko-religjioze, religjioni islam është një mjet i fuqishëm harmonie dhe bashkimi për besimtarët. “Islamizmi, sipas Virgilj, nga pikëpamja e autoritetit shpirtëror prezanton një shkallë të lartë uniteti.”⁵

Sotir Kolea, njohës i çështjeve shqiptare, e në mënyrë të veçantë i gjuhës dhe religjionit, në një përmbledhje për historinë e Shqipërisë së Poshtme, midis të tjerash, shkruante për helenizimin e popujve të tjerë rreth Greqisë. Ai vinte në dukje se vetëm nga fundi i shekullit XVIII filluan të duken frutat e saj në gji të Ambraqisë (Vonicë, Artë etj)”. Preveza me rrethinë e saj qëndroi deri vonë, - theksonte Kolea, - “sepse myslimanët qenë të shumtë, në mos qenë shumica drejt për së drejti.” Helenizimi i shqiptarëve u intensifikua nën sundimin e Ali Pashë Tepelenës. Gjatë këtij procesi, - shkruante Kolea, - greqizmi i vendit bëri përparime dhe



shumica e të krishterëve humbën gjuhën, sidomos ndër viset ku myslimanët ishin pakicë. Vetëm në viset ku një pjesë e madhe e popullit kishin pranuar fenë e Muhamedit, “mbeti gjuha shqipe siç kishte qenë gjatë shekujve”. Pas largimit të osmanëve nga vilajeti i Janinës, në mars 1913, numri i shqiptarëve myslimanë erdhi duke u zvogëluar, derisa në 1945, në Çamëri do të vriteshin një numër i madh shqiptarësh myslimanë dhe pjesa tjetër do të dëbohej për në Shqipëri. Sotir Kolea, parashikonte ditë më të këqija për shqiptarët dhe se gjuha shqipe për pak kohë nuk do të dëgjohej më në ato vise.⁶ Prof. Ahmet Gashi shkruante se greqizimi i Shqipërisë së Poshtme ishte arritur, në një farë mase, duke i greqizuar ortodoksët shqiptarë gjatë shekullit XIX dhe duke zhdukur elementin shqiptar mysliman.⁷

E DREJTA NË ISLAM DHE NDIKIMI I SAJ

Islami do të sillte risi edhe në fushën e së drejtës, e cila do të ndikonte në përhapjen e tij. Deri në shekullin e dytë hixhri, Kurani ishte i vetmi ligj i shkruar që kishin myslimanët. Në këtë epokë, shkrimtarët, filozofët dhe teologët e islamizmit arritën pak nga pak formimin e një pjesë të rëndësishme të legjislacionit religjioz.

Pafundësia e shkrimeve të imamëve, apo filozofëve të shekujve të parë të islamizmit, do të formonin shumë herë burime të përbashkëta të së drejtës. Tek ato burime, magjistratët e juristët mbështesnin bazat e vendimeve të tyre dhe parimet në lidhje me teologjinë e jurisprudencën.⁸

E drejta myslimane kishte karakter religjioz dhe mbi atë ishte ndërtuar tërë sistemi politik, administrativ e juridik i Perandorisë Osmane. Burimi më i lartë dhe i paprekshëm i së drejtës ishte Kurani, rreth të cilit janë mbledhur në shekuj një numër i madh i parimeve legjislative, por që prezantohen të gjitha në një formë modeste e në një interpretim të thjeshtë.

Ato kishin edhe karakter të një të drejte të shenjtë, e ky ishte Sheriati, që përbënte pjesën më të rëndësishme të legjislacionit osman. Në legjislacionin juridik të Perandorisë, Sheriati nuk mund të interpretohej e të aplikohej veçse nga juristët e

religjionit (kadiu), i cili ka qenë kreu suprem pas sulltanit, sheikul-islam. Ishte domethënës fakti që sheikul-islami, deri nga gjysma e dytë e shekullit XX, kryente funksionet e ministrit të Drejtësisë.⁹

Sipas të drejtës islame, gjendja natyrale e njeriut ishte konsideruar liri, ndërsa gruaja, në raport me situatën e saj në shoqërinë pagane dhe para islame, bënte me Islamin progres të madh.¹⁰

Nuk pranohej në asnjë rrethanë që një mysliman të kalonte nga gjendja e lirisë në atë të skllavit. Skllavi, sipas ligjit islamik, kishte shumë më tepër të drejta se ato të skllavëve që ekzistonin deri në shekullin XIX në vendet krishtere. Ai gëzonte liri të plotë besimi, mund të martohej ligjërisht. Lejohej martesë midis njeriut të lirë e skllavit, të skllaves me padronin e saj, i cili, nëse ishte i martuar, mund të bashkëjetonte me të. Skllavërit që nuk ishin të padronëve të tyre, mund të fitonin trashëgiminë ose ta refuzonin edhe kundër vullnetit të padronit. Këta ishin të detyruar t'i trajtonin me humanizëm, t'i furnizonin me ushqimet e nevojshme e t'i kuronin kur ishin të sëmurë e pleq. Në rast të kundërt, padroni mund të ndëshkohej nga gjykata e skllavi lirohej. Lirimi i skllavit konsiderohej nga Kurani dhe nga tradita një nga veprat më të mira të mundshme. Me aktin e emancipimit, që veprohej me procedurë të parashikuar në ligj, krijohesh një trajtim i barabartë me efekte juridike të njëjta. Skllavërit dhe gratë e kuptuan se kjo fe u jepte atyre një mesazh shprese.¹¹

Duke përfutur nga vlerat e Islamit edhe në fushën e së drejtës, njerëzit e paprivilegjuar kontribuan në vetvete në afrimin shpirtëror midis tyre. Kjo ishte e dukshme edhe te shqiptarët që i përkisnin edhe etnisë së njëjtë.

UNITETI PËRBALLË RREZIKUT KOMBËTAR DHE MBROJTJA E TERRITOREVE

Traktati i Berlinit gjeti rezistencë të madhe te shqiptarët e të tre besimeve, por meqë objekti i këtij punimi janë myslimanët, po fokusohemi mbi ta. Duke qenë shumica e



popullit shqiptar e besimit islam, diplomacia e vendeve kryesore të Perëndimit, përdori përçarjen e tyre, për të inkurajuar një lloj shkëputje ose në pamundësi, një lloj përçarje e copëtimi të Islamit në Shqipëri. Mbrojtja që Islami i bënte kombit shqiptar, ishte pengesë për të huajt në realizimin e projekteve të tyre. Sipas Roberto Maroco Della Roca, këtë plan u përpoqën ta realizonin me çdo çmim nëpërmjet bektashizmit. Ai theksonte se qëllimi i tyre ishte të thyenin kompaktësinë myslimane, duke e prezantuar si “fe” më tolerante në krahasim me Islamin.¹²

Sipas Nathalie Clayer, konsujt Johan Georg Hahn, konsulli francez Degrand dhe konsulli Ippen, ishin ndër të parët në mitizimin e bektashizmit. Perëndimorët, - theksonte ajo, - dhanë kontributin e tyre për të krijuar këtë imazh të dallimit që ekzistonte midis sunizmit/bektashizmit, të cilit i korrespondonin një sërë kundërshtish: fanatik/liberal, turk/shqiptar, aziatik/evropian, Vënia e bektashizmit përballë sunizmit si dallim kulturor dhe politik, në të vërtetë, nuk i përgjigjej realitetit në mjediset shqiptare. Sami Frashëri, qysh në vitet '80-ta, vinte në dukje ekzistencën në mesin e shqiptarëve, të myslimanëve bektashi, jo përballë, siç dëshironin konsujt, por në krah të myslimanëve sunitë.¹³

Lidhja e Prizrenit ishte, padyshim, dëshmia më e mirë që hidhte poshtë propagandën e të huajve dhe vërtetonte pohimin e Sami Frashërit. Suni dhe bektashi, bashkë me elitën shqiptare të besimit ortodoks dhe katolik, u përpoqën për mbrojtjen e vendit. Në mbledhjen që u zhvillua në Dibër, Asambleja e Përgjithshme dërgoi në Stamboll një memorandum ku kërkonin bashkimin e Shqipërisë në një provincë të vetme me Ohrin ose Manastirin për kryeqytet e me funksionarë shqiptarë. Memorandumi u firmos nga krerët më të shquar shqiptaromyslimanë, si Xhemal Bej, Abdyl Bej Frashëri, Mustafa Aga, Dervish Mustafa Efendi, Sheh Ismail Efendi, e Myderiz Abdullah Efendi. Politikën e përçarjes së shqiptarëve e denoncoi prifti katolik, prof. D. Gasper Jakova-Mërturi, i akuzoi të huajt “se në Shqipëri ... zbatonin aksiomën e njohur politike përça e sundo”.¹⁴

Konsulli Lippich i raportonte Vjenës se Sheh Mustafa i Tetovës, në korrik 1878, shkoi në Stamboll, i ngarkuar me një mision të veçantë prej Lidhjes, ku kishte takuar ministrin e Jashtëm dhe sulltanin. Me kthimin në Shqipëri kishte biseduar me valiun, Nazif Pashën, në Prishtinë e me krerët e Lidhjes, ndërsa në Gjakovë e Pejë me kadiun Ahmet Koronicën, e me tjerë “fanatikë”. Ky, - theksonte konsulli, - duket se ka për të marrë në dorë drejtimin e Lidhjes për ta riorganizuar. Sot u ka dërguar një telegram nga Prishtina të gjithë përfaqësuesve të degëve të Lidhjes dhe këtyre të Shkodrës që të mblidhen sa ma parë në Prizren.¹⁵ Për takimin e Sheh Mustafa Tetovës me sulltanin raportonte edhe konsulli i Austro-Hungarisë në Prizren, Jelinek.¹⁶

Kur Komisioni për caktimin e kufijve në Shqipërinë e Poshtme shkoi në Janinë, u mblodhën disa hoxhallarë nën

kryesinë e Qamil Efendiut dhe bashkë me Abdyl Frashërin, Mustafa Beun dhe Ahmet Pashën shkruan një lutje drejtuar Myftar Pashës. Midis të tjerave, ata e informonin se nuk i bindeshin aneksimit të tyre te Greqia. Në rast të tillë, - theksonin ata, “do të deklarojmë mëvetësinë tonë nën Portën e Lartë dhe do të luftojmë vetë kundra Greqisë, si një trup i vetëm. Ne dhe gjithë Shqipëria jemi të gatshëm të luftojmë gjer në pikën e fundit.”¹⁷

Më 13 korrik 1878, konsulli austriak në Janinë njoftonte kontin Andrashi se myslimanët ishin brengosur për faktin se traktati i dalë nga Kongresi i Berlinit kishte marrë vendimin për bashkimin e këtij Vilajeti me Greqinë.¹⁸ Por marshalli çerkez, Abdi Pasha, i tha konsullit se ai dhe të gjithë shqiptarët, më parë kishin për të pranuar të shkriheshin në luftë, të derdhnin gjakun dhe të humbnin pasurinë, se sa t'i nënshtroheshin një vendimi të tillë të Kongresit.

Përballë presionit të Qeverisë greke për të zbatuar traktatin e Berlinit në Shqipërinë e Poshtme, Abdyl Frashëri dhe Mehmet Ali Vrioni, kërkuan ndihmën e sulltanit. Më 23 qershor 1879, ata i dërguan një peticion në të cilin, midis të tjerash shkruanin: “Nëse bëhet copëtimi i Arnautllëkut, sipas kërkesave e aspiratave të parashtruara, atëherë pjesa më e madhe e popullsisë shqiptare, që i takon konfesisë islame, do t'i ekspozohet terrorit dhe zhdukjes totale.”¹⁹

1 Gaetano Giordani e sua filio Vittorio, *Il Vilajet di Scutari*, Roma 1899, f. 57-58.

2 AQSH, fondi 143, dosja 1216, f. 15. *Raport nr. 217, datë 6 gusht 1864 i konsullit të Rusisë në Rumeli e Shqipërinë e Mesme*, A. Rostovski.

3 Gjergj Gashi, *Vatvani dhe Arbëria, 1700-1922*, botim “Onufri” Tiranë 1998, f. 434. Raport i vizitës Apostolike bërë në vitin e zotit 1920 nga noteri apostolik Ernesto Cozzi në Peshkopatat e Arbërisë dhe Malit të Zi (f. 3), Dok. Nr. 67 (487), Vizita Apostolike, Shkodër, 21 shtator 1920, Kushtet fetare të Kryepeshkopatës së Durrësit sipas mendimit të Klerit Vendas.

4 Pietro Chiara, *L'Epiro, Gli Albanesi e La Liga*, Palermo 1880, f. 62.

5 Giovanni Amedori Virgilj, vepër e cituar, f. 32.

6 AQSH, fondi 6, dosja 66/1, f. 168- 169; *Letër e Sotir Kolesë, datë 17 gusht 1940, dërguar Dr. Terenc Tocit*.

7 AQSH, fondi Koleksioni i hartave, dosja 3, f. 20, Profesor Ahmet Gashi, Shqipëria Etnike.

8 Giuseppe Calza, *Saggio sulla religione de Maomettani*, Venezia 1793, f. 8-10.

9 Turchia, *Lo straniero ed il regime delle sucessioni in diritto musulmano*, f. 36-37.

10 *Grande Dizionario Enciclopedico UTET*, v. 10. F. 498.

11 Karen Armstrong, *Muhamedi një biografi e Profetit*, Tiranë 2006, f. 118.

12 Roberto Maroco Della Roca, *Kombësia dhe feja në Shqipëri 1920-1944*, Tiranë 1994, f.201-202.

13 Nathalie Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar*, Tiranë 2009, f. 429-430.

14 Prof. D. Gasper Jakova-Mërturi; *La Questione d'Oriente e l'Albania*, Froscati, 1905, f. 53-57.

15 AQSH, fondi 143, viti 1880, dosja 1056, f. 46-47.

16 *Leka*, viti 1938, nr. 10-12, f. 566-567, f. 559-560; Nr. 26 Pol, Prilzrend, 15-X-1878; Pr. 7-11-878; raport i konsullit të Austro-Hungarisë në Prizren Jelinek dërguar kontit Andrashi, ministër i Jashtëm i Austro-Hungarisë.

17 *Leka*, viti 1938, nr. 10-12, f. 530.

18 *Leka*, 1939, nr. 7-12, f. 164, *Njoftim Nr. 38 - Janinë, 13. 7.1878, i konsullit të Austro-Hungarisë në Janinë, dërguar ministrit të Jashtëm të Austro-Hungarisë në Vjenë, Kontit Andrashi*.

19 Zekeria Cana, *Gjenocidi i Malit të Zi mbi popullin shqiptar 1912 - 1913*, botim i Institutit Albanologjik të Prishtinës, Prishtinë, 1996, f. 59.

Çfarë na rrëfen një vakëfname

Burimet arkivore janë lënda e parë e historianit, i cili përmes regjistrimeve të tilla që gjenden në fondet e ruajtura prej arkivave të ndryshme, arrin të ndërtojë një panoramë të shoqërisë, ekonomisë, politikës, kulturës, fesë dhe elementëve të ndryshme për periudhën që po studion.

Dr. Eduart CAKA

Ndonjëherë mjafton vetëm një dokument i vetëm për t'i mbledhur së bashku të gjitha këto fusha të ndryshme. Për ta ilustruar këtë aspekt po analizojmë një vakëfname të përpiluar në qytetin e Beratit në fillim të shek. XVIII.

E përmendur në burime dhe literaturë si vakëfname (vakufname) ose vakfije, termat në fjalë i referohen një dokumenti zyrtar e me karakter juridik që përpilohej prej kadiut në rastin kur themelohej një vakëf. Teksti në fjalë hartohej me kërkesë të personit që po ngrinte një institucion bamirësie, aprovohej përmes dëshmisë që jepnin individët e pranishëm gjatë ndërmarrjes së kësaj nisme, dhe siglohej prej kadiut, i cili e shënonte ngjarjen edhe në regjistrat zyrtare duke e bërë të ligjshëm themelimin e institucionit të bamirësisë në fjalë. Ndonëse vakëfi ishte një nismë private, statusi ligjor i tij njihej prej shtetit dhe ishte i paprekshëm për sa kohë që ky institucion vepronte konform kushteve të përcaktuara prej vakëflënësit në dokumentin themelues, pra në vakfije.

Me qëllimin për të ilustruar se çfarë ishte një vakfije, por edhe të dhënat që i përcjell studiuesit si dokument arkivor, këtu do të paraqesim vakëfnamenë e zonjës Aishe nga qyteti i Beratit, e cila, në vitin 1669 linte vakëf shumën e 100 000 akçeve për shpenzimet e medresesë dhe daru'l-kurrasë që ajo kishte ndërtuar së bashku me të shoqin, Sali Beun. Dhënia e plotë e tekstit këtu, do të ishte jashtë përmasave të këtij shkrimi, prandaj po paraqesim shkurtimisht të dhënat bazike që paraqet dokumenti. Kështu, Aisheja figuron si e bija e Mahmud Pashës dhe ishte martuar me Sali Beun, edhe ky djalë i Hasan Pashës. Të dy bashkëshortët kishin ndërtuar



Vetë fakti se objektet e kultit, institucionet arsimore por edhe urat, hanet, çezmat e rrugët kryesisht përmenden me emrat e njerëzve ose të grupeve që i kanë ndërtuar, e dëshmon qartë faktin se ato u ndërtuan prej këtyre institucioneve të bamirësisë.

një medrese me nëntë dhoma dhe një klasë mësimi si dhe një shkollë të mësimi të Kuranit (Daru'l-kurra) në afërsi të xhamisë së Hysen Pashës në qytetin e Beratit. Në vakëfnamenë e përgatitur pranë kadiut të Beratit, përfaqësuesi i zonjës Aishe deklaronte përpara dëshmitarëve se bamirësja në fjalë dhuronte shumën e mësipërme si vakëf monetar, një pjesë e së cilës do përpunohej për të sjellë të ardhura për vakëfin në fjalë, ndërsa pjesa tjetër do të përdorej për pagesat dhe nevojat e objektit arsimor që ajo kishte ngritur me të shoqin.

Duke hapur një parantezë, duhet të theksohet fakti se bashkëshortët në fjalë kanë përpiluar edhe dy vakfije të tjera (njëra sërish prej zonjës Aishe në shumën e 75 000 akçeve, ndërsa tjetra prej Sali Beut në vlerën e 80 000 akçeve) për të njëjtin institucion arsimor, por ne do të ndalemi vetëm në vakfijen e parë.

Pa u futur në detajet më teknike të dokumentit, këtu është me vlerë të përmenden informacionet që ai përmban për studiuesin, aspekte të cilat po i përmbledhim shkurtimisht më poshtë:

Së pari, vakëfnameja e mësipërme na tregon se cilat ishin kategoritë shoqërore që ngrinin edhe vakëfet e mëdha, të cilat përballonin nevojat kryesore të shoqërisë por edhe transformonin mjedisin urban. Nga studimet e kryera në lidhje me këtë temë, vërehet se ishin familjet e pashallarëve, të tregtarëve, të ushtarakëve e dijetarëve ata që ngrinin vakëfe. Domethënë shtresat drejtuese dhe paria e qyteteve. Edhe në rastin e mësipërm, si Aisheja ashtu edhe i shoqi, Saliu, mësojmë se janë fëmijë pashallarësh, pra pjesë e elitës së qytetit. Në rastin konkret, duket se martesat midis familjeve të mëdha kanë siguruar edhe mbrojtjen e pozitave të tyre politike e ekonomike.

Elementi i dytë që nxjerr në pah dokumenti ka të bëjë me fushëveprimin e vakëfeve. Kështu, objektet e rëndësishme që formësonin peizazhin urbanistik të qyteteve dhe fshatrave ndërtoheshin prej këtyre institucioneve të bamirësisë. Vetë fakti se objektet e kultit, institucionet arsimore por edhe urat,

hanet, çezmat e rrugët kryesisht përmenden me emrat e njerëzve ose të grupeve që i kanë ndërtuar, e dëshmon qartë faktin se ato u ndërtuan prej këtyre institucioneve të bamirësisë. Parë nga ky këndvështrim, vakëfet na dalin përpara si faktorët kryesorë të zhvillimit urban gjatë periudhës së sundimit osman. Kështu, në rastin e bashkëshortëve, duket se kontributi i tyre i bamirësisë ka konsistuar në sistemin arsimor, ku medresetë ishin institucionet më të larta arsimore të kohës dhe kishin programe të gjera studimi që varionin nga fushat e teologjisë në ato të shkencës, logjikës dhe elokuencës.

Së treti, dokumenti i mësipërm na tregon potencialin ekonomik që kishte shoqëria e kohës në përgjithësi dhe familjet e pasura në veçanti. Kështu, një familje e rangut të lartë siç ishin dy bashkëshortët e mësipërm, kishin potencial ekonomik sa për të lënë vakëf një shumë të konsiderueshme që arrinte në vlerën e 250 000 akçeve. Ekzistenca e familjeve të tilla të pasura gjallëronte edhe jetën ekonomike të zonave urbane ku ata jetonin. Në rastin konkret, Berati ishte njëra prej qendrave më të rëndësishme ekonomike e kulturore shqiptare gjatë shek. XVII-XVIII.

Përveç elementëve politikë, ekonomikë dhe urbanistikë që na rrëfen dokumenti, në vakëfname na tërheqin vëmendjen edhe disa aspekte të karakterit shoqëror, kulturor e juridik. Ndonëse në periudhën në fjalë jeta e gruas ishte tejet e limituar në kontekstin shoqëror, gjë e cila del në pah edhe prej faktit se bamirësja Aishe nuk paraqitej vetë në gjykatë, por përfaqësohej prej një të afërmi të saj, nga ana tjetër është shumë domethënë fakti se brenda jetës bashkëshortore ajo kishte të drejtën e administrimit të pasurisë që kishte. Kjo vërtetohet prej faktit se dhurimet që kanë bërë bashkëshortët, nuk janë të përbashkëta, por secili ka dhuruar në emër të tij. Ky element është tejet i rëndësishëm dhe na bën të kuptojmë se gratë e kohës gëzonin njëfarë autonomie ekonomike ku mund ta administronin dhe përdornin sipas dëshirës pasurinë që kishin fituar ose trashëguar.

Rasti i mësipërm e ilustron më së miri se si jeta politike, ekonomike, kulturore, urbanistike e shoqërore e një qyteti, gjendet e pasqyruar në një dokument të vetëm. Ky aspekt e vërteton qartësisht rëndësinë që kanë burimet arkivore në zbulimin e të shkuarës historike të vendit tonë, por edhe nevojën e madhe që këto burime të shfletohen sa më shpejt prej studiuesve të periudhës.

Literatura:

1. Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH), Fondi 128 (Koleksion i sherieve të vilajetit të Janinës), Dosja 10.
2. Osmanlı Dönemi Rumeli Para Vakıfları, C. IV, Ed. Mehmet Bulut, Istanbul: Erkam Yay., 2019, f. 30-35.
3. Eduart Caka, Vakëfet dhe ndikimi i tyre social në Shqipërinë e periudhës osmane, Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, 2021, f. 442-445.

Sixhilatet e kadiut osman si burim i dorës së parë për historishkrimin e qyteteve shqiptare


(Shembulli i Manastirit)

Prof. ass. dr. Agron ISLAMI

HYRJJE

Kushtetuta me të cilën udhëhiqej Perandoria Osmane, për bazë kishte dy komponentë kryesorë: legjislacionin (Sheriatin) islam dhe traditën e popullit, ndërsa administrata e Perandorisë Osmane ishte e ndërtuar nën sloganin e “Drejtësisë”¹ dhe përgjegjësia kryesore respektivisht, mbikëqyrësi i drejtësisë ishte vetë padishahu, i cili përfaqësonte autoritetin e të drejtit. Ndarja e kësaj drejtësie bëhej përmes institucionit të gjykatës, e që përfaqësoheshin nga eminentët që në literaturë njihen si kadinjë.

Kadiu, i cili përzgjidhej për ta ndarë drejtësinë në qytetin e Perandorisë dekretohej me Berat nga ana e padishahut osman.² Kadiu osman drejtonte të gjitha çështjet e juridiksionit islam në kaza, që nënkupton se mbikëqyrte dhe merrte vendime për të gjitha mosmarrëveshjet e mundshme ndërmjet qytetarëve, sikur bie fjala: ai mbikëqyrte kontratat e shitblerjes, me kërkesën e qytetarëve bënte kurorëzime dhe shkukurëzime, ruante pasurinë e fëmijëve që mbeteshin pa prindër në moshë të re dhe kur ata arrinin moshën e pjekurisë (bulûg), ua ndante pasurinë në pjesë të barabarta, përkujdesej për çmimet e artikujve në tregje, si dhe kumtonte të gjitha urdhrat dhe kërkesat që vinin nga qendra e Perandorisë drejtuar popullatës së qytetit ku ai ishte nëpunës, që nënkupton se ai kishte autoritetin e kryetarit të komunës së sotme.³



Faksimil nga sixhili i Manastirit

Te gjitha lëndët e përpunuara nga kadiu osman ruheshin në deftere të veçanta të cilat njihen si *Şer'iyye Sicilleri*, e që edhe në literaturën e historisë shqiptare njihen si *sixhile* apo *sixhilate*, ndërsa gjuha në të cilën janë të shkruara *sixhilet* është osmanishtja, me llojin e shkrimit *Talik* i thyer, *Divani* dhe *Siyakat*,⁴ shkrime të cilat gjatë leximit sjellin shumë telashe.⁵

Sixhilet e kadiut veq rëndësisë juridike të kohës që kanë, ato në vete përmbajnë edhe informacion të dorës së parë për sa i përket administratës osmane të kohës, jetës sociale, ekonomike dhe kulturore dhe si të tilla janë burimi i parë për historinë e qytetit të kohës osmane. Këto dokumente të hartuara nga ana e kadiut, karakterizohen me të dhëna të detajuara për lagjet, shkëmbimin e shkresave/urdhësive mes qytetit dhe qendrës së Perandorisë, kërkesat dhe ankesat e ndryshme të banorëve vendas. Me një fjalë, përmes këtyre shkresave mund të krijojmë një pikëpamje të saktë të jetës së një qytetari osman në atë kohë. Në anën tjetër, në këto regjistra të kadilerëve gjejmë edhe të dhëna të detajuara të sistemit komunal, tatimorë (vergi), prodhimtarisë bujqësore, sëmudnjt e kohës dhe jetën e familjes shqiptare në përgjithësi,⁶ pa përjashtuar edhe dekretet e lëshuara nga qendra e Perandorisë osmane drejtuar qytetarëve të zonës në fjalë, sikur janë *Fermanet*, *Beratet*, etj.

Vendimet e kadiut lëshoheshin sipas kërkesës së qytetarit, andaj edhe në terminologjinë e juridiksionit osman janë të njohura me terme të veçanta. Në kuadër të këtyre vendimeve më së shumti hasen vendimet që njihen si *Hyxhjet* (*Hüccet*), të cilat për nga struktura janë vendime të lëshuara nga ana e kadiut osman dhe kryesisht kanë një tekst të shkurtër, ku është përshkruar kërkesa e palëve dhe në fund janë emrat e dëshmitarëve prezent gjatë aktit të regjistrimit të ngjarjes në fjalë.⁷ Zakonisht tematika e këtyre vendimeve prej hyxheti ka lidhje me shitblerjet, kurorëzimet, shkuroëzimet, mehrin (dhurata martesore), donacionet, marrëveshje bashkëpunimi, marrëveshje paqeje etj.. Si lëndë tjetër, e të cilat nuk janë të pakta janë *Ilamet* (*Plamlar*), në të cilat gjejmë të ruajtur lëndën e akuzuesit, gjegjësisht ankuesit, më pas shohim se është dëgjuar pala e akuzuar karshi akuzës dhe krejt në fund kemi vendimin e gjykatësit, i cili

shoqërohet me emrat e dëshmitarëve apo shahidëve.⁸ Ndërsa në numër më të vogël gjejmë edhe *Myraselet* (*Müraseleler*), të cilat janë dokumente zyrtare që i drejtoheshin punonjësve të cilët ishin nën urdhrat e kadiut.⁹ Po ashtu *Fermanet*, të cilat ishin dekrete që lëshoheshin nga ana e padishahut për qëllime të caktuara; sikur marrja e kompetencave të ndonjë punonjësi apo ndërrimin e vendit të shërbimit, si dhe në raste kur merrej ndonjë vendim që kishte përmasa lokale të qytetit dhe qytetarëve.¹⁰ Ndërsa *Bujuruldut* (*Buyuruldu*), janë vendime dhe urdhëresa të lëshuara nga ana e kryeministrit (sadriazamit) drejtuar ministrit (vezirit), Bejlerbejit, komandantit detarë (Kaptan-i Derya), kadiut apo ushtarëve.¹¹ *Temessuket* (*Temessiik*), janë dokumente të cilat më vonë u emërtuan si tapi të cilat dëshmonin pronësinë e pasurive.¹²

Ajo që ia shton edhe më shumë vlerën hulumtimit të sixhileve të kadiut, pa dyshim që janë edhe emrat e njerëzve, qyteteve, fshatrave, lagjeve, fiseve dhe xhemateve, të cilat kanë një vlerë të veçantë për historinë e gjuhës shqipe, dhe njëkohësisht japin mundësi të nxirren përfundime me shumë interes mbi anën etnike, veçanërisht mbi gjendjen e elementit shqiptar në këto qytete gjatë periudhës së sundimit osman.

GJYKATA E MANASTIRIT DHE SIXHILATET

Më 1385, atëherë kur edhe themelohet Bejlerbejliku apo Ejaleti i Rumelisë i cili më vonë do të njihet me emrin Vilajet, hapësira e Maqedonisë Veriore të sotme bëhet pjesë e kësaj administrate të zgjeruar dhe sipas kësaj Manastiri ishte pjesë administrative e Pasha Sangjakut deri në shek. XIX.¹³ Sipas të dhënave që na ofron seyahatnameja e Evlija Çelebiut, në gjysmën e dytë të shek. XIX, Gjykata e Manastirit kishte në administrim Sanxhakun e Kërçovës, Elbasanit, Gostivarit, Dibrës, Resnes, Florinës, Prilepit, Ohrit dhe 360 fshatra.

Numri i *sixhileve* të identifikuar të qytetit të Manastirit është 185, të cilat përfshinë një interval kohor të regjistrimeve prej 306 vjetësh, respektivisht *sixhili* i parë mbanë datën 1621 dhe i fundit 1927. Mikrofilmet e *sixhileve* të Manastirit gjenden në Arkivin Shtetëror të Maqedonisë dhe në Bibliotekën Qendra për Hulumtime Islame në Stamboll (*Islam Araştırmaları Merkezi-ISAM*). Ne në këtë prezantim kemi marrë për bazë disa vendime nga defteri i sixhileve

Vendimet e kadiut, lëshoheshin sipas kërkesës së qytetarit, andaj edhe në terminologjinë e juridiksionit osman janë të njohura me terme të veçanta.



të Manastirit me nr. 07., defter i cili është punuar si temë masteri nga ana e Nexhati Çayirli ne Universitetin Ege në İzmir të Turqisë në vitin.¹⁴ Ky defter i takon vitit 1031-1032 hixhri dhe 1621-1623 sipas kalendarit miladi. Ka 1182 lëndë të ndryshme, të cilat janë trajtuar në gjykatën e Manastirit dhe për tematikë kanë problemet ditore të qytetarëve të Manastirit dhe fshatrave përreth.

Për sa i përket larmisë së tematikave të lëndëve, apo vendimeve që janë marrë nga kadiu i Manastirit gjatë kësaj kohe, shohim se ato janë të natyrave ekonomike, fondacioneve/vakëfet, problemeve familjare, ushtrisë, rrahje, plagosje, veprave penale-krime, pa u anashkaluar edhe lëndët e shumta të trashëgimisë. Nga 675 vendime të kadiut sa janë në këtë defter, 140 kanë të bëjnë me shitblerje, 407 huamarrje dhe borxhe, 73 me tatime shtetërore dhe 265 me çështje vakëfnore.

Siç edhe dihet, hapësira shqiptare e periudhës osmane karakterizohet me multikulturalizëm. Respektivisht duke qenë se në këto zona nënshtetasit osman i takonin besimeve të ndryshme, edhe bashkëpunimi i tyre ne jetën e përditshme ishte i patejkalueshëm. Kjo vjen edhe si rezultat i qytetërimit osman, i cili është ngritur mbi themele të juridiksionit islam, ku e drejta e jetës dhe e besimit është e garantuar me ligj. Ky bashkëpunim dhe kjo bashkëjetesë shpërfaqet mjaft mirë edhe në dekadën e dytë të shekullit XVII. P.sh. në lëndën me nr. 749: të sixhilit të Manastirit thuhet se është bërë Muhamedi ia ka kërkuar 3 akça (grosh) Salamonit nga hebrenjtë (Jahudi)

dhe Salamoni po ashtu ka premtuar se do t'ia dhuroj 3 akçet (groshët) Muhamedit. Madje, huadhënia nganjëherë tejkalonte edhe kufijtë e Manastirit, sikur bie fjala me lëndën me nr. 796, i cili flet mbi një huadhënie të një nënshtetasi osman me emrin Ridvan, i biri i Osmanit me banim Stamboll. Ky, para zyrtarit të gjykatës dëshmon se 80 000 akça (grosh) i ka dhënë pastorit, i cili më herët kishte qenë patrik i Ohrit me emrin Barkilos. Ndërsa për garantues të borxhit janë regjistruar dy pastorët, Danieli dhe Xhozefi.

Në këto regjistrime zyrtare nuk mungon as elementi gjinor, ku zonjat shfrytëzonin të drejtën e trashëgimisë dhe të drejtën e menaxhimit me pasuritë e tyre dhe të familjeve të tyre, sikur bie fjala me zonjë Aijshe, banuese në lagjen Nexhip Bej. Ajo ka shkuar te zyra e kadiut dhe ka deklaruar për shitjen e pjesës (hises) së saj, e cila ishte pjesë e çiftlikut të cilin e kishin trashëguar bashkë me vëllain, i cili para pak kohësh kishte ndërruar jetë. Në fund të kësaj lënde kemi edhe dëshminë e blerësit të çiftlikut, Hasan beut, i cili ishte edhe Sipahi. Kështu, nga kjo formë e lëndës me nr. 8383, shohim se kemi të bëjmë me një lloj noterizimi, i cili legalizon shitblerjen.

Siç u citua edhe më lartë, kadiu ishte i thirrur për të ndarë drejtësi dhe si i tillë edhe dera e tij duhej të ishte e hapur për çdo qytetarë të kazasë ku ai shërbente. Ai duhej t'i zgjidhte edhe çështjet e dhunës në familje. Një lëndë e karakterit të dhunës në familje është regjistruar pas ankesës së një zonje të besimit të krishterë me emrin Elina. Në këtë lëndë me

shumë pak detaje thuhet se, “i është tërhequr vërejtja Stojkos, që mos të ushtroj dhunë (presion) ndaj rejës së tij, Elina”. Një rast dhune është regjistruar edhe në lëndën me nr. 250. Sipas kësaj, haxhi Ahmedi ushtron ankesë ndaj gjyshit të tij, Hasanit me pretekstin se është rrahur nga ky i fundit. Për të verifikuar pretendimin në fjalë gjykata kishte dërguar një zyrtar dhe pas kësaj Hasani, i ishte nënshtruar kërkesave të zyrtarit.

Fakti që për këto dy raste të dhunës në familje gjykata nuk kishte shqiptuar ndonjë dënim, mund të vijmë në përfundim se, zyrtarët e drejtësisë i kishin dhënë përparësi zgjidhjes së problemeve nëpërmjet marrëveshjeve në mes familjarëve konfliktuoze.

Në kuadër të kompetencës së kadiut ishte edhe ruajtja e të drejtave të grave të shkurorëzuara. Një rasti i tillë shpërfaqet me rastin e zonjës Ummi, e cila në prani të dëshmitarëve kishte lidhur kurorën me Ahmed Çaushin dhe për shkaqe të panjohura (pasi që nuk është e cekur në këtë lëndë) ishte shkurorëzuar nga ky i fundit. Mirëpo ish-bashkëshorti i saj nuk ia kishte dhënë dhuratën e martesës (mehr-i muexhxhel).



Historiografia shqiptare si dhe institucionet kërkimore shkencore të hapësirës shqiptare, akoma nuk ia kanë dalur të kenë një plan për ndriqimin e jetës socio ekonomike të qyteteve dhe fshatrave shqiptare gjatë periudhës së sundimit osman.

Me këtë rast, kadiu nxjerr vendimin e prerë për pagesën e dhuratës martesore prej 600 groshësh.

KONKLUZION

Historishkrimi i jetës sociale, ekonomike dhe politike i qyteteve shqiptare gjatë periudhës së sundimit osman është i varur nga dokumentacioni zyrtar i hartuar nëpër këto qytete, dhe njëri ndër fondet më të besueshme për historishkruesit e qyteteve është fondi i defterëve të kadinjëve të njohura si

sixhilate. Informacioni që përbënë këta defterë është i larmishëm dhe si i tillë jep mundësi të trajtohen edhe problemet më të vogla familjare, siç është rasti me dhunën në familje, shitblerjen, huamarrien dhe copëza tjera të përditshmërisë së një qytetari shqiptar dhe jo vetëm të kohës.

Historiografia shqiptare si dhe institucionet kërkimore shkencore të hapësirës shqiptare, akoma nuk ia kanë dalë të kenë një plan për ndriqimin e jetës socio-ekonomike të qyteteve dhe fshatrave shqiptare gjatë periudhës së sundimit osman. Për rezultat, studiuesit që trajtojnë historinë e qytetit shqiptar dhe që nuk janë njohës të gjuhës osmane, obligohen që të përdorin referenca të dorës së dytë, apo edhe legjenda.

- 1 Halil İnalcık, *The Ottoman Empire: The Classical Age, 1300-1600*, London: Weidenfeld and Nicolson 1973, f. 89-93.
- 2 İber Ortaylı, *Hukuk ve idare Adamı Olarak Osmanlı Devleti'nde Kadı*, Ankara 1994, f.12-13.
- 3 Halil İnalcık, - Joseph Schacht, “Mahkeme”, *İslam Ansiklopedisi*, Volumi VII., Milli Eğitim Basımevi, İstanbul 1993.
- 4 Në osmanisht kemi 6 lloje shkrimesh të cilat janë të stileve të ndryshme dhe që janë përdorur në periudha të caktuara.
- 5 Ahmet Akgündüz, *Şer'iyye Sicilleri*, İstanbul 1988, f. 18
- 6 Zulfıye Kocak, *Jurnal of the Human and Social Science Researches* "Introduction and the list of 1017 (AD 1608) Serizze Records of Azntab City" f. 172.
- 7 Po aty, f. 21.
- 8 Po aty, f. 12.
- 9 Abdülaziz Bayındır, *İslâm Mahkeme Hukuku*, İstanbul 1986, f. 30.
- 10 Agron İslami, "1579 Numaralı Rodosçuk şer'iyye sicilinin Transkripsiyonu ve Değerlendirmesi", Sakarya Türkiye, 2010, f.269.
- 11 A. Akgündüz, po aty, f. 44.
- 12 A. Akgündüz, po aty, f. 48.
- 13 Gökbilgin M. Tayyip "Kanuni Sultan Süleyman Devri Başlarında Rumeli Eyaleti, Livalar, Şehir ve Kasabalar", Belleten, C. 20, Ankara, 1956.
- 14 Necati Çayırılı, *Manastır'ın 2 numaralı Şer'iyye Sicili (1621-1623)*, Ege Üniversitesi, Sosyal Bilimler Enstitüsü Türk Tarihi Ana Bilim Dalı, İzmir.


Komisia Letrare Shqipe e Shkodrës

Komisia Letrare Shqipe e Shkodrës është një këshill i formuar nga intelektualët më në zë të kohës mbi çështjen e gjuhës shqipe, ndër këtë elitë merrnin pjesë edhe albanologë të huaj.

Sevdie OSMANI

Që nga Rilindja, ideja për unifikimin e gjuhës shqipe nga shumë intelektualë, gjuhëtarë, patriotë shqiptarë ka qenë e vazhdueshme. Edhe *Komisia Letrare e Shqipes e Shkodrës* u mbledh për këtë qëllim, ku ideator ishte intelektual i shquar Luigj Gurakuqi. Ajo u mbledh atëherë kur shteti shqiptar ishte nën sundimin e Austro-Hungarisë, e cila pati një rol të rëndësishëm në organizimin e saj.

Komisia Letrare e Shqipes e Shkodrës është një këshill i formuar nga intelektualët më në zë të kohës mbi çështjen e gjuhës shqipe, ndër këtë elitë merrnin pjesë edhe albanologë të huaj. Në të përkohshmen “*Lajmet e Komisionit Letrar Shqipërisë*”, 1918, f.2 shënohet se *Komisia* filloi veprimtarinë e vet më 1 shtator 1916, kur u bë edhe mbledhja e parë. Por puna përgatitore kishte filluar edhe më parë.



Komisia Letrare Shqipe e Shkodrës mori përsipër detyra të mëdha, siç ishin hartimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës sonë, ku përherë të parë në historinë e gjuhës shqipe hartohej një kod drejtshkrimor, hartimin e termave të fushave të ndryshme të veprimtarisë juridike, administrative etj., hartimin e teksteve shkollore dhe përcaktimin e termave të tyre. Ajo punoi për organizimin e bibliotekës shqiptare, më konkretisht për organizimin, fondin, pasurimin dhe administrimin e bibliotekës.

KOMISIA LETRARE SHQIPE E SHKODRËS DHE KUSHTET HISTORIKO-SHOQËRORE KUR U MBLODH AJO

Duke pasur parasysh që përpjekjet për unifikimin e gjuhës shqipe kanë qenë të herëpashershme nga intelektualët shqiptarë, duke u nisur nga *Shoqëria e Shtypurit Shkronja shqip* (1879), *Kongresi i Manastirit* (1908), *Kongresi i Elbasanit* (1909), njashu edhe *Komisia Letrare Shqipe në Shkodër* nuk qe e rastit. Kjo cilësohej si njëra nga ngjarjet e rëndësishme në historinë e kulturës sonë kombëtare. Ajo filloi punën në qytetin e Shkodrës më 1 shtator 1916 deri më 1918, qytet i cili njihej në atë kohë me një histori dhe kulturë të lashtë, që kishte njohur disa pika kulmore zhvillimi. Edhe ashtu nga ky qytet dolën përfaqësuesit e parë të kulturës humaniste, si: Dhimitër Frangu, Marin Beçikemi, Marin Barleti etj., të cilët, me botimet e tyre, edhe pse në gjuhë të huaja, i shërbyen kulturës sonë.

Që nga shekulli XVI thuhet se Shkodra ishte një qytet i madh. Kohë më vonë, ky qytet do të përmendej edhe për Pashallëkun e Shkodrës që qeverisej nga dinastia e përmendur e Bushatlinjve. Ndërsa Sami Frashëri në veprën “Kamus-al-alam” (1899) e përshkruan Shkodrën një qytet që kishte 4500 shtëpi, 1500 dyqane e magazina, një çarshi (pazar, i pari në Shqipëri), një bibliotekë e 3700 banorë. Kishte shkolla, ndërtesa shtetërore etj.¹

Më 24 qershor 1879 botohet gazeta e parë “Iskodra” e përjavshme në shqip dhe turqisht, organ zyrtar i vilajetit të Shkodrës. Më 1858 kemi të realizuar fotografinë e parë nga Pjetër Marubi, pikërisht nga ky vit e deri 1890 u ndërtua studioja e parë fotografike.² Edhe teatri e ka zanafillën në Shkodër. Themelimi i dy shoqërive “Bashkimi” (1899) dhe “Agimi” (1901) që dhanë një kontribut të jashtëzakonshëm sa i përket alfabetit shqip, e para e mbështetur në dyshkronjësia, e dyta një tingull një shkronjë, gjithashtu botuan tekste shkollore.

Pra, faktorët historikë, social-kulturorë dhe arsimorë janë ata faktorë që ndikuan në organizimin e këtij institucioni

shkencor për t’i zgjidhur çështje madhore të kulturës sonë, detyrë që do ta kryente *Komisia Letrare Shqipe e Shkodrës*. *Komisia Letrare e Shkodrës* nuk ishte një nismë individuale e disa patriotëve dhe intelektualëve të shquar, por kushtet historike, social-kulturorë e determinuan një ngjarje të tillë.

Përpara se të filloi punën *Komisia Letrare Shqipe e Shkodrës*, ishin mbajtur disa mbledhje dhe konsulta, sepse për këtë duhej të jepej edhe miratimi i Komandës ushtarake austriake. Si datë e themelimit të *Komisionit Letrare Shqipe të Shkodrës* merret 1 shtatori 1916, kur u mbajt mbledhja e parë.

INTELEKTUALËT QË MORËN PJESË NË KLSH

Ata që morën pjesë në KLSH kryesisht ishin intelektualë të cilët ishin përmendur për veprimtari të shquar kombëtare, politike, gjuhësore, letrare, arsimore etj., personalitete të kulturës kombëtare ekspert të të gjitha fushave, njohës të të gjitha gjuhëve klasike e moderne të kontinentit evropian, si dhe të zhvillimit arsimor e kulturor të vendeve të përparuara. Pavarësisht nga rrethanat në të cilat u themelua *Komisia Letrare Shqipe e Shkodrës*, ajo u krijua me nismën e Luigj Gurakuqit në Shkodër më 1916 pranë Drejtorisë së Arsimit.³ Prapa saj qëndronte autoriteti i Austrisë. Siç dihet, në atë kohë Shqipëria pas Luftës së parë Botërore ishte nën sundimin e Austro-Hungarisë. Ata që morën pjesë në *Komisionin Letrare Shqipe të Shkodrës* janë: Luigj Gurakuqi, Aleksandër Xhuvani, Gjergj Pekmezi, Luigj Naraçi, Gjergj Fishta, Sotir Peci, Dom Ndre Mjeda, Mati Logoreci, At Ambroz Marlaskaj, Hilë Mosi, Anton Paluca, Hafiz Ali Korça, Maksimilian Lamberc, Rajko Nahtigali, Vinçenc Prendushi, Sali Nivica, Josif Haxhimima.

Struktura e këtij komisioni ka qenë e përbërë: një kryetar, një sekretar, disa misë (anëtarë), disa misë me korrespondencë dhe të ftuar. U mor vendim qysh në mbledhjen e parë që anëtarët e Komisionit të mbledheshin tri herë në javë nga dy orë. Çdo mbledhje do të protokollohej, do të caktohej tematika për të cilën do të diskutohej, dhe gjithashtu vendimet do të merreshin me shumicë votash dhe në rast se ndërkohë paraqitet ndonjë problem me rëndësi mund të aktivizohej



ndonjë dijetar i huaj që ishte i rëndësishëm në filologjinë shqiptare.⁴

Edhe pse në KLSH pati më shumë shkrimtarë gegë, jo të gjithë i përfillën vendimet që u morën në këtë komision, njëri prej tyre ishte Gjergj Fishta, i cili nuk i përfilli këto vendime kombëtare. Megjithatë, këto përpjekje që u bënë gjatë kësaj periudhe u kurorëzuan në *Kongresin Arsimor të Lushnjës* të vitit 1920. Kryeministri i Shqipërisë së asaj kohe kishte autorizuar administratën shtetërore që për bazë të gjuhës së shkruar zyrtare ta kishte të folmen e Elbasanit (Ismajli, R. 2005:56). Kjo qeveri kishte formuar Akademinë Letrare për unifikimin e gjuhës zyrtare dhe kishte formuar një komision të posaçëm për çështje të ortografisë dhe të gjuhës së shkruar që në këtë mënyrë të caktohet një ortografi të unifikuar për gjithë shqiptarët.

ÇËSHTJET QË U DISKUTUAN NË KLSH

Për shqipen e përbashkët

Për drejtshkrimin e gjuhës shqipe

Edhe pse KLSH-ja ishte një ngjarje shumë e rëndësishme, ajo nuk arriti t'i zgjidh të gjitha çështjet gjuhësore, sepse aso kohe shteti shqiptar ishte i pushtuar. Nga diskutimet dhe debatet që u zhvilluan u vendos që të hartohet një ortografi sa më e përbashkët për të dyja dialektet. Në këtë mënyrë, *Komisia* shpalli parimin fonetik si parimi i gjithë praktikës gjuhësore të shqipes, pra *Ortografia e Gjuhës Shqipe* duhet të ishte për sa mundej fonetike d.m.th. gjuha do të shkruhej ashtu siç flitej prej popullit.⁵


Më 29 janar më 1917 u miratua për herë të parë një kod drejtshkrimor "*Parime e rregulla mbi ortografinë e gjuhës së shkrueme*".

Më 29 janar 1917 *Komisia Letrare Shqipe* mbas diskutimesh për çështje të ndryshme drejtshkrimore arriti të miratojë "*Rregullat mbi ortografinë e gjuhës shqipe të shkrueme*". Disa ditë më vonë ato u botuan në Shkodër si broshurë.

Komisia Letrare Shqipe diskutoi edhe për hartimin e termave të fushave të ndryshme të veprimtarisë juridike, administrative etj.

Komisia Letrare Shqipe botoi edhe organin me titull *Laimet e Komisë Letrare Shqipe në Shkodër*. Kjo e përkohshme kishte për qëllim që të përkujdesej për të gjitha çështjet që u përkisnin lëvrimit të gjuhës shqipe, përparimit dhe zhvillimit të saj. Do të botoheshin ligjërata, vepra, dorëshkrime, folklor etj.

KLSH diskutoi edhe për kriteret e hartimit të teksteve mësimore, përcaktimin e terminologjisë shkollore, mënyrat



e hartimit dhe e botimit të tyre. *Komisia* u mor me këtë problem sepse vetëm në këtë mënyrë do ta zhvillonin arsimin kombëtar. Si rrjedhojë e veprimtarisë së KLSH-së, në Shkodër u hap për herë të parë shkolla laike për vajzat e qytetit.

Një hap tjetër për sa i përket veprimtarisë së KLSH-së ishte edhe zhvillimi i letërsisë.⁶ Ajo u mor edhe me organizimin e bibliotekës shqiptare.

Si përfundim, *Komisia Letrare e Shkodrës*, si një institucion me vlera të veçanta shkencore, historike, gjuhësore, letrare, arsimore dhe kulturore për kohën me vendimet e saj e çoi më tej njësimin e gjuhës letrare e drejtshkrimin e saj, kontribui mjaft në konvertimin e saj, duke e shpënë më tej prirjen konvertuese të rilindësve të shquar, gjë që u arrit me kodifikimin prej saj të arritjeve kryesore drejtshkrimore të mëparshme.⁷

1 Osmani, T. 2012: 16.

2 Krasniqi, Sh. 2004: 10-13.

3 Ismajli, R. 2005:53.

4 Osmani, T. 2012: 34.

5 Osmani, T. 2012: 58.

6 Osmani, T. 2012:90.

7 Çeliku, M. 2001: 79.

Medresetë-shkollat e para në periudhën klasike osmane (1360 – 1600)

Phd. Driton KELMENDI

HISTORIKU I NDËRTIMIT TË MEDRESEVE – SHKOLLAVE OSMANE

Dituria dhe ndjekja e rrugëve të dijes në botën islame është vlerësuar dhe zhvilluar vazhdimisht. Edhe tek osmanët, dituria është vlerësuar shumë lart. Në pjesën e Anadollit të sotshëm, para qeverisjes osmane, si model të diturive dhe sistemit të arsimit ishte Konja, kryeqendra e mbretërisë Selçuke, pastaj qytetet e tjera si Kajseri, Aksaraji, vendet e ndryshme nga bota arabe dhe Irani. Në shekujt XI-XII, në qytetin e Konjës, si kryeqendër e mbretërisë Selçuke, kanë qenë afërsisht 14 medrese – shkolla të larta, universitete.¹ Medresetë e kësaj kohe në Konja janë të ngjashme me universitetet e kohës sonë. Tri objektet e medreseve-universiteteve të asaj kohe sot shërbejnë si muze në Konja: “Medreseja Karataj”, “Inxhe Minare” dhe “Medreseja Sırçali”. Krahas zhvillimeve të bejlikut-principatës, osmanët në të njëjtën kohë kanë zhvilluar edhe tregtinë, kulturën, jetën sociale dhe zhvillimin e fesë.

Orhani, i biri i Osmanit shtypi monedhat e para të argjendta në Bursë më 1327. Në qytetin e Iznikut, në vitin 1331 themeloi medresenë -shkollën e lartë. Më 1340, në qytetin e Bursës ndërtoi një qendër tregtare – Bedesten (treg i mbyllur ku shiten mallrat me vlerë).² Në vitin 1334, qytetin e Bursës e vizitoi udhëpërshkruesit arab, Ibni Batutë, i cili thotë se është një qytet i madh, me qendër të madhe, e me rrugë të gjëra.³ Osmanët në kohën e Orhanit filluan një zhvillim i cili reflektonte në të gjitha fushat e jetës. Ky zhvillim bëri që në kohën e Orhanit të ngritët zhvillimi arsimor dhe në vitin

1331, në qytetin e Iznikut themeloi Medresenë e parë osmane (shkollën e lartë-universitet).⁴ Orhani në qytetin e Iznikut, si pjesë e rëndësishme e principatës osmane, së bashku me xhaminë, ndërtoi një strehimore për të varfrit dhe medresenë -shkollën e lartë.⁵ Duke e përshtatur me objektin e një manastiri, ndërtohet medreseja - shkolla e lartë, e cila ishte caktuar shkollë e lartë e një dijetari të famshëm i cili quhej Dauti nga qyteti i Kajserisë.⁶ Pra në këto medrese-shkolla të larta vijonin mësimin nxënësit që kishin bazë të njohurive fetare dhe nga këto shkolla përgatiteshin kuadrot për fushat e larta udhëheqëse si fetare ashtu administrative, ushtarake e shtetërore. Kjo medrese-shkollë e lartë është medreseja e parë osmane. Kjo shkollë si dhe ndikimet e shkollave si modele në qytetet si: Konja, Kajseri, Aksarayi, ose nga bota islami si Irani, Turkistani, Egjipti, Siria, etj., kanë bërë që së bashku me zhvillimin e osmanëve të zhvillohen dhe përhapen edhe më shumë dituritë e ndryshme në shkollat e tyre që quheshin medrese - universitete.⁷ Zhvillimi i shkollës së ulët dhe i shkollës së lartë osmane dallohej edhe nga periudha apo koha e qeverisjes së sulltanëve. Pas shkollës së Iznikut, Orhani ndërtoi shkollë të lartë edhe në qytetin e Bursës, pastaj në qytetin e Bursës u ndërtuan shkolla dhe objekte ndihmese për shkollat, si dhe objekte të tjera në shërbim të shoqërisë.

Në vitin 1365-66, Murati I, pastaj në vitin 1388, Bejaziti I dhe në vitin 1418-19, Çelebi Mehmeti, ndërtuan shkolla dhe objekte ndihmese në qytetin e Bursës, Iznikut dhe në disa vende të tjera më të vogla. Por, pas Iznikut, qyteti i Bursës është qyteti më i zhvilluar me shkolla dhe objekte të tjera

infrastrukturore.⁸ Kjo periudhë e këtyre sulltanëve dhe investimet e tyre në sistemin arsimor të asaj kohe, në shkolla të ulëta dhe të larta, rregullimin e infrastrukturës, si prurjet nga jashtë të dijetarëve të fushave të ndryshme, si dhe ndërtimin e objekteve shkollore të larta dhe objekte ndihmëse, konsiderohet si vendosje e themelit të sistemit arsimor osman të periudhës së hershme osmane. Më vonë nëse një sulltan dëshironte të themelonte medrese - universitet të ri, ai ftonte dijetarë nga Anadulli, nga qendrat kulturore si Konja, Aksaraji, Kajseri, apo nga bota islame si Irani, Turkistani, Egjipti apo Siria,⁹ që të merrte mendimet më të mira nga ta për të arritur organizimin e një sistemi të arsimimit sa të mirë.

Me rritjen dhe zgjerimet e mëdha të osmanët, në të njëjtën kohë edhe shteti osman ngrihej dhe forcohej ekonomikisht, e kjo ngritje ekonomike ka ndikuar shumë edhe në sistemin e edukimit, që në atë kohë është quajtur shkollë e lartë - universitet. Në kohën e Muratit II, për ta forcuar medresenë osmane, ftohet nga Irani dijetari Alaeddin Tusi (v. 1482) dhe Fahredini, të cilët ia shtuan famën shkollës së lartë osmane, e cila u zhvillua shumë shpejt. Në shekujt XIV dhe XV, në kohën kur formohej kultura osmane, dijetarët osman shkonin të merrnin dituri në vendet si Egjipti, Irani, dhe Turkistani. Për çështjet fetare si tefsiri, komentimi – sqarimi i Kuranit dhe studimet e fikhut – jurisprudencës islame, dijetarët osmanë fillimisht shkonin në Egjipt dhe Iran. Mehmet Fenari, Ali Fenari, Sheh Bedredini, si dhe disa të tjerë ishin nga ata që shkuan në këto vende. Në shekullin XV, dijetarët si Sadedin Taftazani dhe Seyyid Sherif Xhyrxhani, shkuan në territoret e sunduara nga Timuri. Për të studiuar shkencat e matematikës dhe të astronomisë, dijetarët osmanë, vazhdimisht kanë shkuar në Semerkand.¹⁰

MEDRESE TË, SHKOLLAT E LARTA NË KOHËN E SULLTAN MEHMETIT II

Pas kalimit të qendrës osmane nga Edirne në Stamboll, sulltan Mehmeti II, është ankuar se është krijuar një perandori e madhe, por që ka pak dijetarë. Ndër dijetarët që kanë qenë në kohën e tij dhe që ai është krenuar me ta janë Mulla Hysreviu dhe Mustafa Hocasade.¹¹ Në qytetin e Stambollit,

Me rritjen dhe zgjerimet e mëdha të osmanët, në të njëjtën kohë edhe shteti osman ngrihej dhe forcohej ekonomikisht, e kjo ngritje ekonomike ka ndikuar shumë edhe në sistemin e edukimit, që në atë kohë është quajtur shkollë e lartë - universitet.

Mehmeti II, i shndërroi tetë kisha bizantine në Medrese – shkolla të larta, për tetë dijetarë të mëdhenj, ndërsa gjatë viteve 1463-1470 ndërtoi xhaminë e Fatihut, e përreth xhamisë ndërtoi tetë Medrese – shkolla të larta, të njohura si Sahn-i Seman ose Semanije dhe për secilën nga këto shkolla caktoi nga një dijetar.¹² Shkollat ishin ndërtuar në të dy anët e xhamisë Fatih, me ndërtime prej guri dhe me stil dhe bukuri të arkitekturës osmane të asaj kohe. Përveç tetë shkollave të larta, ishin edhe tetë shkolla të ulëta, të cilat përgatitnin nxënësit për shkollat e larta. Secila shkollë kishte nga një myderriz (profesor, pedagog, mësues medreseje), i cili kishte pagën ditore 50 akçe. Secila shkollë kishte 19 dhoma dhe një klasë, bibliotekën për secilën shkollë dhe një bibliotekë të përgjithshme. 15 dhoma jepeshin për nxënësit kujdestar, të cilët ishin përzgjedhur nga profesori. Këta nxënës kishin përfunduar shkollimin e ulët dhe përgatiteshin për studime të larta. Çdonjëri nga këta

student merrte nga dy akçe në ditë dhe ju sigurohej ushqimi e banimi nga fondet e bamirësisë – vakëfi.¹³ Në këtë periudhë, shkolla më e lartë ishte shkolla Semanije, pastaj në rangun e dytë, apo më të ulëta si kategori, vinin shkollat që ishin ndërtuar në Anadoll para osmanlinjve. Shkolla “Darulhadis”, të cilën e kishte ndërtuar Murati II në Edrene, e pas saj vinin shkollat e themeluara nga sulltanët e mëhershëm në Bursa. Pas tyre vinin shkollat që mbështeteshin nga njerëzit e mëdhenj të shtetit në tri qytete, në provincat siç ishin Medreseja e Ali Pashës në Edrene, e Shiabedin Pashës në Filibe, e Mahmut Pashës në Stamboll, e Eski Ali Pashës në Bursë dhe Medreseja e Isak Beut në Shkup.¹⁴ Osmanët kishin dy kategori kryesore të shkollave, Medresetë Hariç dhe Medresetë Dahil.

MEDRESEJA HARIÇ (SHKOLLË E ULËT, FILLORE)

Në këtë medrese përgatiteshin kuadrot me bazat kryesore të diturive. Nxënësit në këtë kategori të shkollave ndaheshin në tri grupe, e po ashtu edhe mësuesit që punonin në këto shkolla paguheshin më pak se në shkollat dahil.¹⁵



MEDRESEJA DAHIL (SHKOLLË E LARTË)

Këto shkolla ishin të themeluara prej shtresës më të lartë osmane, nga fëmijët e sultanëve, vezirët etj. Nga këto shkolla përgatiteshin edhe kuadrot për pozitat e larta fetare dhe shtetërore. Në këtë grup të shkollave hynin edhe tetë shkollat e Sulltan Mehmetit II. Në vitet 1550-1559, gjatë ndërtimit të xhamisë “Sylejmanie”, sultan Sylejmani I, bëri një ndryshim të shkollave. Pranë xhamisë ndërtoi katër medrese – shkolla të përgjithshme dhe dy të veçanta, ku në njërin studiohej shkenca e hadithit dhe në tjetrën shkenca e mjekësisë. Këto patën rangun më të lartë si shkolla. Osmanët ndërtuan shkolla në shumë vende dhe qytete të ndryshme, kryesisht në qytete të mëdha. Më 1529, në qytetin e Edirnes kishte 14 shkolla. Në shekullin XVII, në qytetin e Stambollit kishte 95 shkolla, ndërsa deri në shekullin XIX, numri i tyre kishte arritur në 170.¹⁶

Medresetë – shkollat, si në periudhën para osmane, ashtu edhe në atë osmane, mbështeteshin nga vakëfi. Në përgjithësi, xhamitë, bujtinat dhe fondacionet e tjera bamirëse ishin një institucion. Përgjegjësi i këtij institucioni – vakëfi, i përgjigjej profesorit apo pedagogut, i cili i përzgjidhte nxënësit dhe menaxhonte shkollën apo vakëfin. Profesorët dhe pedagogët përzgjidheshin nga sultani.¹⁷

Medresetë – shkollat e ndërtuara në qytetet kryesore nga disa prej sultanëve osman në periudhën klasike osmane.

Shkollat në qytetin e Iznikut

Në periudhën e sundimit të Orhanit (1324 – 1362) janë ndërtuar tri shkolla;

Në periudhën e sundimit të Muratit I (1362 – 1389) është ndërtuar një shkollë;

Në periudhën e sundimit të Muratit II (1421 – 1451) është ndërtuar një shkollë.

Shkollat në qytetin e Bursës

Në periudhën e sundimit të Orhanit (1324 – 1362) janë ndërtuar tri shkolla;

Në periudhën e sundimit të Muratit I (1362 – 1389) janë ndërtuar dy shkolla;

Në periudhën e sundimit të Bejazitit I (1389 – 1403) janë ndërtuar nëntë shkolla;

Në periudhën e sundimit të Çelebi Mehmetit I (1413 – 1421) janë ndërtuar dy shkolla;

Në periudhën e sundimit të Muratit II (1421 – 1451) janë ndërtuar pesë shkolla.

Shkollat në qytetin e Bursës (mos ndoshta qetu duhet të jetë Edirne, për shkak se Bursa është përmendur më lartë, e në fjalinë e më poshtme, shkruhen tri qytete, Iznik, Bursa dhe Edirne.)

Në periudhën e sundimit të Çelebi Mehmetit I (1413 – 1421) janë ndërtuar dy shkolla;

Në periudhën e sundimit të Muratit II (1421 – 1451) janë ndërtuar nëntë shkolla.¹⁸

Gjatë periudhës kohore 1324 – 1451, në tri qytete, në Iznik, Bursa dhe në Edirne, janë ndërtuar 36 shkolla. Shkollat e ndërtuara në qytetet e tjera përgjatë kësaj periudhe janë të dorës së dytë për nga rëndësia.

Üsküp-Shkupi, Afjonkarahisar, Regjioni i rrafshit Akça, Alashehir, Amasja, Balikesir, Bergama, Bolu, Çorum, Dimetoka, Filibe, Gelibolu, Shtip, Izmit, Kytahja, Malkara, Merzifon, Milas, Mudurnu, Sapanxha, Tire, Tokat, Tuzla, Yenishehir, etj.¹⁹

1 Medrese – shkollë fetare. Ndërtesë e shkollës fetare. Fakultet. Fjalor Turqisht-Shqip. Sami Neziri. EDFA Tiranë, 2006, f. 615.

2 Osmanlı İmperatorluğu Klasik Çağ (1300-1600). Halil İnalcik, Yapı Kredi Yayınları. İstanbul, 2013. f. 13.

3 Po aty, f. 14.

4 Mustafa Bilge, İlk Osmanlı Medreseleri, İstanbul 1984, f. 11,12.

5 Osmanlı Müesseseleri Tarihi. Mehmet Ali Ünal. Fakülte Kitabevi. Isparta.2015, f.125.

6 Osmanlı İmperatorluğu, vep. e cituar. f. 175.

7 Po aty, f. 175.

8 Osmanlı Müesseseleri, vep. e cituar, f. 125.

9 Osmanlı İmperatorluğu, vep. e cituar, f. 175.

10 Po aty, f. 175.

11 Po aty, f. 176.

12 Osmanlı Müesseseleri, vep. e cituar, f. 127.

13 Po aty, 176.

14 Po aty, f. 175. Mustafa Bilge, vep. e cituar, f. 200.

15 Osmanlı İmperatorluğu, vep. e cituar, f. 176.

16 Po aty, f. 177.

17 Po aty, f. 177.

18 Mustafa Bilge, vep. e cituar, f. 1, 2, 3.

19 Po aty, f. 2, 3.

Mulla H. Sadik ef. Hoxha (1908 - 1972)

Njeriu që gjithë jetën ia kushtoi fesë e atdheut

Ma. Vehbi SHATRI

Në plejadën e hoxhallarëve të dalluar të Dukagjinit e më gjerë, të cilët u shkolluan në medresetë që vepruan në mes të dy luftërave botërore në Rrafshin e Dukagjinit, dhe që lanë gjurmë në kujtesën e besimtarëve dhe të popullit shqiptar për mençuri, trimëri, atdhedashuri dhe për devotshmëri, veçohen: mulla Jahja Daci, mulla Zekë Byrdyna, mulla Ramush Shatri, mulla Iljaz Broja, mulla Isa Haxhijaj, mulla Sadik Hoxha e të tjerë. Këta ishin krenaria e Islamit dhe patriotizmit. Ishin të tillë meqë ishin predikues të shkëlqyeshëm të fesë islame dhe të arsimimit kombëtar.

LINDJA DHE FAMILJA

Sadiku lindi në Uçë nga prindërit mulla Sadriu nga fshati Uçë i Istogut dhe Ajsheja nga Ribariqi, motra e mulla Mahirit. Mulla Sadiku rrjedh nga një familje me gjendje ekonomike



mesatarisht të mirë, por me një traditë të mirëfilltë fetare dhe kombëtare. I ati i mulla Sadikut ishte mulla Sadri ef. Gashi (1853 - 1948). Mulla Sadriu ishte ixhazetlij i Medresesë së Gjakovës. Në fillim kishte punuar rreth gjashtë vite imam xhamie në Kllodernicë të Runikut të Drenicës. Në Drenicë ishte njoftuar me burra të dijes e pushkës

si: Xhemajl Obrija, Xhemajl Izbica, Azem Bejta etj. Ishte mirë i informuar për traditën e pasur të asaj ane, me sfidat e peripecitë e kohës, me rezistencën për të ruajtur kombin e fenë.

Mulla Sadriu, pas kësaj, kalon me punë në fshatin e tij të lindjes në Uçë, në vendlindjen e tij-shërbeu imam xhamie për dyzet e dy vjet, deri në vdekje.

Xhaminë e fshatit Uçë e kishte ndërtuar Bedri Begu, të parët e të cilit moti ishin shpërngulur në Turqi nga Uça (i mëhallës Arifaj). Bedri Begu asaj kohe, kur ndërtoi xhaminë, ishte ministër në qeverinë turke.

Mulla Sadiku, ishte martuar me zonjën Sabrije, të bijën e mulla Fetah ef. Hoxhës nga Kllodërnica e Skënderajt, me të cilën Allahu i begatoi me dy djem. Në moshë të re ajo vdes. Pastaj është martuar me zonjën Shahbaze Zatriqi, bijë e mulla Hysejn Zatriqit nga Peja, imam në Shushicë në atë kohë. Më këtë, Zoti iu fali tri vajza e tre djem. Një vajzë dhe një djalë i kishin vdekur fëmijë. Familja Gashi, e që tani një pjesë e kësaj familje mbajnë emrin Hoxha, në përgjithësi në anën e Podgurit njihet si familje fisnike, fetare e atdhetare.



*Mulla Sadri ef. Gashi
(1853 - 1948)*

Gjatë tërë kohës së okupimit ka qenë i dobishëm për popull, sepse i dinte hallet dhe nevojat e tyre dhe si i tillë ka mundur të ndihmojë në momentet më të vështira të okupimit.


SHKOLLIMI

Shkollën fillore e kreu në fshatin Uçë. Në atë kohë shkolla ishte në shtëpinë e xhamisë deri në vitin 1925 kur ishte ndërtuar shkolla shtetërore. Në shkollë para vitit 1925, kishte pak nxënës, e më së paku nxënës shqiptarë mund të kenë qenë: Sadiku, Imeri nga Uça dhe Beslimi, që më vonë ishte njohur si “mulla Beslimi”. Pasi që Sadiku e mbaron shkollën fillore, babai i tij Sadri efendiu, e dërgon në Medresenë “Mehmet Pasha” të Prizrenit, para myftiut të çmuar Nusret efendi Galipit. Ani pse kushtet ishin shumë të vështira, qoftë banimi, ushqimi, udhëtimi etj., megjithëkëtë kjo nuk e pengoi Sadikun që me sukses ta kryej Medresenë dhe marrë të drejtën për imam.

KONTRIBUTI DHE PUNA

Pas kryerjes së Medresesë, Sadiku u inkuadrua në punë si zyrtar i Bashkësisë Islame në Skenderaj, më 1932, ku punoi katër vjet. Aty informohet për një konkurs për pranimin e nxënësve në Medresenë “Isa Beu” në Shkup, dhe e regjistron vëllain e vetë Abdurrahimin. Abdurrahimi mbaroi me sukses, si gjeneratë e parë, pesë klasë të kësaj Medreseje: Të tilla në Ballkan ishin katër medrese, dy në Shkup, një në Tiranë dhe një në Sarajevë.

Kur kapitulloi Jugosllavia më 1941, dhe u formua komuna në Rakosh në kohën e Italisë, si njeri i aftë, Sadiku u inkuadrua sekretar i Komunës, ndërsa kryetar ishte Jusuf Boletini, nga familja e Isa Boletinit. Sadiku aty punoi katër vjet. Në atë kohë u formuan njësite vullnetarësh nën udhëheqjen e Cal Bajraktarit dhe Ramë Alisë, njësi këto që mbronin dhe i bënë rezistencë çetnikëve të Koleshinit. Sadik Hoxha iu ndihmoi këtyre luftëtarëve duke iu dërguar ushqim dhe gjithçka që kishin nevojë. Sadik efendiu, me shkathtësinë e vetë dhe autoritetin që gëzonte ka shpëtuar shumë njerëz të marrë peng e që ishin në plan të likuidoheshin. Si



administrator i mirë, më 1941, emërohet sekretar komune në Rakosh, të cilit territor i takon edhe vendlindja e tij Uça. Si sekretar i Komunës së Rakoshit ka mbrojtur popullsinë nga sulmet e banditëve dhe të rrugaçëve.

Gjatë tërë kohës së okupimit ka qenë i dobishëm për popull, sepse i dinte hallet dhe nevojat e tyre dhe si i tillë ka mundur të ndihmojë në momentet më të vështira të okupimit. Më 1941, refugjatëve të ikur prej çetnikëve nga Bosnja, Sanxhaku e Mali i Zi, u bëri strehim, duke i shpërndarë nëpër terrenin e komunës së vet dhe duke i furnizuar me ushqim e gjëra të tjera. Ani pse ishte në këshill për mbrojtjen e refugjatëve, prapëseprapë personalisht i mbronte, i vizitonte kohë pas kohe, posaçërisht gjatë Ramazanit dhe netëve të Bajrameve dhe personalisht iu ndante ushqim, duke u bërë kështu bir dhe vëlla i të gjithë refugjatëve në terrenin e vet.

Nga familjet e refugjatëve ka pasur edhe ilegalë që kanë punuar për LNC-në, të cilët ai mirë i ka njohur dhe

kurdoherë që ju drejtoheshin për ndihmë iu ndihmonte pa kursyer asgjë.

Sadiku ndihmoi shumë shkollën në Uçë, të cilën shkollë e kishte hapur për herë të parë në gjuhën shqipe vëllai i tij, Abdurrahim Gashi në vitin 1942.

Pas formimit të Jugosllavisë Federale, më 1944 emërohet nëpunës i Këshillit popullor të rrethit të Istogut, ku punoj tri vjet në sektorin e planit, ndërsa në administratë njëmbëdhjetë vjet. Gjatë gjithë kohës sa ka shërbyer, ani pse kishte shumë kërkesa të natyrave të ndryshme, me urtësinë dhe mençurinë e tij, gjithherë ka treguar sukses dhe me punën e tij kanë qenë të kënaqur të gjithë.

Pas vdekjes së babait, më 1948 më kërkesën e xhematit të rreth 300 shtëpive, Sadik efendiu, bëhet imam i xhamisë në fshatin Uçë, ku shërbeu jo më pak se njëzet e katër vjet, nga 1948 deri më 1972.

Mulla Sadiku, kishte apeluar popullit, qoftë në xhami, me vlyd apo tubime të tjera, duke u bazuar në Kuran e hadith, që t'i dërgojnë fëmijët e tyre në shkollë, gjë që edhe vetë e bënte. Kur paraqitej nevoja për meremetimin e xhamisë së vet apo xhamive të tjerave, gjithherë ishte i pari në ndihmë. Ishte i pari në dhënien e huave për shkolla. (Në vitin 1972 ishte aksioni për inkasimin e huas për ndërtimin e shkollave). Ishte ndër të parët edhe për nevojat e tjera të Bashkësisë Islame.

Mulla Sadiku, pothuajse tërë kohën ishte nën shënjestër të sigurimit shtetëror. Po i përmendim këtu vetëm dy shembuj: Mulla Sadiku burgoset dhe atë dy herë. *Sadik Hoxha ishte i lidhur ngushtë me Jusuf Boletin, kryetar në komunën e Rakoshit, vëllai i tij nacionalist Abdurrahim Gashi në një tubim ka protestuar për të kundërshtuar mos përdorimin e gjuhës shqipe në administratë.* Ne aksionin e armeve 1956 ai ishte i planifikuar të maltretohej.

Mulla Sadiku, ishte mysliman i shkëlqyeshëm, i cili kishte menduar për të tanishmen dhe të ardhmen e Islamit dhe brezit islam, duke e vazhduar brezin e hoxhallarëve me djalin e vet Nexhmedinin. Mulla Nexhmedin Sadik Hoxhaj është

Mulla Sadiku, ishte mysliman i shkëlqyeshëm, i cili kishte menduar për të tanishmen dhe të ardhmen e Islamit dhe brezit islam, duke e vazhduar brezin e hoxhallarëve me djalin e vet Nexhmedinin.

hoxhë i njohur në Kosovë dhe më gjerë. Shërbeu imam, kryetar Këshilli në Istog e Pejë, anëtar në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës dhe pozita të tjera me rëndësi, deri në pensionim në vitin 2017. Tradita e studimit dhe shërbimit ndaj fesë islame, pos te djali mulla Nexhmedini, përcillet edhe te nipat e stërnipat e tij.

VDEKJA

Pas një aksidenti në komunikacion, mulla Sadiku ndërroi jetë më 20 korrik 1972. Për varrim e pastaj edhe për ngushëllime kishin vajtur shumë xhematë e hoxhallarë, ndër ta dhe mulla Ramush Shatri. Atë ditë të 20 korrikut, siç rrëfen Nexhmedin efendiu, mulla Ramushi si një hoxhë i madh që ishte, erdhi ndër të parët në Uçë, e duke na ngushëlluar edhe na tha: *“O burra, të bëheni të fortë! Sot nuk ka vdekur vetëm hoxha, por sot ka vdekur ora e hoxhallarëve, mbrojtësi i dinit. Autoriteti ma i fortë i besimit tonë, avokati i popullit në mbrojtje të të drejtave të fesë para*

hyqymetit të sotëm. Trimi i pa thyer e armiku i përbetuar i shkive. Sot na u ka thye një krahë, dhe jemi gjymtua rëndë. Zoti na lashtë shëndosh ne e ju e të gjithë shqiptarët e kësaj treve, haj medet haj, po ky o caktimi i Zotit tonë.....”

Se sa ishte i ndjeri h. Mulla Sadik Hoxha i njohur dhe i dashur, më së miri ka dëshmuar xhenazeja e tij, në të cilën përpos farefisit, miqve, shokëve dhe më shumë se 1500 besimtarëve, në varrim morën pjesë edhe shumë të tjerë të besimeve të tjera.

Allahu e pastë mëshiruar dhe e bëftë prej banorëve të Xhenetit firdevs! Lus Allahun të jetë në dritën e fjalës së Allahut, ku thotë: *“Dhe assesi mos mendoni se janë të vdekur ata që u vranë në rrugën e Allahut ! Përkundrazi, ata janë të gjallë duke u furnizuar te Zoti i tyre.”* (Ali Imran, 169)

1. Dr. Sulltane Kajqini, “Kudri arsimor në shënjestër të sigurimit shtetëror”, 1997.

2. Haxhi Beqir Vejseloviqi, “Merhum Haxhi Sadik Efendi Hoxha”, Edukata Islame, BIK, 1973.

3. Intervista me Abdurrahim Gashin, data:

4. Intervistë me Nexhmedin ef. Hoxhajin, djalin e mulla Sadikut, data:

Imam i Qabesë dr. Abdullah Avad El Xuheni qëndroi në Kosovë

Me ftesë të kryetarit të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiut Naim ef. Tërnavë, në Kosovë për vizitë tri ditore qëndroi imami i Qabesë, dr. Abdullah Avad el-Xuheni. Fillimisht ai u prit nga Myftiu Tërnavë në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari”, i cili i dëshiroi mirëseardhje dhe e falënderoi për këtë vizitë, duke e cilësuar kështu si një vizitë historike.

VIZITA NË KRYESI

Më 28 shtator 2022, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, me stafin e tij ka pritur në takim imamin e Qabesë, dr. Abdullah Avad el-Xuheni. Myftiu Tërnavë fillimisht falënderoi imamin El Xuheni për vizitën duke e çmuar dhe vlerësuar këtë vizitë, ngase është hera e parë që një imam i Qabesë po viziton Kosovën. Më pas, Myftiu Tërnavë e njohu imamin e Qabesë, dr. Abdullah Avad El Xuheni me aktivitetin dhe me veprimtarinë e BIK-ut, duke theksuar bashkëpunimin shumë të ngushtë që ka me autoritetet e Arabisë Saudite. Myftiu Tërnavë po ashtu theksoi se Arabia Saudite, populli i saj, Qeveria dhe mbreti i saj, Selman bin Abdulaziz al-Saud, ka ofruar përkrahje për Kosovën në periudha të ndryshme dhe në fusha të ndryshme

dhe se ata vazhdimisht kanë treguar praktikisht një përkushtim për bashkëpunim, mirëqenie dhe prosperitet për të gjithë popujt myslimanë të botës dhe popujt e tjerë miq. Ai theksoi se populli i Kosovës gëzon respekt dhe simpati të veçantë nga Qeveria dhe populli saudit, duke vënë në pah kështu rëndësinë e thellimin të bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve. Ai më pas po ashtu njohu mysafirin për praktikën e institucioneve të BIK-ut në respektimin e të gjitha besimeve për një bashkëjetesë të mirëfilltë pa dallim feje, race, gjuhe dhe etnie. Nga ana e tij, imami i Qabesë, dr. Abdullah Avad el-Xuheni, shprehu falënderime për mikpritjen vëllazërore dhe bujarinë e ofruar gjatë kësaj vizite, dhe se është i lumtur që po viziton Kosovën dhe popullin e saj.



VIZITA NË FAKULTETIN E STUDIMEVE ISLAME

Imami i Qabesë, dr. Abdullah Avad El Xuheni i shoqëruar nga Myftiu Tërnavë, vizituan Fakultetin e Studimeve Islame, ku u pritën nga dekani, dr. Islam Hasani dhe stafi i tij. Islam Hasani falënderoi imamin e Qabesë për vizitën dhe më pas e njohu atë me historikun, të arriturat dhe zhvillimin e FSI-së, duke shprehur kështu gatishmërinë e tyre për bashkëpunim me institucionet e larta arsimore të Arabisë Saudite. Pas këtij takimi, imami El Xuheni mbajti një ligjëratë në FSI.



VIZITA NË MEDRESENË "ALAUDDIN"

Imami i Qabesë, Abdullah Avad el-Xhuheni, në ditën e tij të dytë në Kosovë, ka vizituar medresenë e mesme "Alauddin" në Prishtinë, ku u prit nga drejtori i kësaj shkolle, Fadil Hasani, personeli akademik dhe imamë të shumtë të rajonit të Prishtinës. Imami i Qabesë me këtë rast foli për rëndësinë e unitetit të besimtarëve myslimanë si dhe për ndalesat që shpien në konflikte dhe në përçarje ndërmjet njerëzve. Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, tha se Kosova dhe populli i saj është mirënjohës ndaj Arabisë Saudite çdoherë për ndihmat që ka bërë në kohët më të vështira, por edhe për bashkëpunimin e shkëlqyer me Bashkësinë Islame të Kosovës, siç po ndodhë aktualisht me vizitën e imamit të Qabesë për çka po nderon gjithë besimtarët shqiptarë, ku edhe po mund të përfitojnë prej tij.

Imami El-Xhuheni, ka prirë në namazin e akshamit në xhaminë "Hasan Beg – 4 Llullat" në Prishtinë, ndërsa namazin e jacisë i priu dhe e fali në xhaminë "Shuajb Arnauti" në lagjen Mati 1 në Prishtinë ku edhe mbajti një ligjëratë.

Më 29 shtator, imami i Qabesë, El Xhuheni në shoqërim të Myftiut Tërnavë ka vizituar Prizrenin, ku i priu namazit të akshamit në xhaminë "Sinan Pasha" në Prizren. Me 30 shtator, Abdullah Avad el-Xhuheni, ka falur namazin e sabahut në xhaminë "Bajram Pasha Isa Beg" në Mitrovicë, ku edhe mbajti një ligjëratë të shkurtër për vlerën dhe rëndësinë e ditës së xhuma. Namazin e xhumasë e fali në xhaminë "Sulltan Mehmet Fatih" në Prishtinë. Ai në hytben e xhumasë, përcolli mesazhet për paqe, tolerancë e lehtësim në fe. (R.S).



MYFTIU TËRNAVA MBIKËQYRI PUNIMET NË NDËRTIMIN E XHAMISË QENDRORE

Më 1 shtator 2022, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë me bashkëpunëtorë mbikëqyren punimet në ndërtimin e Xhamisë Qendrore në Prishtinë. Me këtë rast, Myftiu Tërnavë u nda i kënaqur që punët në ndërtimin e Xhamisë Qendrore janë duke ecur sipas planit dhe dinamikës së paraparë. Ai veç tjerash tha se tanimë ka filluar të betonohet një pjesë e xhamisë, janë bërë disa shtylla dhe pritjet që në fund të muajit të përfundojë pllaka e parë.

Ai me këtë rast uroi të gjithë besimtarët që kanë kontribuar për ndërtimin e Xhamisë Qendrore në Prishtinë. Ai ka shprehur falënderime edhe për Dijanetin e Turqisë, kompaninë “Kumash” dhe të gjithë njerëzit vullnet mirë që kanë marrë përsipër ndërtimin e këtij objekti kaq domethënës për BIK-un dhe për vetë qytetarët e Kosovës. “Inshalla shumë



shpejt do të vjen dita ku do të festojmë ditën kur do të hapim xhaminë për t'i kryer obligimet e tyre që qytetarët tanë e kanë pritur me dekada e dekada” – tha ndër të tjera Myftiu Tërnavë.

Edhe nga kompania ndërtuese “Kumash” vlerësuan se punët po ecin

mirë e mbarë për ndërtimin e xhamisë, andaj me këtë rast falënderuan Myftiun Tërnavë për vizitën dhe interesimin e tij të vazhdueshëm për mbarëvajtjen e punimeve në këtë xhami. (R.S.)

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM AMBASADORIN E MALAJZISË, DATO ABDUL MALIK

Më 6 shtator 2022, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim ambasadorin e Malajzisë, Dato Abdul Malik.

Pasi i dëshiroi mirëseardhje, Myftiu Tërnavë e njohu mysafirin me organizimin dhe aktivitetet e BIK-ut si institucion i vetëm që organizon dhe udhëheq jetën edukativo-fetare në Kosovë. Ai falënderoi shtetin e Malajzisë për të gjitha ato që ka bërë para dhe pas pavarësisë së Kosovës, si dhe për përkrahjen që ende po vazhdon ta japë që Kosova të integrohet në mekanizmat rajonale dhe ndërkombëtarë. Myftiu Tërnavë tha se jemi të interesuar për forcimin e lidhjeve dhe për hapjen e mundësive të reja të bashkëpunimit.



Nga ana e tij, ambasadori i Malajzisë, Dato Abdul Malik, falënderoi Myftiun për pritjen vëllazërore dhe u shpreh i lumtur që Kosova po ecën me hapa të sigurt drejt zhvillimit dhe prosperitetit dhe

se Malajzia do të vazhdojë të ndihmojë Kosovën që populli i saj të ketë mirëqenie ekonomike e sociale.

Të dy palët ranë dakord dhe shprehen gatishmëri për thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit. (R.S.)

MYFTIU TËRNAVA MBIKËQYRI PUNIMET NË RENOVIMIN E KONVIKTIT TË MEDRESEJË

Më 8 shtator 2022, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka mbikëqyrur punimet në renovimin e konviktit të ShML “Medreseja Alauddin” në Prishtinë. Ai pa nga afër punët e deritanishme, për të cilat u nda tejet i kënaqur me ecurinë e tyre. Myftiu Tërnavë falënderoi të gjithë vullnetmirët që kanë ndihmuar deri më tani për renovimin e këtij objekti, duke lutur Zotin që t’ua shpërblejë me të mirat e Tij në këtë dhe botën tjetër. Ai edhe njëherë bëri thirrje që edhe më tej të ndihmohet dhe që të kontribuohet për



renovimin e vatrës arsimore “Medreseja Alauddin”. Vlen të përmendet se renovimi i konviktit të Medresesë është

ende në fazën e parë, dhe deri më tani ka përfunduar instalimi i ngrohjes dhe nivelizimi.

MYFTIU TËRNAVA VIZITOI AMBASADËN E KOSOVËS NË HOLANDË

Më 10 shtator 2022, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga drejtori i Financave në Kryesinë e BIK-ut, Islam ef. Hasani, kanë vizituar Ambasadën e Kosovës në Holandë, në të cilën u mirëpritën nga ambasadori z. Dren Doli. Ambasadori, z. Doli falënderoi Myftiun Tërnavë për vizitën dhe çmoi lart kontributin, punën dhe aktivitetet që po bën BIK-u, që Kosova të jetë një vend i qetë fetar, ku respektohen dhe çmohen toleranca dhe bashkëjetesa, vlera këto që e bëjnë të dallohet vendi ynë. Myftiu Tërnavë e



njohu ambasadorin Doli me ecurinë e jetës fetare në Kosovë, si dhe me

aktivitetet që zhvillon Bashkësia Islame e Kosovës.

PRIJËSIT FETARË TË KOSOVËS TAKUAN KRERËT E UÇK-SË

Më 10 shtator 2022, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë dhe ipeshkvi i Kishës Katolike, Dodë Gjergji, janë takuar me krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët ndodhen në Qendrën e Paraburgimit në Hagë. Pas takimit, Myftiu Tërnavë u shpreh se vizita e sotme së bashku me ipeshkvin Gjergji ishte tejet domethënëse dhe në kohën e duhur.



“Ata na falënderuan për mbështetjen e vazhdueshme, si dhe u shprehën të bindur në pastërtinë e tyre dhe të luftës së tyre. Ne patëm rastin që të bisedojmë me të gjithë për shumë gjëra, për çka besoj se kjo vizitë edhe ia ka arritur qëllimin e saj. Të gjithë ishin mirë me shëndet,

me moral të lartë dhe të bindur në kauzën e tyre të drejtë” – u shpreh ndër të tjera Myftiu Tërnavë. Në fund, Myftiu Tërnavë, shprehu bindjen e tij dhe shpresën që së shpejti krerët e UÇK-së të shpallen të pafajshëm dhe të kthehen në vendlindjen e tyre.

MYFTIU TËRNAVA MORI PJESË NË PËRURIMIN E “XHAMISË SË HAXHILERËVE”

Më 15 shtator, në fshatin Klinë e Poshtme të komunës së Skenderajt është bërë hapja solemne e “Xhamisë së Haxhilerëve” ku morën pjesë një numër i madh i të pranishmëve. Në këtë ceremoni mori pjesë edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i cili u shpreh tejet i lumtur për ndërtimin e kësaj xhamie. Ai duke uruar banorët e këtij fshati, tha se duhet punuar bashkërisht për një të ardhme më të mirë për vendin. Myftiu Tërnavë përmendi gjithashtu sakrificën e gjithë atyre që dhanë jetën për lirinë e vendit e që falë kësaj lirie populli i Kosovës po gëzon të drejtat e veta. Ndërtimin e kësaj xhamie e përshëndeti edhe kryetari i Komunës së Skenderajt, z. Fadil Nura, i cili uroi



që ky objekt të rrezatojë unitet të përbashkët. Ndërtimin e kësaj xhamie e uruan edhe kryetari i KBI-së së Skenderajt, kryetari i fshatit, si dhe donatorët. Ideja për ndërtimin e kësaj xhamie kishte nisur qysh në vitin 1984, por që ishte pezulluar dhe u ndalua

nga ish-regjimi serb, për të filluar sërish ndërtimin e saj në vitin 2019 me iniciativë të bashkëfshatarëve e veçanërisht të vëllezërve Muhamed dhe Arif Ibishi. Falë këtyre, banorët e këtij fshati po e gëzojnë ndërtimin e tërësisht të saj.

VIHET GURTHEMELI I XHAMISË NË FSHATIN DOBËRDOL TË PODUJEVËS

Më 16 shtator 2022, kryetari i Bashkësisë Islame, Myftiu Naim ef. Tërnavë, mori pjesë sot në vënien e gurthemelit të xhamisë në fshatin Dobërdol të Podujevës. Ai duke uruar banorët, falënderoi edhe donatorin për këtë gjest të madh dhe u shpreh tejet i lumtur që dita-ditës po ndërtohen xhami të reja, ku besimtarët mund të kenë mundësi t'i kryejnë ibadetet ndaj Zotit. Kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame të Podujevës, Mensur ef. Hoti, duke falënderuar donatorin uroi që iniciativa e tij për ndërtimin e kësaj xhamie të shërbejë si shembull për të tjerët. Krahas kësaj xhamie, në ndërtim e sipër janë edhe



shumë xhami të tjera në gjithë vendin. Bashkësia Islame e Kosovës është duke bërë përpjekje maksimale për

ndërtimin e infrastrukturës për t'i përmbushur kërkesat e besimtarëve anekënd Kosovës.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM DREJTORIN E PËRGJITHSHËM TË FONDACIONIT TË VAKËFEVE TË DIJANETIT TË TURQISË, IZANI TURAN

Më 30 shtator 2022 Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim drejtorin e përgjithshëm të Fondacionit të Vakëfeve të Dijanetit të Turqisë, Izani Turan. Myftiu Tërnavë së pari i shprehu mirëseardhje, e më pas e njohu atë me aktivitetin dhe organizimin e jetës fetare dhe edukative që bën Kryesia e BIK-ut në vend. Myftiu Tërnavë falënderoi qeverinë dhe popullin e Turqisë, të cilët kanë kontribuar shumë për përmirësimin e infrastrukturës së BIK-ut, duke theksuar kështu se Turqia vazhdimisht ka ofruar ndihmë dhe mbështetje për shtetin e Kosovës gjatë luftës, por edhe pas përfundimit të saj. Populli i Kosovës asnjëherë nuk do ta harrojë këtë mirësi. Ai tha se



kanë një bashkëpunim të shkëlqyer me Dijanetin e Turqisë, për çka shprehu falënderimet e tij për ndihmën që janë duke dhënë për ndërtimin e Xhamisë Qendrore në Prishtinë. Edhe drejtori i përgjithshëm

i Fondacionit të Vakëfeve të Dijanetit të Turqisë, Izani Turan, falënderoi Myftiun Tërnavë për mikpritjen dhe premtoi se bashkërisht do të punojnë për realizimin e shumë projekteve në dobi të Kosovës.

MYFTIU TËRNAVA VIZITOI AMBASADËN E BRITANISË SË MADHE



Më 15 shtator 2022, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka vizituar Ambasadën e Britanisë së Madhe, për të shprehur ngushëllime, me rastin e vdekjes së Mbretëreshës Elizabeth II, ku u prit nga ambasadori Nicholas Abbott.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM NJË DELEGACIONI NGA QENDRA ISLAME NGA LONDRA

Më 22 shtator 2022, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, me bashkëpunëtorë priti në takim një delegacion nga Qendra Islame nga Londra, të kryesuar nga Dilowar Khan. Pasi u dëshiroi mirëseardhje, Myftiu

Tërnavë i njohu me historikun, organizimin dhe aktivitetet e BIK-ut si institucion i vetëm që organizon dhe udhëheq jetën edukativo-fetare në Kosovë. Ai më pas theksoi se vendi ynë njihet për tolerancë, bashkëjetesë dhe harmoni ndërfetare dhe se populli

ynë asnjëherë nuk ka pasur luftë ndërfetare përgjatë historisë. “BIK-u vazhdimisht ka luajtur një rol kyç në mbarëvajtjen e tolerancës dhe harmonisë ndërfetare në vend” – tha Myftiu Tërnavë. Nga ana e tij, kryesuesi i delegacionit nga Londra,

Dilowar Khan, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen vëllazërore dhe u shpreh i lumtur që Kosova po ecën me hapa të sigurt drejt zhvillimit dhe prosperitetit. Ai shprehu kënaqësinë që u pritën në Kryesinë e BIK-ut dhe se janë të interesuar që takimet të vazhdojnë në të mirë dy vendeve.



MYFTIU TËRNAVA: “MBËSHTESIM KËRKESAT E MËSIMDHËNËSVE, POR GREVA DUHET TË NDËRPRITET”

*Të nderuar e të çmuar mësimdhënës,
të nderuar shërbyes civilë,*

*Ju të respektuar udhëheqës sindikal e
qeveritarë,*

*Të nderuar qytetarë të Republikës së
Kosovës!*

Me vëmendje kam përcjellë zhvillimet e muajit të fundit në vendin tonë, që kanë të bëjnë me grevën në sektorin e arsimit dhe atë të administratës publike. Që në fillim, më lejoni të shpreh vlerësimin dhe konsideratën time me të lartë për mësimdhënësit, profesionin e të cilëve është përtej detyrës së rëndomtë – është në premisat e misionit të shenjtë. E këtë mision dhe detyrë, mësuesit dhe pedagogët tanë e kanë kryer me përkushtim e vetëdije të lartë që nga Rilindja Kombëtare e deri në ditët e sotme. Të gjithë ne jemi dëshmitarë që një ndër shtyllat kryesore në themelet e mëvetësisë së vendit tonë gjatë viteve të 90-ta, në përballje me okupimin serb, ka qenë organizimi i pavarur i sistemit të arsimit në kuadër të shkollës shqipe. Ne, mbështesim kërkesën e mësimdhënësve të Kosovës për pagë të dinjitetshme, ngase mësimdhënësit kanë mision të shenjtë, janë arsimuesit, edukuesit dhe pedagogët e fëmijëve tanë.



Thërras SBASHK-un që për hir të misionit që bartin mbi vete, që sot ta ndërpresin grevën dhe që nesër fëmijët tanë të kthehen në bankat e shkollës, aty ku e kanë vendin.

Po ashtu, thërras sindikatën e shërbyesve civilë që të ndërpresë grevën, të kthehen në vendin e tyre të punës dhe institucionet publike e shtetërore të zhblokohen e të jenë në funksion të qytetarëve, e të shtetit. Të drejtat e tyre sindikale t'i kërkojnë përmes dialogut social duke pasur parasysh gjithnjë interesin e popullit tonë dhe vendit tonë. Apeloj të dy udhëheqësit e sindikatave që në këto momente të tregohen të arsyeshëm, të urtë dhe t'i kthehemi normalitetit.

Gjithashtu, i bëj ftesë Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës që sa më parë të miratojnë ligjin për paga, e në këtë kuadër, kërkesat e sindikalistëve të merren në konsideratë. Të gjithë jemi të bindur që nuk është koha për përplasje e barrikadime, por për unitet veprues, urtësi, mençuri e mbështetje për njëri-tjetrin. Mbes me shpresë që nesër nxënësit t'i kemi në bankat e shkollës, kurse shërbyesit civilë në krye të detyrës.

Ju faleminderit”

Myftiu i Kosovës,

Naim ef. TËRNAVA

Prishtinë, më 27 shtator 2022

KRYEIMAMI SAHITI NËNSHKROI MARRËVESHJE ME MINISTRIN ÇEKU

Më 28 shtator 2022 Kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, bashkë me ministrin e Kulturës Rinisë dhe Sportit, z. Hajrullah Çeku, kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore islame në Kosovë. Angazhimi i ndërsjellë i dy institucioneve për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë së pasur kulturore islame në Kosovë u formalizua përmes nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit mes MKRS-së nga ministri z. Hajrullah Çeku dhe Institutit për Trashëgimi Kulturor Islame, të përfaqësuar nga kryeimami i BIK-ut, Vedat ef. Sahiti. Përmes kësaj marrëveshjeje ndër të tjera do të krijohen



mekanizma të përbashkët për vlerësimin, inventarizimin, dokumentimin e monitorimin e zbatimit të projekteve të trashëgimisë kulturore të paluajtshme, të luajtshme dhe shpirtërore të besimit

islam në vend. Te dyja palët theksuan qëndrimin dhe përkushtimin institucional për të vazhduar angazhimin në mënyrë që kjo marrëveshje të zbatohet në mënyrë sa më efektive.

KRYEIMAMI SAHITI PRITI NË TAKIM KRYETARIN E KOMUNËS SË PRISHTINËS, Z. RAMA

Më 14 shtator, kryeimami i BIK-ut, z. Sahiti priti në takim kryetarin e K. së Prishtinës z. Përparim Rama, të cilin e njohu për projektet e BIK-ut në fushën e trashëgimisë kulturore në përgjithësi, e në veçanti për projektet restauruese që po realizohen në Komunën e Prishtinës. Kryetari Rama falënderoi kryeimamin për mikpritjen, si dhe përgëzoi Bashkësinë Islame për koontributin e saj në ruajtjen dhe ringritjen e trashëgimisë kulturore islame në vendin tonë.



Pas takimit vizituan dy xhamitë që po restaurohen, xhaminë "Alauddin" dhe Xhaminë e Pirinazit, për të cilat kryetari Rama u shpreh mjaft i kënaqur

dhe theksoi gatishmërinë e tij dhe të institucionit që ai drejton për bashkëpunim me Bashkësinë Islame të

Kosovës për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë së pasur kulturore të Kosovës.

DREJTORI SIMNICA TAKOI KRYETARIN Z. SHABANI

Më 12 shtator 2022, drejtori i DD-së në Kryesinë e BIK-ut, Ekrem ef. Siminca, priti në takim kryetarin e xhamisë "ASR" të Gjermanisë, z. Safet Shabanin. Drejtori Siminca falënderoi z. Shabani dhe xhaminë "ASR" për kontributin e tyre dhënë për mirëqenien dhe jetën e përgjithshme fetare të shqiptarëve atje. Ai shprehu gatishmërinë e tij, por edhe të institucionit të BIK-ut që bashkëpunimi i mirë që ka mbretëruar deri më tani, të vazhdojë edhe më tutje. Ndërkaq, z. Shabani e falënderoi atë për gatishmërinë e tij dhe të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës që të kenë një bashkëpunim të mirëfilltë me qendrat shqiptare në diasporë.



PROF. ASSIST. DR. ISLAM HASANI ZGJIDHET DEKAN I FSI-SË PËR MANDATIN KATËR VJEÇAR

Pas përfundimit të procesit të zgjedhjes së anëtarëve të KMSH-së së FSI-së më 28.07.2022, konstituimit të KMSH-së dhe më pastaj hapjes së konkursit për dekan të FSI-së, më 26.09.2022, prof. ass. dr. Islam Hasani, me vendim të Kryesisë së BIK-ut zgjidhet dekan i FSI-së për mandatin katër vjeçar (2022/26).

Dr. Islam Hasani lindi më 16.03.1975 në Suharekë. Studimet themelore i ka përfunduar në Fakultetin e Studimeve Islame të Prishtinës. Studimet e nivelit master i ka përfunduar në “International Islamic University Malaysia”, ndërsa



ato të doktoratës i ka përfunduar në “University Malaya” të Malezisë.

Dr. Islam Hasani ka një përvojë të bujshme në fushën e arsimit të lartë.

Ka qenë i angazhuar në disa institucione të arsimit të artë, siç janë:

-IIUM (International Islamic University Malaysia), Lecturer (Part Time)

-The Kingdom University, Bahrain
-ESLG College, European School of Law and Governance.

Deri më tani ka qenë i punësuar në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, drejtor financiar.

Flet disa gjuhë të huaja, është i martuar dhe ka dy fëmijë.

47 MUALIME NGA KOSOVA VIZITUAN SHTETIN E TURQISË

Nën organizimin e Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Dijanetit të Turqisë është realizuar vizita shtatë ditore e Dep. të Gruas në qytetin e Stambollit dhe Bursës. 47 mualime të udhëhequra nga znj. Vaxhide Bunjaku brenda kësaj periudhe kohore patën mundësi të vizitojnë objekte të ndryshme kulturore e fetare. Ato në Stamboll vizituan muzeun “15 korriku”, xhaminë e madhe “Çamlica” dhe xhaminë “Ayasofya”.

Vizitën e vazhduan në qytetin e Bursës, ku u pritën nga myftiu i Bursës, Yavuz Selim Karabayir, nënkryetarja Melek Mentese dhe dr. Muhammed Coşkun, drejtor i Qendrës për Specializim Fetar, si dhe nga kryetari i komunës së Bursës.

Mualimet po ashtu u takuan edhe me koordinatoren e Qendrës Kulturore në Bursa, Recep Gunduz. Gjatë qëndrimit pesë ditë në këtë qytet përveç vizitave të shumta, ato ndoqën seminare me tema të ndryshme në Qendrën për Specializim Fetar.

Seminaret janë mbajtur nga personalitete të fushave të ndryshme si:



dr. Muhammed Coşkun, drejtor i Qendrës për Specializim Fetar, Idris Yavuzyigit, shef i Departamentit të Shërbimeve Fetare me Përmbajtje Sociale dhe Kulturore, Dursun Ali Coşkun, shef i Departamentit të Arsimit dhe Udhëzimit jashtë shtetit, Melek Mentese, nënkryetare e Bursës, Izani Turan, drejtor gjeneral i Fondacionit Fetar turk, e personalitete të tjera.

Mualimet vizituan qytetin e Bursës (xhamitë, tyrbet, pazaret), Fakultetin Teologjik, Myftininë e Bursës, muzeun

“Panorama”, Librarinë “BKM” e vende të ndryshme.

Udhëheqësja e Departamentit të Gruas, znj. Vaxhide Bunjaku, u shpreh tejet e kënaqur dhe njëherësh falënderuese ndaj shtetit të Turqisë për pritjen dhe organizimin që u është bërë. Ajo falënderoi organizatorët, Bashkësinë Islame dhe zyrën e Dijanetit në Kosovë.

Të gjitha mualimet në fund të seminarit u pajisen me certifikata nga Dijaneti i Turqisë. (Sh.K.)

MYSAFIRË NGA FRANCA VIZITUAN SHOQATËN “BEREQETI

Më 15 shtator 2022, Shoqata Humanitare Bamirëse “Bereqeti”, ka pritur një grup turistësh nga Franca. Ata janë pritur nga drejtori i “Bereqetit”, z. Behxhet Ajvazi, z. Xheladin Fazliu dhe z. Bashkim Mehani. Drejtori Ajvazi i njohu mysafirët me historikun dhe veprimtarinë e shoqatës me theks të veçantë për veprimtarinë e tyre humanitare jo vetëm në Kosovë, por edhe jashtë saj. Mysafirët nga Franca ishin të interesuar për të kaluarën e Kosovës, për sfidat me të cilat përballlet ajo, sidomos në kohën e pandemisë. Ata u ndanë jashtëzakonisht të kënaqur me mikpritjen. Pas këtij takimi, ata vazhduan vizitat e tyre edhe në objektet e trashëgimisë kulturore dhe fetare në Kosovë.



DOKTOROI FLAMUR KASAMI

Më 11 maj 2022, Flamur Kasami, mbrojti me sukses disertacionin e doktoratës në Universitetin “Uludag” të Bursës, në Institutin e Shkencave Sociale, Shkencat Themelore Islame, në drejtimin Shkenca Kuranore dhe Tefsir, me temën “Metodologjia e Thaëlebiut në tefsirin e tij “el-Keshfu ve-l-Bejjanu fi Tefsiri-l-Kurani”. Komisioni ishte i përbërë nga prof. dr. Celil Kiraz, prof. dr. Remzi Kaya, prof. dr. Muhammet Tarakçi, prof. dr. Ali Karataş, Doc. dr. Gökhan Atmaca.

Flamur Kasami lindi më 1985 në Bresanë të Dragashit. Gjatë viteve 2017 – 2022 ka punuar në Universitetin e Pamukkales – në Fakultetin Teologjik, asistent – profesor i lëndës së Kuranit dhe predikimit.

Dr. Flamuri, jeton e vepron në Stamboll. (K. Muhameti)



DOKTOROI MUHAMED STUBLLA

Më 25 gusht 2022, Muhamed Stublla, mbrojti me sukses disertacionin e doktoratës me titull “Metodologjia e Imam Muhamed bin el-Hasen esh-Shejbanit në librin “El-Huxhe ala ehli el-Medineh” në fushën e hadithit, në Universitetin e Jordanit.

Komisioni i përbërë nga dr. Besim el-Xhevabirah, kryetar dhe mentor, prof. dr. Mahmud Rashid, prof. dr. Abdu Rabehu ebu Sajlik dhe prof. dr. Ahmed Abdullah, anëtarë, vlerësuan punimin dhe kontributin e kandidatit, dhe me konsensus vendosën t’i japin titullin doktor i shkencës së hadithit.

Muhamed Stublla lindi më 28 qershor 1989, në fshatin Herticë, komuna e Podujevës. Shkollën fillore e përfundoi në fshatin e lindjes, ndërsa të mesmen e vazhdoi në medresenë e mesme “Alaudin” në Prishtinë. Në vitin 2009, u regjistrua në Universitetin “El-Ulum el-Islamije el-Alemije” të Jordanit, në drejtimin Bazat themelore të fesë, studime, të cilat i përfundoi në vitin 2014. Më pas, studimet master i vazhdoi



në drejtimin e shkencave të hadithit, në po të njëjtin Universitet, të cilat i përfundoi në vitin 2016.

Më 17 dhjetor 2020, magjistroi për herë të dytë, në po të njëjtin Universitet, në fakultetin “Medhhebi Hanefi”, në drejtimin fikhu hanefi.

MERHUM: NDËRROI JETË DIJETARI I MADH BASHKËKOHOR, PROF. DR. JUSUF EL-KARDAVI

"Të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehemi"

Me 26 shtator bota islame humbi një ndër dijetarët më të mëdhenj bashkëkohor, në fushën e fikhut, shejh, prof. dr. Jusuf el-Kardavi.

BIOGRAFI E SHKURTËR

Jusuf el-Kardavi lindi më 9 shtator 1926 në fshatin Safet Turab të Egjiptit. Që në moshën dhjetë vjeçare mësoi përmendësh Kuranin. Shkollimin fillor dhe të mesëm e kreu në Ez'her dhe çdoherë herë ishte prej nxënësve më të dalluar.

Diplomoi në Fakultetin e Usul Dinit në Universitetin e Ez'herit, në vitin 1952-1953. Në vitin 1973, kreu doktoratën me temë "Zeqati dhe ndikimi i tij në zgjidhjen e problemeve shoqërore".

Gjatë jetës ka ushtruar një sërë përgjegjësish e detyrash, si:

- Drejtor i Institutit të Mesëm Fetar, në Katar (1961); - Dekan i Fakultetit të Sheriatit në Universitetin e Katarit (1977 - 1990); - Udhëheqës i Qendrës për Studime dhe Hulumtime në

Historinë dhe Traditën e Profetit a.s.; -Ligjërues në xhami, dhe mbikëqyrës i ligjëruesve dhe imamëve në Egjipt; - Mbikëqyrës i botimeve në Universitetin e Ez'herit; - Kryetar i Unionit Botërorë të Dijetarëve Mysliman, kryetar i Këshillit Evropian për Fetva dhe Studime; - Anëtar i Këshillit për Studime dhe Hulumtime në Egjipt; - Anëtar i Këshillit të Jurisprudencës Islame, me seli në Meke; - Kryetar i Bordit Mbikëqyrës të Bankës Islame të Katarit dhe i asaj të Fejsalit në Bahrej; - Anëtar i Bordit Udhëheqës të Qendrës për Studime Islame në Oksford.

Gjatë jetës së tij, ai mori një sërë çmimesh si personaliteti dhe figura më me ndikim në botën islame dhe po ashtu për kontributin e tij të pazëvendësueshëm që e ka dhënë deri më sot. Më 2008 u shpall si personi i tretë më me ndikim në botën islame.

El-Kardavi është autor i afro 200 librave, autor i shumë punimeve shkencore, shumë fetvave dhe një



mori emisionesh televizive të incizuara.

Librat e tij janë prit shumë mirë në botën islame, andaj edhe janë përkthyer edhe në shumë gjuhë të botës e po ashtu edhe në gjuhën shqipe janë të përkthyer mbi 50 tituj.

Prej librave të tij më të njohur mund të cekim: "Hallalli dhe Harami", "Fikhu Zekati", "Fetva Bashkëkohore" etj.

Kryesia e BIK ka ka përkthyer dhe botuar librin e tij "Fikhu i prioritetëve" më 2014.

Zoti e shpërbleftë për punën dhe kontributin e tij me Xhenetin Firdevs!

MERHUM: NDËRROI JETË ISH-MYFTIU I BASHKËSISË ISLAME TË MALIT TË ZI, JUSUF EF. GJOKAJ

"Të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehemi"

Më 26 shtator, në moshën 76 vjeçare ndërroi jetë ish-myftiu i Bashkësisë Islame të Malit të Zi, Jusuf ef. Gjokaj.

BIOGRAFI E SHKURTËR

Jusuf ef. Gjokaj lindi më 18.11.1946, në Dinoshë të Malit të Zi. Rrjedh nga një familje e respektuar, nga babai haxhi Beqiri dhe nëna haxhike Sherifeja, e lindur Beqoviq.

Shkollën fillore e kreu në Dinoshë, për të vazhduar shkollimin e mëtejshëm në medresenë e mesme "Alauddin" në Prishtinë. Më pas, ai studioi në

Universitetin e Bagdadit, në drejtimin "Letërsia arabe dhe ligji i Sheriatit", ku dhe diplomoi në vitin 1972.

Pas kryerjes së shërbimit ushtarak në vitin 1973, emërohet si imam i "Xhamisë Bajrakli" në Beograd në vitin 1974-1975.

Prej vitit 1975 deri në vitin 1986 punoi në Republikën Arabe të Libisë.

Në vitin 1986, pranohet në Meshihatën e Bashkësisë Islame në Mal të Zi, ku dhe u emërua si Myfti i BI-së së Malit të Zi.



Detyrën e myftiut e ka kryer deri në vitin 2011, gjegjësisht në fundin e karrierës deri kur doli në pension.

E lusim Allahun e Madhëruar ta mëshirojë shpirtin e tij fisnik dhe ta shpërblejë me Xhenetin Firdevs!

XHELOZIA E SHEJTANIT

Shëtiti shejtani në “rrugicat” e djallëzisë,
me dinakëri i vendos kurthe njerëzisë,
ai asht betu se kurrë s’do të pushojë,
me të gjitha format njeriun ta mashtrojë.

Për t’ia arrit kësaj, punon ditë e natë,
me “mjeshtërinë” e tij që e ka zanat.
Turma njerëzish për nga ai shtrijnë hapin,
“Likes” të panumërta atij i japin.

Me gjithë këtë arritje s’ngopet shejtani,
bahet xheloz se po ia kalon ‘insani’.
E thotë me vete shejtani dinak,
se djallëzitet e njeriut po i hyjnë në ‘hak’.

Njeriu djallëzor përpara po ecë,
ustai i tij një hap mbrapa ngec.

E kjo shejtanit aspak s’i pëlqen,
e pyet me habi: “Njeriu kta ...ku i gjenë?!”
A thu nga rruga ime ka deviju,
që mu si ‘usta’ më ka anashkalu.”

Në punë djallëzore i ligu ka ecuri,
për këtë arritje djalli ka zili.

Për prishjen e moralit s’kursehet i ligu,
çdo gja e mirë nga bota e tij iku.
I duket shejtanit se mbrapa ka mbet,
ndonji metodë të re mundohet me gjet.

E mendja djallëzore shpeshherë i thotë:
“Me njeriun e lig nuk ia del dot,
nëse donë që puna me të shku mbarë,
nga “insani” i tillë ‘kurse’ me marrë!”

Të gjitha këto, shejtani i mendon,
“ortakut” të tij suksese i uron!
Se punë të tilla që njeriu i ban,
kanë vetëm një “logo” që i thonë: shejtan.

E për atë që dy pikë mend i kanë mbet,
t’i përdorë si duhet sa nuk i kanë tretë,
për ruajtjen e mirësisë në gara le të jetë!

Burhan Fili

JETA ËSHTË VETËM NJË KUJTIM

Dhunti nga Zoti është jeta,
E ne jemi të lirë në vepra,
E ato do të na shoqërojnë,
Janë ndjenja që na rikujtojnë.

Gjatë jetës kemi përgjegjësi e obligime,
Zhvillojmë aktivitete, art e qytetërime,
Përballemi me sfida e ballafaqime,
E gjurmët tona mbesin si kujtime.

Vetëm një përshëndetje,
Memorien e ndriçon,
Para shumë viteve gjërat t’i kujton,
Pra o njeri, vetvetja të mjafton.

E kur na dalin përpara ndjemë gëzim,
Se ishim dikush na vije mallëngjim,
Jetuam e vepruam me mundim,
Jeta është vetëm një kujtim.

Refik Gerbeshi

Rrugës për në Mekë

-I-

Rrugës për në Mekë,
Syri së vështruar nuk pushon,
Shpirtit, mendjes e zemrës,
Njohuri të shumta i ofron.

-II-

Mendja përnjëherë fluturon,
Nëpër atë shkretëtirë të pafund ajo noton,
Sa pejgamberë të shumtë këndej kaluan,
E sa porosi të shumta nga Zoti ata kumtuan.

-III-

Librat qiellorë me shumë porosi,
Të gjithë urdhëruan të besohet Një Perëndi,
E të adhurohet vetëm Madhëria e Tij,
Ngase Zoti e begatoi njeriun me këtë mundësi.

-IV-

Kur nga dritarja këtë shkretëtirë të pafund shikoj,
Në mendje më vjen dhe historinë rikujtoj,
Dhe atje diku larg patjetër takoj Pejgamberët,
Vuajtjet e tyre të shumta për të sjellë lumturinë.

-V-

Mendoj Ademin dhe momentin e krijimit,
Havanë, nënën e njerëzimit,
Si ata në Xhenet u takuan,
Erdhën në këtë botë dhe u sprovuan.

-VI-

Nuhun dhe përmbytjen e tokës me ujë në përgjithësi,
Marrjen fund të popullit mizor të tij,
Si ngjarje më e madhe në histori,
Për të shpëtuar ata që ishin me Nuhun në anije.

-VII-

Përkujtoj Ibrahimin dhe hedhjen në zjarr të tij,
Refuzimin e zjarrit që të djegë këtë njeri,
Ndërtimin e Qabesë me Ismailin, birin e tij,
Kurbanin, hedije nga i Madhi Perëndi.

-VIII-

Kur Musanë në këto momente e kujtoj,
Te firaonët mendja më shkon,
Se me çfarë pengesa u ballafaqua,
Fjalën e Zotit për ta kumtuar.

-IX-

Kujtoj Musanë dhe detin si u nda,
Urdhrin e Zotit: "Bjeri me shkop, o Musa!"
Turmën e njerëzve që e besuan,
Dhe detin me ndihmën e Zotit si e kaluan.

-X-

Mrekulli të shumta ndodhën në këto anë,
Isai a.s. lindi pa babanë,
Merjemja, nëna e Isait,
U akuzua me shpifje pa pikë të fajit.

-XI-

Ajo lindi Isanë pa e prekur njeri,
Foli Isai i vogël, se lindja e tij është mrekulli,
Se nderi i nënës,-tregoi,- është i pastër si loti,
Për ta dëshmuar këtë, posa linda më porositi Zoti.

-XII-

I tërë populli mbeti në habi,
Si mund të flasë i porsalinduri fëmijë,
Merjemja kur nga Isai i vogël këto fjalë i dëgjoji,
Ajo shpifjet shumë më lehtë i përballoi.

-XIII-

Të gjitha këto mendime do të ishin të kota,
Sikur për Muhamedin të mos dëgjonte e mbarë bota,
Se Muhamedi, Pejgamber i fundit është dërguar,
Dhe Allahu me Kuran e ka nderuar.

-XIV-

Kur bota kishte humbur nderin,
Asaj Zoti i dërgoi Pejgamberin,
Shpalli Kuranin me porosi,
Libër udhërrëfytes për mbarë këtë njerëzi.

Myftiu Naim Tërnavë

Më 1991

Në aeroplan rrugës për në Mekë.